

**BULETINI I
SHKENCAVE GJEOLOGJIKE**

**ORGAN I
SHERBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR**

VITI XX (XXXIX) I BOTIMIT

1

2003

TIRANE

BULETINI I SHKENCAVE GJEOLQJIKE


**ORGAN I
SHERBIMIT GJEOLQJIK SHQIPTAR**

VITI XX (XXXIX) I BOTIMIT

1

2 0 0 3

TIRANE



BULETINI I SHKENCAVE GJEOLOGJIKE

2003-1

REDAKSIA: Prof. Dr. Teki BIÇOKU Kryeredaktor

ANETARE: Prof.Dr. Ilir ALLIU, Prof.Dr. Radium AVXHIU, Prof.Dr. Çerçiz DURMISHI, Prof.Dr. Kadri GJATA, Prof.Dr. Lirim HOXHA, Prof.Dr. Nikolla KONOMI, Prof. Dr.Selami MEÇO, Prof. Dr. Defrim SHKUPI, Inxh.Hidrogeol. Ibrahim TAFILI, Prof.Dr. Artan TASHKO (Sekretar)

Art Disigner Genc TOMINI

Adresa Redaksise: Redaksia e Buletinit të Shkencave Gjeologjike
Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Rruja e Kavajes Nr. 153, Tirana, ALBANIA
Tel. + 355 4 222 578
Fax. + 355 4 229 441
www.gsa.gov.al

TREGUESI I LENDES (CONTENTS)

50 VJETORI I SHERBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR
“Gjeologjia shqiptare dje, sot dhe neser”
Fjala e Hapjes - A.Frasherri

6 Pershendetja e Ministrit te Industrise dhe Energjites me rastin e 50 Vjetorit te krijimit te Sherbimit Gjeologjik Shqiptar
Z. V. Doda

8 Gjeologjia Shqiptare dhe krijimi i Sherbimit Gjeologjik Shqiptar premise e rendesishme per zhvillimin ekonomik te Shqiperise.
T. Biçoku

13 Kontributi i Sherbimit Gjeologjik Shqiptar ne zhvillimin e Ekonomise Shqiptare
I. Premti

16 Zhvillime te ardhshme te Gjeologjise Shqiptar
H. Beshku

19 Gjeologjia Shqiptare e naftes ne 50 vjetorin e krijimit te Sherbimit Gjeologjik Shqiptar.
I. Fili

22 Gjeofizika ne 50 vjetorin e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar
R. Avxhiu, A. Frasherri, V. Bare

26 Kooperimi i Shqiperise me industrine nderkombetare te Naftes e Gazit dhe situata aktuale e kerkimit dhe prodhimit ne Shqiperi.
A. Xhavo

30 Pershendetje - K. Muska

32 Pergatitja dhe kualifikimi i specialisteve te Gjeoshkencave
S. Meço

35 Rezolucion i Konferences - Gj. Foto

Rivleresimi i vendburimeve te bakrit te Rajonit Perlat - Munelle V. Doda, L. Hoxha	36
Disa ligjesi te perhapjes se Zn dhe Pb ne vendburimin e Hajvalise. B. Durmishaj, A. Tashko, S. Hyseni	62
Vleresimi dhe progozimi i xehoreve lateritike te Fe - Ni ne treven e Kosoves. A. Koliqi, A. Tmava	72
Veshtrim gjeologo - inxhinerik e gjeomjedisor i zones rurale Bulqize. L. Kazanxhi, J. Kola	82
Toka ne zhvillim, nje veshtrim i ri ndaj tektonikes globale nepermjet teorise se Tokes ne ekspansion. V. Shehu	94
Nekrologji - ILIA PAPA	105

**I NDERUAR ZOTI MINISTËR
TË NDERUAR PËRFAQESUES DIPLOMATIKË TË AKREDITUAR NË
TIRANË
TË NDERUAR ZONJA E ZOTËRINJ, TË DASHUR KOLEGË DHE MIQ!**

Sot jemi mbledhur në këtë Konferencë Jubilare për të përkujtuar 50 vjetorin e krijimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, të arritjeve të tij dhe për të përvjuar rrugën e tij në të ardhmen.

Gjatë gjysëm shekullit që kaloi, gjeoshkencat në Shqipëri u organizuan, u zhvilluan dhe arriten suksese të mirënjojura brenda vendit dhe jashtë kufinve të tij. Arritet e Gjeologjisë Shqiptare, përvoja dhe puna e apasionuar dhe vetmohuese e mbi 4000 mijë gjeologëve, gjeofizikëve, petrografëve, mineralogëve, petrologëve, gjeokimistëve, stratigrafëve e paleontologëve, kimistëve, fizikanëve, inxhinerëve të naftës dhe të minierave, e minatoreve dhe naftëtarëve, janë në themel të kontributit të saj për zhvillimin e ekonomisë shqiptare në vite, që qëndrojnë në nxjerrjen, për këto pesëdhjetë vjet, të rrith 50 milion ton naftë, 12 miliardë metër kub gaz, 21 milion ton krom, 20 milion ton bakër, 18 milion ton hekur-nikel dhe 47 milion ton qymyre, miliona ton materiale ndërtimi, lëndë industriale, ujë etj., që i siguruan ekonomisë shqiptare mbi 300 milion dollarë të ardhura në vit, si edhe rezervat e mëdha që i janë lënë brezit shqiptar të sotëm dhe atyre që do të vijnë, si 400 milion ton naftë, 37 milion ton krom, mbi 53 milion ton bakër, mbi 220 milion ton hekur-nikel, mbi 100 milion ton nikel silikat, mbi 700 milion ton qymyre, etj. Këtosuksese janë një bazë e sigurtë për të përvjuar strategjinë afatmesëm e afatgjatë për zhvillimin e ekonomisë shqiptare, si edhe të gjeoshkencave, të kërkimeve gjeologjike dhe të kontrolleve gjeoteknikë komplekse në këtë fillim shekulli të ri, në kushtet e ekonomisë së tregut. Në këtë proces, krahas drejtimeve relativisht të reja të kërkimeve dhe studimeve gjeologjike për zgjidhjen e problemeve të infrastruktura, kërkimeve dhe shfrytëzimit të ujit, të njoħjes dhe mbrojtjes së mjedisit etj. rëndësia e nevoshme duhet ti jepet edhe kerkimeve dhe studimeve gjeologjike të mineraleve të dobishme dhe të naftës e të gazit, si për zbulimin e vendburimeve të reja, por edhe në administrimin e mirë dhe shtimin e rezervave në vendburimet ekzistuese.

Por sot, në këtë Konferencë, midis rradheve tona mungojnë shumë specialistë të degëve të ndryshme të gjeoshkencave. Në pamundësi, po përmenden vetëm disa prej tyre, organizatorë dhe drejtues të shërbimit gjeologjik Prof. Zihni Sinoimeri dhe Prof. Eshref Pumo, Docent Servet Pasho, gjeologët Skënder Dede, Vasil Jorjani, Savete Ohri, Koço Plaku, Milto Gjikopulli, Protoko Murataj, Vehap Bezhani, gjeofizikët Hasan Topçiu, Eriko Veizi, Ligor Lubonja, Salo Arapi, Mihallaq Malaveci, Neim Çavani, mineralogu Petro Kati, paleontologu Shaban Pinari etj. Le të mbajmë një minutë heshtje në kujtim të tyre.

Vitet e tranzicionit të vështirë kanë sjellë ndryshime të mëdha edhe në kërkimet gjeologjike, si edhe në organizimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe të institucioneve të tjera të gjeoshkencave. Por, arritet e gjeologjisë shqiptare janë ato themele të sigurta qe i lejojnë gjeoshkencave në Shqipëri tu bërë ballë sfidave të kohës dhe të përparojnë. Janë me qindra gjeoshkencëtarë e specialistë shqiptarë që kanë paraqitur me dinjitet arritet e gjeologjisë shqiptare në forumet shkencore më të shquara ndërkombëtare, çka përbëjnë kontribut të shquar për të nderuar Shqipërinë në botë.

Konferencën tonë e nderon edhe një delegacion i gjeologëve kosovarë nga Drejtoria e Minierave dhe Mineraleve, KEK dhe Universiteti i Prishtinës, të cilët i falenderojmë përzëmërsisht për pjesëmarrjen e tyre në këtë veprimtari jubilarë.

Prandaj, e kam për nder të madh që të deklaroj të hapur Konferencën tonë jubilare.

Fjala i jepet Inxhiner Gjeolog Viktor Doda, Ministër i Industrisë dhe i Energjetikës.

PËRSHËNDETJA E MINISTRIT TË INDUSTRISË DHE ENERGJITIKËS Z. VIKTOR DODA ME RASTIN E 50 VJETORIT TË KRIJIMIT TË SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR.

Të nderuar pjesmarrës,

Plot gjysëm shekulli më parë u themelua një ndër institucionet më të rëndësishëm e më të të suksesshëm kërkimor e shkencor të vendit tonë, i cili sot mban emrin **Shërbimi Gjeologjik Shqiptar**.

Që në fillim dhe pa ndërprerje për 50 vjet, ai mori përsipër barën e rëndë të kryerjes së kërkimeve e studimeve gjeologjike, si dhe të vlerësimit të lëndëve të para të vendit tonë. Gjatë kësaj periudhe u kërkuan dhe zbuluan vendburime me rëndësi të naftës, gazit, kromit, bakrit, hekuri nikelic, nikelic silikat, qymyreve, mineraleve industriale, lëndëve të para, ujrave të pijshëm etj., të cilët paraprinë dhe mbështetën zhvillimet ekonomike të vendit tonë përmjaft kohë.

Krahas punimeve intensive të kërkimit, u kryen shume studime e përgjithësime gjeologjike, gjeofizike, gjeokimike, hidrogeologjike, gjeologo inxhinierike, të cilat evidentuan ligjësitë shkencore të fenomeneve të ndryshme gjeologjike dhe përhapjes së hidrokarbureve e mineraleve të dobishme. Punimet e kërkimit, zbulimit, si dhe studimet e kryera kanë ofruar një informacion të jashtëzakonshëm që përbën një pasuri të madhe përvendosur tonë. Rezultatet shkencore janë pasqyruar në harta të shkallëve të ndryshme, studime, raporte, projekte, artikuj shkencorë të botuar brenda dhe jashtë vendit, në konferanca e simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky informacion me një vlerë të jashtëzakonshme ka krijuar një shkallë shumë të lartë të njohjes shkencore, që pak vende e disponojnë. Ai është frut i mendjes, mundit, përpjekjeve dhe sakrificave të panumërtë të gjeologëve, specialistëve të ndryshëm të disiplinave të gjeologjisë, shpuesve, teknikëve, punëtorëve dhe gjithë personelit tjeter që punoi e bashkëpunoj me Shërbimin Gjeologjik.

Sot në përvjetorin e 50-të, të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, jam i lumtur që më jepet rasti të falenderoj në emër të Qeverisë Shqiptare të gjithë punonjësit e këtij sektori, që ashtu si në të shkuarën edhe sot, me sakrifica e përpjekje të mëdha, jadin kontributin e tyre të shquar në të mirë të vendit tonë.

Ndryshimet politike – ekonomike të dekadës së fundit natyrshëm diktuan nevojën përvendosur të rivlerësimin e rolit dhe misionit të Sh. Gj. Sh. Klima e re ekonomike shtroi detyra te reja dhe komplekse në përputhje me zhvillimet dhe kërkimesat e sotme të shtetit dhe shoqërisë. Miratimi i Ligjit "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar" ishte një moment kthesh, që ndikoi në konsolidimin dhe zhvillimin e këtij institucioni. Duke u afirmuar si këshilltar teknik i Shtetit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është përpjekur të përqëndrojë aktivitetin e tij në problemet më thelbësore të vendit, që i përkasin kompetencës së shkencave të tokës. Midis arritjeve të këtij 10 vjeçari të fundit dëshiroj të nënvojoz sidomos transformimin e shpejtë të këtij Shërbimi, orientimi drejt kërkimesave të shoqërisë, duke realizuar studime e projekte me vlera aplikative. Pozitiv është fakti se tashmë ndërtimi organizativ dhe synimet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, natyrish pa mohuar nevojën përvendosur natyrish në përvendosur objektivat që plotësojnë nevojat e vendit tonë.

Në veçanti, këto vitet e fundit, në zbatim të Programit të Qeverisë, Sh. Gj. Sh. ka mundur të përfshihet në procesin e integrimit dhe të ndikimit të drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Me studimet dhe projektet që po kryhen është sjellë informacion gjeoshkencor, i cili është i nevojshëm përvendosur natyrish në përvendosur objektivat që plotësojnë nevojat e vendit tonë.

Këto drejtime zhvillimore janë përcaktuar në funksion të misionit të Sh. Gj. Sh, përvendosur studimet e kuptuar fenomenet gjeologjike, përvendosur të dhëna të reja, të cilat janë të nevojshme përvendosur formularimin e bazuar të politikave lidhur me administrimin e tokës dhe nëntokës, rezigjeve natyrore, parandalimin e ndotjeve, planifikimin e harmonizuar dhe zhvillimin e qëndrueshëm rajonal. Ato synojnë të marrin në konsideratë

ambjentin, si dhe të realizojnë menazhimin shkencor të pasurive minerale dhe natyrore, ujut dhe resurseve energjitetike.

Edhe më ambicioz do të jetë programi i ShGjSh përvendosur përvendosur ardhshme. Ai do të synojë vënien në jetë të objektivave të Qeverisë mbi zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, zgjidhjen drejt të problemit të ekuilibrit midis resurseve natyrore dhe nevojave të vendit përvendosur sot dhe nesër, ndërtimin dhe modernizimin e infrastrukturës, krijimin e një ambienti të shëndetshëm, rritjen e cilësisë së jetës, si dhe integrimin me institucionet europiane.

Zgjidhja e kësaj problematike, krahas përmirësimeve ligjore kërkon gjithashtu, rritjen e frysës së bashkëpunimit me institucionet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Këtu kam parasysh në mënyrë të veçantë tërheqjen e mendimit të kualifikuar të institucioneve akademike e shkencore. Vetëm kështu Sh.Gj.Sh. mund ti përshtatet shpejt sfidave që i dalin përpara.

Duke përfunduar, dëshiroj të theksoj se gjithçka që është arritur dhe që parashikohet të realizohet në të ardhmen, nuk mund të bëhet realitet pa përkushtimin dëshiror të specialistëve tanë. Më lejoni të dashur kolegë, punonjës të-sotëm e të djeshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, t'ju uroj edhe një herë shëndet të plotë dhe suksesë në punën tuaj të lavdërueshme.

Ju faleminderit
Tiranë, 1 Nëntor 2002

GJEOLOGJIA SHQIPTARE DHE KRIJIMI I SHERBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR PREMISE E RENDESISHME PER ZHVILLIMIN EKONOMIK TE SHQIPERISE

Nxjerrja dhe perdonimi i mineraleve ne trojet shqiptare dhe i bitumit te Selenices kane filluar 2500- 3000 vjet me pare, per te cilet deshmojne ne veprat e tyre historianet e vjeter Herodoti, Aristoteli, Straboni, Plini etj; ndersa vrojtimet me te hershme gjeologjike per Shqiperine datojne fillimin e qindvjeçarit te 19-te. Vrojtimet e para gjeologjike jane bere nga udhetare e natyraliste evropiane, veçanerisht nga ata franceze. Ato ne te vertete kane qene shenime te rastit ne pershkrrinet e udhetimeve te tyre. Nga me te fillimit jane ato te F. de Pouqueville (1805). Njoftime per minieren e bitumit te Selenices kane dhene edhe H. Hollandt (1815) dhe H. Virlet (1834).

Studimet e para thjesht gjeologjike jane te Ami Boue dhe bashkeudhetarit te tij Auguste Viquesnel. Ami Boue per 40 vjet (1834 - 1874) botoi artikuj te shumte per Shqiperine dhe gjeologjine e saj. Studim gjeologjik te hollieshem ka bere H. Coquand (1868), i cili pershkruan minieren e bitumit te Selenices dhe shfaqjet e gazit dhe te naftes rreth saj. A. Philippson dhe P. Oppenheim kane bere studime ne Shqiperine e Jugut perfshi edhe krahinen e Korçes (1892 - 1896) duke ndertuar edhe hartat gjeologjike ne shkallen 1: 750 000 dhe 1: 300 000. Gjeografi Italian A. Baldacci ka pershkruar te dhena gjeologjike, sidomos per minieren e Selenices (1892 - 1897), te cilat i ka vazhduar edhe me vone; kurse paleontologu A. Simonelli ka bere studimin e faunes pliocenike te Selenices (1893).

Studimet geologjike te gjysmes se pare te qindvjeçarit te 20 kane qene me te shumta. Ne vitin 1902 A. Von Kastrota ka botuar ne Bruksel harten gjeologjike e klimatologjike te Shqiperise ne shkalle 1: 500 000. Per gjeologjine e Shqiperise kane shkruar C. Renz, V. Regny, A. Gounot, J. Cvijic, H. Veters.

Gjate Luftes se Pare Botore prane shtabeve te ushtrive te huaja, qe kishin pushtuar pjese te ndryshme te Shqiperise, kishte edhe gjeologe, te cilat kane punuar ne Shqiperi. Keshtu per Austrohungarine F. Goebel, H. Vetteks, E. Nowaek, K. Von Teleg; per Francen S. Bourcart, K. Abrad, H. Cossman, per Italine L. Maddalena etj.

Nga studimet e ndryshme jane per tu permendur ato te:

Gjeologut Italian A. Martelli, i cili gjate viteve 1903-1912 ka bere vrojtime dhe hartografime gjeologjike ne krahinen e Vlores, perfshi edhe minieren e bitumit te Selenices, qe i ka pasqyruar ne disa studime dhe qe perfunduan me botimin ne Rome me 1912 te hartes gjeologjike 1: 200000 dhe te gjeologjise se krahines se Vlores.

Gjeografit dhe gjeologut Hungarez F. Nopcsa i cili gjate viteve 1903-1913 e me pas me nderprerje deri me 1922 ne Shqiperine e Veriut ka bere studime etnografike, gjeografike e gjeologjike qe i ka pasqyruar ne 30 artikuj e punime, qe u kuroreuan me botimin ne Budapest me 1929 te hartes gjeologjike te Shqiperise se Veriut ne 1: 200000 dhe te vepres madhore "Gjeografia dhe Gjeologjia e Shqiperise se Veriut".

Gjeologut Francez J. Bourcart, i cili gjate viteve 1916-1924 ka punuar ne krahinen e Korçes, rezultatet i ka pasqyruar ne mbi 20 artikuj e punime dhe botoi ne Paris me 1921 harten gjeologjike 1:200 000 te Krahines se Korçes dhe rajoneve jashte kufinjve te sotem dhe tekstin "Kufinjte e Shqiperise te administruar nga Franca (1916-1920). Kontribut per gjeografine dhe gjeologjine e Shqiperise se Mesme (Paris 1922)

Gjeologe Italian G. Dal Piaz, G. De Toni, te cilet gjate vitit 1913 kane bere vrojtime dhe hartografime gjeologjike te rajoneve bregdetare nga Gjiri i Vlores deri ne derdhjen e lumit Mat, perfshi Vlore, Beratin, Elbasanin e Durresin, duke botuar me 1915 ne Rome harten gjeologjike 1: 500000 te ketyre rajoneve dhe tekstin "Relacion i Komisionit per studimin e Shqiperise. Studime Gjeologjike.

Gjeologut Italian G. Ineichen, i cili i ftuar nga qeveria Shqiptare, ka punuar ne Shqiperi gjate viteve 1920-1925, duke drejtuar edhe sektionin e metaleve prane Drejtorese se Bujqesise ne Ministrine e Puneve Botore e Bujqesise, ka bere vrojtime gjeologjike krahinore dhe vleresimin e shfaqjeve minerale dhe te naftes, te cilat i ka paraqitur ne studimin "Resurset minerale te Shqiperise (1924), perqatiti harten gjeologjike te Shqiperise ne shkallen 1:400000 (1925), si dhe perqatiti ligjin minerar dhe ate te dhenies se

koncensioneve. Me pas kaloi me pune ne shoqerite Italiane qe filluan te benin kerkime per nafte ne Shqiperi. Prane tyre punoi deri ne vitin 1943.

Gjeologut Çeko-Austriak E. Nowack, i cili sic u permend ne Luften e Pare Botore kishte ardhur me ushtrine austrohungareze. I ftuar nga Qeveria Shqiptare, ka punuar gjate viteve 1922-1924 nga 6 muaj ne vit per vleresimin e shfaqjeve te ndryshme minerale. Vrojtimet e tij perveç raporteve javore qe i ka derguar sektionit te metaleve prane Drejtorese se Bujqesise ne Ministrine e Puneve Botore e Bujqesise ka pershkuar edhe ne 40 artikuj e punime dhe qe i kurorezoj me botimin ne 1929 te hartes gjeologjike te Shqiperise 1: 200 000 dhe te tekstit perkates.

Duke filluar nga viti 1925 kerkimet per nafte filluan te behen nga shoqerite angleze, italiane, amerikane dhe franceze (AIOC, AIPA, SIMSA, Standart oil of New Jersey, HH Ruston, Syndicat Franco-Albanis, AGIP, etj); ndersa per mineralet e ngurta nga ato Italiane e Angleze (SIMS, SAMAI, Neylor Benzin Co, Montecatini, Monte Amiata, AMMI, Feralba, ACAI). Ne vitet 1930-1932 shoqerite angleze, amerikane e franceze i nderprene kerkimet, te cilat me pas u perqendruan ne duart e shoqerive italiane.

Kerkimet gjeologjike te shoqerive italiane Jane drejtuar nga gjeologet L. Maddalena, G. Ineichen, me pas nga C. Porro dhe S. Zuber; kurse shoqerite angleze nga Papp, amerikane nga Wade, franceze nga M. de Cizanceurt.

S. Zuber gjate 20 vjetave (1927-1947) perveç ndjekjes se kerkimeve dhe hartografimeve gjeologjike, ka bere studime per gjithesuese si harta tektonike e Shqiperise 1:400000 botuar ne 1938 ne Rome; Shenime mbi tektoniken dhe evolucionin gjeologjik te vendburimeve metalore te Shqiperise (botuar me 1940 ne Rome; Zbatimi praktik i teorise paleogeografike ne vendburimet e naftes, harta gjeologjike e Shqiperise 1:200000 (doreshkrim e paperfunduar 1943), harta minerale e Shqiperise 1:300000 (doreshkrim 1943) etj.

Mungesa e gjeologeve beri qe ne vitet 1945-1950 te mos behen kerkime gjeologjike.

Gjysma e dyte e qindvjeçarit to 20 shenon krijimin dhe zhvillimin e Sherbimit Gjeologjik te Shqiperise, fillimin e planifikuar te kerkimeve gjeologjike nga shteti shqiptar, zgjerimin dhe rritjen me hapat te shpejta te tyre.

Sipas marreveshjeve te nenshkuara ne datat 4,8,10 mars 1950 midis Ministritse Industrise se Shqiperise dhe perkatesisht Ministritse se Gjeologjise, Ministritse se Industrise se Naftes dhe Ministritse se Metalurgjise se B.S ne qershori 1950 erdhen ne Shqiperi tri ekspedita gjeologjike Sovjetike te cilat ne fillim u moren me vleresimin e minierave dhe vendburimeve qe ishin ne shfrytezim: te naftes Kuçove e Patos, bitumit Selenice, qymyreve Memaliaj, Krrabe, Priske, te kromit ne Bulqize, bakrit Rubik dhe bene kerkime per zgjerimin e lyre dhe te mineraleve te tjere. Ne vitin 1952 erdhi nje ekspedite polake qe u mor me zbulimin e qymyrit ne Memaliaj. Keto ekspedita vareshin nga Institucionet perkatese nga kishin ardhur, dhe projektet e raportet gjeologjike i perqatitn edhe i mbronin ne vendet e tyre.

Duke marre parasysh rendesine qe kishin kerkimet gjeologjike per zhvillimin e industrise se naftes, industrise minerale, te material ndertimit etj. si dhe perqatjen e gjeologeve te pare shqiptare ne Rusi, Poloni dhe Bullgari, Keshilli i Ministrave me date 31 gusht 1952 vendosi krijimin e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar-Drejtorese Se Pergjithshme te Gjeologjise me strukturat perkatese dhe ekspeditat e para gjeologjike Shqiptare. Me 1 Nenter 1952 filloj edhe perqatja ne vend e gjeologeve shqiptar ne Institutin e Larte Politeknik.

Me forcimin e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar, me date 1 Korrik 1954 ekspeditat gjeologjike sovjetike dhe ajo polake kaluan nen drejtimin tekniko-administrativ te Drejtorese se Pergjithshme te Gjeologjise.

Gjate viteve 1956-1957 e me pas kerkimet gjeologjike moren zgjerim te metejshem sidomos u forcuan kerkimet per hapjen dhe sqarimin e perspektives, meqenese me zbulimin e metejshem ne disa miniera dhe perqatjen e tyre per shfrytezimin merrej Sherbimi gjeologo-markshederik i minierave dhe ai gjeologokantiera i naftes.

Nga 1 Janari 1958 dhe me pas u ngriten ndermarjet gjeologjike te shperndara mbi baza territoriale dhe qe ne perberjen e tyre kishin nga disa ekspedita dhe ekipe gjeologjike. Gjate viteve 1956-1960 u shtua numri

i gjeologove rus, si dhe u thirren gjeologe Polak per kerkimin e qymyrit, gjeologe Çekoslovakke per kerkimin-zbulimin e mineralit te hekur-nikelit, gjerman per kerkimin e fosforiteve, hungarez per kerkimin e boksideve, bullgar per kerkimin e lendeve te para per qelq-keramike dhe rumun per kerkimin e kripgrave, te cilet dhane ndihmesen e tyre ne studimin e ndertimit gjeologjik dhe te mineralmbajtjes te Shqiperise dhe zbulimin e rezervave te mineraleve perkates. Midis tyre do vene ne dukje kontributi i veçante i Z. A. Mishunina, e cila per 5 vjet radhazi drejtoi ekspediten gjeologjike te naftes, beri studime gjeologjike krahinore dhe perveç te tjerave shkroi monografine voluminoze "Ndertimi gjeologjik dhe naftembajtja e R. P. te Shqiperise" Leningrad 1955-56, si dhe perbatiti, Harten Gjeologjike te Shqiperise 1:200 000 per perdomim ne industrine e naftes me shenimet svaruese Leningrad 1957. Gjithashtu dua te permend punen e ekspediten gjeologjik te drejtuar nga D. L. Dobrecov, qe ka bere rilevimi gjeologjik 2250 km² te Alpeve te Shqiperise dhe Cukalit.

Me prishjen e marredhenieve ndershteterore me BRSS, ne prill-maj 1961 u be terheqja e njehshme e te gjithe specialisteve sovjetike dhe te shteteve te tjera, keshtu qe duke filluar nga viti 1961 te gjitha kerkimet e studimet gjeologjike u kryen plotesisht nga specialistet shqiptar.

Deri ne fund te vitit 1965 edhe kerkimet gjeologjike per nafta e gaz jane bere ne kuadrin e Drejtorese se Pergjithshme Gjeologjike me pas ato u bene nga Instituti Gjeologjik i Naftes e Gazit.

Nga 5 minerale qe njiheshin e shfrytezoheshin deri me 1950, me kohe kerkimet gjeologjike u zgjeruan dhe u kryen edhe per minerale te tjere qe dora dores u arrit te behen kerkime per 50 minerale kryesor e shoquerues. Gjate 50 vjetete Sherbimi Gjeologjik ka zhvilluar veprimtari te gjere e te gjithanshme kerkimore e shkencore duke mbuluar gjithe territorin e Shqiperise me rilevime gjeologjike te shkalleve 1: 100 000 (13 900 km²), 1: 50 000 (16 600 km²), 1:25 000 (23 750 km²), 1:10 000 (2650 km²), te ndjekura nga studimet gjeofizike (sizmike, sizmologjike, gravimetrike, elektrometrike, magnetometrike), radiometrike, gjeotermale, karotazh, studimet gjeokimike, stratigrafike e tektonike, paleontologjike e biostratigrafike, petrografike e mineralogjike, hidrogeologjike e gjeologjise inxhinierike, punime tematiko-pergjithesuese e studime te gjeologjise krahinore e te sintezes, qe kane perfshire nje periudhe kohore gjeologjike prej 470 milion vjetesh, nga formacionet ordovikiane te Korabit deri sedimentet ne formim e siper ne deltat e lumenjeve Drin, Mat, Shkumbin, Seman e Vjose.

Punime te shumta jane bere per kerkim-zbulimin e mineraleve te ndryshme qe kane arritur volume te medha si mbi 10 milion ml. shpime, 700 mije ml. galeri, miliona m³ kanale e germime siperfaçesore, duke arritur volumet maksimal ne natyre ne vitet '80 me 500 mije ml. shpime ne vit dje 32 mije ml. galeri. Per kryerjen e te gjithe ketyre punimeve ne sistemin e Sherbimit Gjeologjik vetem per mineralet e ngurte deri ne vitin 1990 kane punuar 8600 punonjes, pa permendor mijra te tjere qe kane punuar ne kerkimin e naftes e gazit.

Zhvillimi i vrullshem i kerkimeve dhe studimeve gjeologjike çoi ne nje rritje dhe zgjerim te madh te industrise se naftes, te industrise minerale, te material ndertimi etj. Nxjerra e naftes u rrit 17 here, qymyri 54 here, kromi 53 here, bakri 65 here etj.

Keshtu nga 131 mije ton nafte qe eshte nxjerre ne vitin 1950, ne vitin 1974 eshte nxjerrur 2 milion e 440 mije ton, gaz nga 43 mije m³ kub qe eshte nxjerr ne vitin 1960, ne vitin 1982 eshte nxjerre 936 mije m³, qymyr nga 40.8 mije ton qe eshte nxjerre ne vitin 1950 ne vitin 1989 eshte nxjerre 2 milion e 200 mije ton, mineral kromi nga 52 mije ton qe eshte nxjerre ne vitin 1950, ne vitin 1989 eshte nxjerre 1 milion e 200 mije ton, duke zene vendin e trete ne bote per prodhim absolut, gjithashtu u nxorr 186 mije ton koncentrat dhe 39 mije ton ferrokrom, mineral bakri nga 18 000 ton qe eshte nxjerre ne vitin 1950, ne vitin 1989 eshte nxjerre 1 milion e 200 mije ton, hekur nikel nga 260 mije ton qe eshte nxjerre ne vitin 1960, ne 1 milion e 180 mije ton ne vitin 1989, pa permendor prodhimet e tjera.

Periudha 50 vjecare eshte karakterizuar nga nje pune e madhe voluminoze, plot mund e sakriflca e punonjesve te gjeologjise por, pune me rezultate. Jane shpenzuar fonde te konsiderushme monetare per kryerjen e volumeve te medha te punimeve, te cilat çuan ne zbulimin e rreth 300 vendburime te mineraleve te dobishme nga 5 vendburime qe shfrytezoheshin para vitit 1945. Gjate ketyre 50 vjeteteve jane nxjerre

rreth 50 milion ton nafta, rreth 12 miliard m³ gaz, 47 milion ton qymyr, 21 milion ton krom, 20 milion ton baker, 18 milion ton hekur-nikel, miliona ton minerale industriale e lende te para ndertimi, dhjetra pellgje ujembajtes etj. Perveç sigurimit te ketyre sasive rezervash te nxjerra, jane zbuluar dhe siguruar per kohen e sotme dhe te ardhmen rezerva te medha mineralesh si 440 milion ton nafta, 1,5 miliard m³ gaz, 700 milion ton qymyre, 156 milion ton torfe, 37 milion ton krom, 52 milion ton baker, 235 milion ton hekur-nikel, 102 milion ton nikel silikat, 137 milion ton titanomagnetit, mbi 16 milion ton bokside, 300 milion ton kripeguri, perveç 10 miliard ton kripeguri qe ka Dumreja, 60 milion ton olivinite, 58 milion ton dolomite, gjithashtu ka rezerva shume te medha gjipsi e alabasti, mineralesh industriale, gure dekorative dhe lende te para ndertimi. Gjithashtu ky potencial duhet patur ne evidence.

Krahas kerkimeve per studimin e ndertimit gjeologjik dhe mineral mbajtjen e Shqiperise, punimeve per zbulimin dhe sigurimin e rezervave te mineraleve te dobishem, specialistet shqiptare kane bere punime tematiko-pergjithesuese dhe studime gjeologjike krahinore e te sintezes, te cilat jane kurorezaur me perpilimin dhe botimin ne Tirane te hartes gjeologjike te Shqiperise ne shkallen 1: 200 000 ne shqip e frengjisht (1967) dhe te teksteve shpjegues "Gjeologja e Shqiperise (1970 e 1974), permiresimi dhe ribotimi ne Tirane i hartes gjeologjike te Shqiperise 1: 200 000 (1983) dhe i tekstit shpjegues (1990), permiresimi dhe perbatitja per ribotim i hartes gjeologjike te Shqiperise 1: 200 000 dhe tekstit shpjegues (doreshkrim 2002), perpilimi dhe botimi ne Tirane i hartes tektonike te Shqiperise ne shkallen 1: 500 000 (1969), perpilimi dhe botimi ne Johannesburg - Afrika e Jugut i hartes tektonike te Shqiperise 1: 200 000, perpilimi dhe botimi ne Tirane i hartes se mineraleve te dobishme te Shqiperise 1: 200 000 (1971), perpilimi dhe botimi ne Gjermani i hartes metalogenjike te Shqiperise 1:200 000 (2000), perpilimi i hartes se mineraleve industriale te Shqiperise (2000), perpilimi i hartes se gureve deorative te Shqiperise 1:500 000 (2001), perpilimi dhe botimi ne Tirane i hartes hidrogeologjike te Shqiperise 1: 200 000 (1985), perpilimi i hartes neotektonike te Shqiperise 1:200 000 dhe tekstit shpjegues (1995), perpilimi i hartes gjeoteknike te Shqiperise 1:200 000 dhe i tekstit shpjegues (1998), perpilimi dhe botimi i hartes se rajonizimit sismik te Shqiperise 1 : 500 000 (1980), perpilimi i hartes rajonizimit sismik te Shqiperise 1: 200 000 (2002), perpilimi i hartes se anomalive Buge te Shqiperise 1: 200 000 (1993), perpilimi i hartes magnetike te Shqiperise 1:200 000 (1998), hartografimi gjeokimik i Shqiperise 1: 200 000, ne baze te cilid eshte ndertuar atlasi gjeokimik, pçrgatitja dhe botimi ne Gjermani i tekstit "Gjeologja e Shqiperise ne anglisht (2000), harta gjeotermike e Shqiperise 1:100 000 (1994), hartat e burimeve te energjise gjeotermale 1:1000000, harta e rrezikut gjeologjik te Shqiperise 1: 200000 (2002), harta e gjeomonumenteve te Shqiperise ne 1: 200 000 (2002).

Perveç ketyre jane perbatit edhe harta gjeologjike, tektonike, metalogenjike, sismotektonike, gjeotermike etj. ne shkalle me te vogla qe jane botuar si pjese te hartave te Evropes, te harkut Karpat Ballkanik apo Ballkanik. Gjithashtu jane perbatit hartat gjeologjike e te pasurive minerale 1: 50 000 te rretheve te ndryshme te vendit.

Ne fund dua te permend ata qe e kane drejtuar Sherbimin Gjeologjik gjate ketyre 50 vjeteteve, Drejtore te Pergjithshem te Gjeologjise kaqe qene Zihni Sinoimeri (1 nentor 1952 - 30 prill 1955), Zenel Hamiti (1 maj 1955 - 31 dhjetor 1956), kryetar te Komitetit Shteteror te Gjeologjise kane qene Panajot Plaku (1 Janar 1957 - 15 maj 1957), date qe u arratis ne Jugosllavi, Xhafer Spahiu (1 Shtator 1957 - 31 dhjetor 1959), Drejtore i Pergjithshem i Gjeologjise Zenel Hamiti, i cili ka qene edhe zev. Minister i pare (1 janar 1960 - 31 dhjetor 1965), Teki Biçoku (1 mars 1966 - 31 gusht 1975), Ramazan Vladi (1 shtator 1975 - 31 dhjetor 1981), Haki Caslli (1 janar 1982 - 31 mars 1987), Halil Hallaci (1 Prill 1987-30 prill 1989), Ndoc Uci (1 maj 1989-31 gusht 1991), Vasil Grillo (1 shtator 1991 - 15 nentor 1997), Mehmet Zaçaj (16 nentor 1997 - 15 nentor 2001), Hamdi Beshku (16 nentor 2001 e vazhdim). Kryegjeologe kane qene Eshref Pumo (1 nentor 1952- 17 dhjetor 1952), Zihni Sinoimeri (1 maj 1955-31 maj 1957), Teki Biçoku (1 qershor 1957-shtator 1965), pas heqjes se postit te kryegjeologut, kane qene kryespecialistet Rexhep Shehu (1965-1967), Feti Arkaxhiu (1967-1975), Fiqiri Bakalli (1981-1982), dhe zev. Drejtore

te Pergjithshem Vaxhid Tasimi (1992 - 1997), Irakli Premti (1998 - 2000), Çerçiz Durmishi (2000 e vazhdim), Mehmet Zaçaj (nentor 2001 - prill 2002), Lirim Hoxha (qershor 2002 e vazhdim). Me lejoni te perfundoj me urimin qe pervajetoret e ardhshem te gjeologjise qofshin te begate si keto vite qe kaluan dhe me arritje edhe me te medha.

KONTRIBUTI I SHERBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR NE ZHVILLIMIN E EKONOMISE SHQIPTARE

Zonja dhe Zoterinj

Te nderuar te ftuar,

Te nderuar kolege e kolegë.

Sot festojme 50 vjetorin e Sherbimit Gjeologjik te Shqiperise, i cili me punen vetmohuese ka dhene një kontribut gjithnjë e ne rritje ne njohjen e gjeologjise se vendit tone, dhe sidomos ne zhvillimin e industries minerare nxjerrse e perpunuese, si element kryesor qe ka mbajtur një peshe kryesore ne ekonomine e vendit.

Duhet te theksoj, se elemente te Sherbimit Gjeologjik ne Shqiperi jane shfaqur qe ne vitet 20 te shekullit XX, e që më vonë gjijnë pasqyrimin në kartografimet e gjeologëve të ushtrive të huaja okupuese, por Shërbimi Gjeologjik i përbërë nga vetë gjeologët e parë shqiptar të lauruar jashtë shtetit dhe më vonë në ish Institutin Politeknik të Tiranës e Fakultetin e Gjeologji Minierave, e ka ditën e themelimit në 31 Gusht 1952. Që nga kjo kohë e deri më sot në radhët e këtij shërbimi kanë aderuar me dhjetra e qindra gjeologë, dhe specialistë të kësaj fushe si mineraloge, petrologe tektoniste, palanteologe, hidrogjeologe, gjeokimiste, metalogeniste, gjeologo-inxhinjerike, etj.

Në Shërbimin Gjeologjik dhe në Shoqatën e Gjeologëve Shqiptare, gjatë këtyre 50 vjetëve kanë punuar rreth 500 gjeologë në gjeologji dhe në shërbimin gjeologo-minerar. Si rezultat i këmbënguljes personale të çdo njërit dhe specializimeve pasuniversitare të kryera në vend ose jashtë shtetit, në fushën e gjeologjisë, kanë dalë shkencëtarë të vërtetë që me punën e tyre ata kanë dhënë kontribute me vlera kombëtare e ndërkombëtare në fushën e kartografimeve, kërkim-zbulimeve të minraleve të dobishëm të ngurtë dhe të fushave të tjera si mineralogji, petrografi, paleontologji etj.

Kështu në fushën e gjeologjisë gjatë këtyre 50 vjetëve kanë fituar tituj shkencore si akademik, profesore, doktorë, docent, etj, rreth 37 specialistë.

Por vitet kanë bërë të tyren dhe aktualisht në rradhët e Shoqatës të Gjeologeve të Shqipërisë të minraleve të ngurta nuk ndodhen rreth 40 gjeologë, ku do të desha të përmëndja, për mungesë kohe e vendit, disa nga përsonele të tillë të Gjeologjisë si:

Prof. E. Pumo, Prof. Z. Sinojmeri, Prof. I. Ndojaj, Prof. S. Dede, Doc. L. Peza, Mineralogu P. Kati, Prof. Dr. V. Bezhani, Prof. Inxh. H. Caslli, Ing. Gjeologët S. Ohri, Ing. Z. Hamiti, Ing. Gjeolog Sh. Bushati, A. Demi, S. Guranjaku, A. Cakulli e V. Jorjani, i cili dha jetën në krye të punës, K. Gushi, G. Bisha, Q. Çitozi, N. Osmani, Inxh. Hidrogjeolog A. Gjata, Inxh. R. Selimi e Inxh. N. Çoçoli, të cilët me punën e tyre në prodhim ose në didaktike kanë dhënë dhe hekur bazat e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, dhe për këtë ju ftoj që në shënjë kujtimi të tyre të mbajmë një minut heshtje.

Falë punës këmbëngulëse dhe vetmohuese të specialistëve gjeologë për një periudhë 50 vjeçare, megjithëse të ndodhur edhe para shumë vështirësive tekniko-laboratorike dhe ato të terrenit, është bërë e mundur që në Shqipëri të realizohet një kartografim i nivelit ndërkombëtar si në sasi dhe cilësi, gjë që ka bërë të mundur rritjen e efektivitetit të kërkimeve të minraleve të dobishëm në vendin tonë dhe dhënjen e një kontributi të denjë në hartat gjeologjike, metalogenike, tektonike, etj, në kuadrin europjan, dhe atë botëror.

Kështu gjatë këtyre 50 vjetëve nga gjeologët shqiptar janë ndërtuar 3 harta gjeologjike në shkallë 1:200.000 (1967, 1983 dhe 2002).

Për gjithë vendin janë ndërtuar 2 harta tektonike në shkallë 1:500.000 (1965) dhe 1:200.000 (1985) dhe një hartë neotektonike. Eshtë ndërtuar harta hidrogjeologjike e Shqipërisë (1985) ku janë dhënë dhe evidentuar të gjitha burimet e ujit dhe basenat ujëmbajtëse kryesore të vendit tonë. Njëkohësisht janë ndërtuar hartat e minraleve të dobishëm dhe harta metalogenike në shkallë 1:200.000.

Nga viti 1950-2000 territori i Shqipërisë e shprehur në %, është mbuluar me rilevime të shkallëve të më poshtme si në:

Shk. 1:100.000 (45%)

Shk. 1: 50.000 (54%)

Shk. 1: 25.000 (85%)

Shk. 1: 10.000 (10%)

Si rezultat i rilevimeve e kërkimeve gjeologjike në vendin tonë falë Shërbimit Gjeologjik janë zbuluar gati 30 lloje mineralesh, ku ndër më kryesoret përmendim mineralet tradicionale si kromi, bakri, qymyret dhe torfat, hekur-nikeli e nikel-silikat, rërat bituminoze, boksidet, mineralet e ndërtimit si gëlqeror argjila, gipse dolomite e minerale industriale si kaolina, xhami vullkanik, tufe potasike etj.

Ndërsa nga realizimi i projekteve të kërkim-zbulimit të hartuar nga gjeologët shqiptarë është bërë e mundur që të zbulohen rrëth 67 vendburime kromi të mëdha, të mesme dhe të vogla me një sasi kombëtare të rezervave të kromit prej gati 37 milion ton rezervave të të gjitha kategorive.

Gjeologët me interpretimet e tyre kanë bërë të mundur që të zbulojnë vendburime kromi në Shqipëri, si Bulqiza e Batra me veçori të ndërtimit gjeologo—strukturore unikale në bote.

Si rezultat i rezervave të konsiderueshme të dhëna nga gjeologët u bë e mundur që të prodhoheshin në vitin 1987-1988 deri 1.1 milion ton krom në vit me një të ardhur vjetore per ekonominë deri 60 milion USD në vit dhe duke zënë vendin e tretë në botë për prodhimin e kromit.

Në mineralin e bakrit gjeologët me punën e tyre 50 vjeçare kanë zbuluar rrëth 40 vendburime të bakrit dhe sulfureve shoqërues të tyre, me një sasi rezervash bakri për vendin tonë rrëth 50 milion ton të të gjitha kategorive të rezervave ku nga këto 20 milion ton janë me 1.26% Cu. Ndër vendburimet kryesore të bakkrit që mund të përmëndim janë Munella, Karma-2, Perlati Jugor, Lak Roshi etj.

Falë rezervave kaq të mëdha të mineralit të bakrit dhe investimet që janë kryer, është bërë e mundur që të nxirren deri 1.2 milion ton mineral bakri në vit, me një të ardhur vjetore për ekonominë deri 35-40 milion USD (nga bakri dhe elementet shoqërues).

Për mineralin e hekur-nikelit dhe nikel-silikatit janë zbuluar rrëth 25 vendburime të hekur-nikelit dhe nikel-silikatit me sasi të përgjithshme të rezervave, respektivisht 310 milion ton hekur-nikel dhe 104 milion ton nikel-silikat duke bërë të mundur që prodhimi vjetor i këtij minerali të arrinte deri 1 milion ton hekur-nikel.

Për mineralin e qymyrgurit dhe torfave nga punimet e kërkim-zbulimet të kryera nga Shërbimi Gjeologjik është bërë e mundur që të siguroheshin rrëth 600 milion ton rezerva qymyr guri dhe 150 milion ton rezerva për torfat dhe prodhimi vjetor i qymyrgurit të arrijë deri në 2 milion ton në vit.

Zhvillimi i vrullshëm i ndustrisë minerare e cila për vitet e kaluara u bë një nga sektorët më të rëndësishme të ekonomisë duke siguruar nëpërmjet eksportit 100-180 milion USD në vit, bëri të mundur që në këtë industri minerare të punësosheshin rrëth 48 000 punonjës, dhe në fushën e gjeologjisë rrëth 7 500 punonjës.

Vetëm në fushën e gjeologjisë gjeologët shqiptarë bënë të mundur që nëpërmjet projekteve të kërkim-zbulimit të kryheshin sidomos nga vitet 80-90 që volumi i shpimeve të arrijë deri në 500 mijë metra linear në vit përvëç volumit të galerive kërkimore e kanaleve, po të kemi parasysh se volume të tillë investimesh në fushën e gjeologjisë në atë kohë kryheshin vetëm nga shtete të fuqishme si SHBA, Rusi, Kinë e ndonjë tjetër.

Edhe për **materialet e ndërtimit** dhe **gurëve dekorativë** në periudhën 50 vjeçare megjithëse politika e asaj kohe ka qenë e tillë për kryerjen e investimeve në mineralet tradicional e industrial, prapë se prapë edhe në lëndët e ndërtimit sot kemi gati 40 vendburime argjilash, të studiuar si në rezerva dhe cilësi, 60 vendburime gëlqerorësh dhe mermë, ranorë, gjë e cila është mirë e vertetuar në stadin e ri që kalon vendi ynë sidomos për ndërtimin e infrastrukturës, dhe ndërtimeve në përgjithësi në Shqipëri, ku vetëm studimet e kryera nga Shërbimi Gjeologjik, bënë të mundur që ndërtime të tillë të mos gjenden përpara vështirësive për mungesë të lëndëve të para ndërtimore.

Kontributet e çantave kanë dhënë gjeologët Shqiptarë të vendosur edhe në Ministri të tjera, kështu p.sh. Sektori i Gjeologjisë në ish Ministrinë e Ndërtimit ka realizuar studimet gjeologo—inxhinierike të digave të hidrocentraleve tanë, diga që për nga përmasat dhe karakteri strukturor i tyre janë të nivelit european e

Irakli PREMTI

botëror, po e njëjtë gjë duhet thëne për gjeologët që kanë punuar në Ministrinë e Mbrojtjes apo atë të Bujqësisë.

Pasqyrë e punës kaq te madhe e të pa përseritëshme që ka bërë Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, janë edhe te 7000 volumet e raporteve, studimeve, artikujve shkencore dhe relacioneve që ndodhen në Arkivin Shteteror te Gjeologjise, numra keto qe per nga madhesia flasin vëte per aftesite dhe vitalitetin ne teresi te gjeologeve shqiptar.

Për meritat e pamohueshme te pjesetareve te Sherbimit gjeologjik shume prej tyre janë dekoruar deri me çmime Republike dhe vleresime te tjera.

Perveç kontributit qe ka dhene Sherbimi Gjeologjik shqiptar ne zhvillimin ekonomik te vendit tone do te desha te theksoja me krenari se ajo qe eshte me e rendesishme eshte niveli i larte shkencor i punimeve dhe studimeve gjeologjike te kryera nga ky sherbim, te cilat janë te nivelit boteror, sidomos ato te kartografimeve dhe te projektimeve per qellime te kërkim-zbulimeve, dhe kjo pa dyshim eshte puna e gjithe spezialisteve gjeologe shqiptare që kane punuar dhe vazhdojnë te punojne ne kete sherbim. Ne kete kuader nuk mund te le pa permendor shkencetare, gjeologe dhe specialiste qe kane dhene një kontribut te veçante ne udheheqjen e temave dhe studimeve ne kerkimin e mineraleve te ngurta dhe ujët disa prej te cileve ndodhen aktualisht ne pension:

Akademik T. Biçoku, Prof. Dr. R. Shehu, Dr. F. Bakalli, Prof. Dr. M. Shall, B. Vj. Sh. A. Xhomo, Prof. Dr. A. Kodra, Prof. Dr. A. Çina, Prof. Dr. M. Zaçaj, Prof. Dr. K. Gjata, B. V. Sh. Xh. Karkanaqe, Inxh. Gjeolog Sh. Stermasi, Inxh. Gjeolog. S. Qorlaze, Prof. Dr. A. Dobi, Prof. Dr. B. Lleshi, Prof. Dr. H. Hallaçi, Inxh. Gjeolog Henrik Maliqi, Prof. Dr. P. Vaso, Prof. Dr. L. Hoxha, Dr. P. Çakalli, Prof. Dr. D. Shkupi, Inxh. T. Deda, Inxh. P. Kokona, Inxh. N. Shkodrani, Inxh. P. Jani, Inxh. Gjeolog Z. Zeqollari, Inxh. gjeolog P. Kalina, Inxh. gjeolog D. Shtefanaku, Dr. N. Mekshiqi, Dr. E. Vllaho, Prof. M. Koçi, Prof. Dr. A. Tershana, Prof. Dr. A. Serjani, Inxh. S. Shabani, Prof. Dr. A. Pirdeni, Prof. Dr. P. Theodhori, e shume te tjere, qe te me falin sepse nuk mund t'i permend per efekt vendi dhe kohe.

Me lejoni qe te falenderoj dhe kujtoj me respect drejtoret e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar si drejtor i pare Akademiku Teki Biçoku, R. Vladi, H. Hallaçi, H. Caslli, M. Zaçaj dhe H. Beshku.

Jam i sigurte se gjithe kjo pune madheshtore qe eshte kryer ne fushen e gjeologjise do te jetë një baze per punet e tjera akoma me te mëira qe do te bejne ne te ardhmen brezat e rindj, dhe kjo eshte ne nderin e gjeneracioneve te gjeologjise qe kane punuar ne kete fushe, dhe kane ditur ta transmetojne me se miri eksperiençen e mire te punes brez pas brezi.

Duke ju uruar suksese ne pune, ju uroj te gjitheve mirupafshim ne festime te tjera përvjetoresh te Sherbimit Gjeologjik Shqiptar.

Faleminderit

Prof. Dr. Irakli Premti

Kryetar i Shoqatës së Gjeologëve Shqiptarë

ZHVILLIME TE ARDHSHME TE GJEOLOGJISE SHQIPTARE

Inderuar Z. Minister

Te nderuar pjesemares dhe te ftuar,

Konferanca jubilare kushtuar 50 vjetorit te krijimit te Sherbimit Gjeologjik Shqiptar, e organizuar ne bashkepunim me Bashkinin Shqiptar te Gjéoshkencetareve dhe Inxhinjereve i ben jehone kontributit te shqar te gjithe gjeologeve vendas dhe te huaj qe punuan gjate dhe para kesaj periudhe, te cilet me nje perkushtim te vecante themeluan dhe zhvilluan njohjen shkencore per gjeologjine dhe resurset minerale te Shqiperise.

Jam I te njejtit mendim me ate te referuesve qe folen me pare se gjate ketyre viteve aktiviteti I ShGjSh per vleresimin e tokes dhe nentokes ka qene I gjere dhe I shumeanehem. Gjate kesaj periudhe u kerkuau dhe u vleresan me shume se 50 minerale xehore e jo xehore dhe per 39 prej tyre u llogariten rezerva. Jane kryer studime te shumta gjeologjike, rilevime komplekse ne shkalle te ndryshme, studime strukturore-tektonike, metalogenike, gjeofizike, gjeokimike, hidrogeologjike etj., si dhe jane grumbulluar te dhena te shumta gjeologjike, dokumentime, raporte, projekte per te gjithe territorin e Shqiperise, te cilat jane depozituar ne Arkivin Qendor te Gjeologjise. Duke shpresuar se punonjesit e ShGjSh do te vleresojne e shfrytezoje gjithmone punen e madhe te kryer nga breza te tere gjeologesh, une do te mundohem te perqendrohem ne disa nga drejtimet kryesore te punes se tanishme e te perspektives te ShGjSh, veprimitaria e cilit mbeshtetet ne ligjin nr. 8366, dt. 2.7.1998, I cili e cileson ate si "Person juridik, publik, buxhetor, organ keshillimor teknik i shtetit, qe me porosi te tij kryen veprimitari gjeologjike ne territorin e Republikes se Shqiperise"

Aktiviteti i punes kerkimore e aplikative te ShGjSh zhvillohet ne perputhje me kete ligj dhe me Programin e Zhvillimit Ekonomik te Qeverise. Ai po orientohet gjithnje e me mire ne nevojat e shoqerise, duke sjelle ndihmesen e tij ne plotesimin e kerkesave te sotme dhe perspektive per zhvillimin e qendrueshem ekonomik te vendit. Ai sjell informacion te dobishem gjeoshkencor, si dhe ben keshillime qe jane te nevojshme per nevojat kombetare dhe lokale, ne mbeshtetje te vendim-marrjes per nivele te ndyshme.

Programi zhvillimor i ShGjSh i zbatuar nepermjet projekteve eshte perqendruar ne problemet me kritike te kohes te cilat kerkojne zgjidhje te shpejte, por edhe afatgjate.

Duke vleresuar rolin e gjeoshkencave te aplikuara ne sherbim te mire-administrimit te territorit, ambientit dhe burimeve natyrore, Qeveria Shqiptare ka financuar mjaft projekte qe jane perqendruar ne zonat me zhvillime te vrullshme urbane, si ne rajonin Tirane, Durrës, Kavaje, dhe ne te gjithe qarqet e vendit. Ne teresine e tyre ato synojne te zgjidhin nje problematike komplekse, ti jepin zgjidhje problemeve te furnizimit me uje, te shfrytezojne ne menyre rationale dhe te mbrojne resurset e ujrate nentokesore, te vleresojne lendet e para, qe jane te nevojshme per ndertimin e infrastruktureve, te vleresojne treziqet natyrore dhe te propozojne masa per parandalimin e tyre, te studjojne aspektet e ndotjes se ujrate, ambientit, te vleresojne aspektet gjeologo-inxhinjerike te trojeve etj. Studimet realizohen nepermjet hartografimeve te ndryshme dhe studimeve te specializuara nderdisiplinore dhe te dhenat perpunohen ne kuadrin e sistemit gjeografik te informacionit (GIS), duke krijuar mundesi per nje informacion te shpejte dhe koherent per organet vendim marrese, shoqerine dhe subjektet e ndryshme. Produktet perfundimtare te ketij aktiviteti jane hartat e ndryshme qe kane nje vlore te vecante dhe sherbejne per programet zhvillimore kombetare e lokale, per investitoret e ndryshem, institucionet shteterore apo private etj.

Aspekt tjeter i rendesishemi i punes se ShGjSh eshte rivleresimi i metejshem i vendburimeve metalore e jo metalore te vendit tone, si dhe perqatija e projekteve te kerkimit per te rritur potencialin e tyre ekonomik. Duke perqatitur projekte kerkimi, synohet qe te terhiqen investitore vendas dhe te huaj, qe kerkojne te zhvillojne aktivitet ne kete drejtim. Aktualisht ShGjSh po punon per rivleresimin e disa vendburimeve te kromit, bakrit, qymyreve, konkretizimin e disa objekteve te platinit, vleresimin e lendeve te para te ndertimit ne mjaft rajone te vendit, po realizon standartizimin e resurseve, rezervave te vendburimeve te ndryshme sipas kerkesave nderkombetare etj.

Hamdi BESHKU

Nje drejtim mjaft i rendesishem ne veprimitarine e ShGjSh eshte vleresimi dhe menazhimi i ujerave nentokesore si pasuri kombetare. Projektet qe zhvillohen ne kete drejtim synojne ne kryerjen e studimeve hidrogeologjike mbi shperndarjen dhe shfrytezimin e rezervave te ujerave nentokesore ne 11 pellgjet kryesore te Shqiperise. Keto studime sjellin informacion mbi rezervat e shfrytezueshme, kufinje e zonave prespektive, mundesite e reja per rritet e rezervave dhe shfrytezimin racional te baseneve ujembajtes, si dhe sjellin zgjidhje konkrete per sigurimin e ujit te pijshem. Kohet e fundit eshte programuar gjithshtu vleresimi i ujerave nentokesore te zones bregdetare Vlore-Butrint per perdonim publik dhe zhvillimin e turizmit.

Gjeomjedisi dhe tressku gjeologjik eshte nje fushe kerkimore mjaft e ndjeshme per vendin tone. Aktiviteti kerkimor ne kete fushe perqendrohet ne gjetjen e shesheve me te pershtateshme, konform klasifikimit nderkombetar te eurokodit per stokimin e mbetjeve urbane dhe industriale per qytetet e ndryshme te Shqiperise. Studimet janin te dhena per parametrat e ndryshem fiziko- mekanike te terreneve te ndryshme, si dhe rekomandimet perkatese. Eshte perpiluar masterplani per 39 qytete, si dhe jane kryer studime te detajuara per disa qytete. Gjate ketij viti vazhdon puna edhe ne qytete te tjera. Per tu permendur jane studimet ne nivel kombetar, siç eshte perqatitja e Hartes se Rrezikut Gjeologjik te Shqiperise ne shkalle 1:200000.

Mbeshtetur ne nje Vendim te KM te ketij viti, Sherbimi Gjeologjik Shqiptar kryen studime per monitorimin e ambientit, ku perfshihen ujrat nentokesore ne pellgjet kryesore ujembajtes te vendit, hapesira bregdetare, emanacionet e radonit, deltat e lumenjve etj.

Duke vleresuar rolin e studimeve base, ShGjSh kryen njekohesht studime krahinore mbi gjeologjine, tektoniken, stratigrafine, magmatizmin e metalogenine e sektoreve te ndryshem te Shqiperise, perte realizuar nje njohje me te thelluar shkencore te truallit te vendit tone, por qe ndihmojne ne thelb studimet e karakterit te aplikuar. Krahas kesaj ai kryen korrelime gjeologjike nderkuftare me Kosoven, Malin e Zi, Maqedonine dhe Greqine. Per probleme te caktuara me interes dy palesh zhvillohen projekte te perbashketa me institucionet shkencore te Gjermanise, Italise, Polonise, Frances dhe Austrise.

Sherbimi Gjeologjik disponon nje informacion shume te madh per vendburimet, veçorite e trojeve, ujrat, gjeologjine krahinore te Shqiperise etj. Ne vazhdim te punimeve te kryera me pare synohet te perpunohen dhe informatizohen te dhenat konform standarteve te reja. Ne te njejten kohe synohet krijimi bazes se te dhenave per hidrogeologjine, vendburimet, gjeokimine, gjeofiziken, gjeologjine krahinore etj. Objektivi kryesor eshte nderthurja dhe nderveprimi i ketyre bazave, si dhe perpilimi e hartave dixhitale me destinacion te ndryshem.

Kryerja e aktivitetit kerkimor e aplikativ mbeshtetet ne nje strukture organizative qe vazhdimisht ka nevoje te permiresohet, ne menyre qe ajo te jete me e manovrueshme dhe me kosto me lehte per buxhetin e shtetit.

Ne i permbahemi idese se integrimi i sukseseshem ne problemet e zhvillimit te qendrueshem mund te sigurohet ne qofte se aktiviteti kerkimor I ShGjSh mbeshtetet ne nje rrjet organizativ efikas, qe ka te percaktuar sakte detyrat dhe perqegjesite. Me mjaft rendezi eshte fakti se Sherbimi Gjeologjik tashme eshte çliruar nga infrastruktura e renduar, por ne te ardhmen ajo lipset te permiresohet me tej, duke e konfiguruar teresisht sipas modelit europian

Perspektiva e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar

Duke vleresuar lart mbeshtetjen qe Qeveria i ben Sherbimit Gjeologjik Shqiptar, garantohet e ardhmja dhe zhvillimi i metejshem i studimeve djhe kerkimeve gjeologjike. Ne kete kuader, institucioni yne po perpiqet qe aktiviteti i tij te orientohet plotesisht ne nevojat e sotme dhe ato te perspektives. Aspekt themelor eshte angazhimi i tij ne ndihme te vendim-marrjes, duke ndikuar ne konsolidimin e metejshem te rolit dhe misionit te tij.

Hapja e negociatave te asocimit te Shqiperise me BE zgjeron detyrat dhe angazhimet e ShGjSh ndaj shtetit dhe shoqerise. Shoqata e Sherbimeve Gjeologjike Europiane ka ofruar kohet e fundit bashkepunim edhe me vendin tone. Kjo krijon mundesine qe ne te ardhmen vendi yne te marre pjese me gjeresisht ne

programe dhe projekte te ndryshme, te terheqe ndihmen dhe bashkepunimin nderkombetar ne fushen e gjeoshkencave. Ne objektivat kryesore te Sherbimeve gjeologjike europiane klasifikohen problemet e zhvillimit te qendrushem per lendet e para, ujin dhe energjine, administrimi i territoreve dhe menazhimi i ambientit, zhvillimi i infrastruktureve, rreziqet gjeologjike, zona bregdetare, gjeotrashegimia etj. Kjo problematike aktualisht eshte ne qender te vemandjes se ShGjSh dhe ne te ardhmen, duke bashkepunuar ne kuadrin e Programeve nderkombetare ajo do te marre nje zhvillim edhe me cilesor.

Institucioni yne eshte plotesisht I vendosur te perballoje sfidat e reja ne te ardhmen. Per fat te mire, por jo pa veshtiresi, gjeoshkencat po zene gradualisht vend ne shoqeri. Hartografimet shume disiplinore te zonave urbane, vleresimi I resurseve minerale dhe ujore, gjeologjia inxhinierike, rreziqet gjeologjike, mbetjet urbane etj. duke qene disiplina te gjeologjise dhe qe kuptohen pa veshtiresi nga publiku, ndikojne ne vendosjen e profesionit tone ne sferen e preokupacionit social. Ky veshtrim i ri mbi Shkencat e Tokes, duke e pare ate si nje sherbim social, letheson ndjeshem vleresimin e rolit te gjeologut ne kohen e sotme. Kjo krijon nje vizion te hapur dhe optimist per te ardhmen. Une kam besim te plete qe Sherbimi Gjeologjik Shqiptar ne bashkepunim te ngushte me institucionet e tjera te vendit tone si Universiteti, Akademja, Qendra Kombetare e Hidrokarbureve, institucionet e ndryshme te dikastereve etj. do te ece me ritmin e kohes, duke u zhvilluar dhe perparuar me tej.

Ju faleminderit.
Drejtori i Pergjithshem i ShGjSh
Hamdi BESHKU

GJEOLOGJIA SHQIPTARE E NAFTES NE 50 VJETORIN E KRIJIMIT TE SHERBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR.

Prof. Dr. Ilia FILI

Kryetar i Bashkimit Shqiptar te Gjeoshkenctareve dhe Inxhiniereve, dhe i Shoqates se Gjeoshkencetareve te Nafteve:

Shume te respektuar kolege,

Festimi i 50 vjetorit te formimit te Sherbimit Gjeologjik Shqiptar na detyron te kthejme koken prapa dhe te shohim rrugen ku kemi ecur, si kemi ecur dhe ku duhet te shkojme. E ky veshtrim serioz nuk mund te behet pa vleresuar dhe punen e armates se madhe te gjeologeve te industrije te nafteve, te cilet si bujq te mire e te perkushtuar filluan te lerojne nentoken Shqiptare pikerisht 50 vjete me pare. Ne qofte se ne ato vite te hershme ata ishin te paket ne numur, por me zemer dhe perkushtim te madh, shume shpejt ata do ta shikonin veten si nje armate e madhe e vendosur te ecte perpara.

Ne vitet 1945-1952, punetoret heroike te nafteve rikthyen teresisht ne shfrytezim fushat naftembajtese te Kuçoves dhe Patosit, duke arritur prodhimin rreth 130 000 tone.

Specialistet e pare shqiptare, qe ne hapat e pare, hodhen veshtrimin e sigurt jo vetem drejt zgjerimit te fushave ekzistuese por dhe drejt fushave te reja perspektive. Veshtrimi i tyre ishte i guximshem dhe i vendosur.

Sherbimi gjeologjik i kombinatit te nafteve, duke zbatuar parimin nga e njohura ne te panjohuren, arri te zgjeroi fushat naftembajtese Kuçove dhe Patos, si dhe te zbulajo, mbas pak vite pune e pikerisht ne Maj 1957, me pusin 542, gjigandin e nafteve shqiptare, fushen naftembajtese te Marinzes, e cila njekohesisht konfirmoi perfundimisht potencialin naftembajtes te truallit Shqiptare.

Vete historia e zbulimit te fushes naftembajtese te Marinzes, e cila u zgjerua me vone drejt perendimit dhe veriut, perfaqeson nje shembull ideal te perkushtimit dhe vendosmerise te specialisteve tane te pare si Servet Pasho, Zenel Hamiti, Ziver Meko, Ramiz Xhabia, Rexhep Reka, Perikli Prifti, Ramadan Perhati, Egerem Beci etj, te cilet ne vitin 1960 e ngriten prodhimin e nafteve ne 625 000 tone.

Vitet 60 e me mbrapa, nxoren me mire ne dukje si nivelin teknik e shkencor ashtu dhe perkushtimin dhe vtmohimin e gjeologeve tane, te cilet drejtjone dhe konkretizojnë kerkimet dhe intensifikimin e nxjerjes te nafteve, duke zbuluar fusha te reja nafte ne objektin e gelqeroreve. Historia e zbulimit te vendburimeve te nafteve ne gelqerore si Visoke, Ballsh, Gorisht - Koculit, Cakranit, Amonices, Finiqit, Delvines etj, jane deshmi e formimit, nivelit shkencor, perkushtimit dhe dashurise per profesionin e dhjetra e dhjetra gjeologeve. Ngritura e Institutit te Nafteve ne vitin 1965 krijoj mundesine e konsolidimit te shkences gjeologjike te Nafteve. Sot mbas 37 vjeteteve kujtoj me kenaqesi ate grup te shqar specialistash te Institutit te Nafteve qe ne drejtimin e Rexhep Rekes, Koço Pepes dhe Petraq Xhaçkes perveshen lleret per konsolidimin e punes te ketij institucioni me vlera te vyera kombetare e teper i rendesishem, e sot institucion i nderuar i shkences gjeologjike shqiptare. Ne ato dite, une si nje i ri, i cili hidhte hapat e para ne kete fushe te gjere, qe kishte filluar te lerohej, shikoj me kenaqesi punen qe benin mjeshtrat e gjeologjise, tashme e kompletuar me gjithe specialitetet e nevGjshme. KujtGj debatet e gjalla te gjeologeve si Koço Plaku, Milto Gjikopulli, Thanas Nasto, Beqir Alia, Fatri Kadilli, Bedri Kokomani, Protoko Murati, Menyr Arapi, Hektor Dalipi, Viashi Janopulli, Dhimiter Gjenerali, Luftar Bandilli, Thanas Gjata, Adem Dalipi, Xhelal Shehu, Gazmir Çomo, Piro Bibaja, e shume te tjereve.

Si te mos kujtosh sot debatet e zjarrita shkencore te specialisteve te grupeve te Mesozoit e Paleogenit te cilet ndertuan dhe konsoliduan deshifrimin e prerjes karbonatike dhe asaj terigjene, si nje baze e domosdoshme dhe e pa diskutushme per realizimin e kerkimeve te nafteve e gazit. S'mund te harohen debatet midis Anastas Kondos, Irakli Pejos, Jani Ikonomit e Bilbil Meçaj, Thanas Gjates, Viron Skeles,

Vangjel Kicit, Liri Yllit, Violeta Dalipit, Ded Markut, Pellumb Sadushit, etj. dhe me kenaqesi i shikoje mbas pune ne shoqerine e pandashme te gjeologeve, duke qeshur e bere shaka me njeri tjetrit. Duke shfletuar dokumentat dhe kujtimet, zbulimi i çdo vendburimi nafte, e veçanerisht ai i gelqeroreve, pasqyron dhe nje here nivelin dhe perkushtimin e gjeologeve tane te mrekullueshem te cilet e çuan prodhimin e nafte ne shifra te admirueshme ne vitet 70, ne reth 2 000 000 tone nafte ne vit, e cila mbante nje peshe te rendesishme ne te ardhurat e Shtetit Shqiptar. Brezi i gjeologeve te viteve 60 dhe 70, eshte per tu admiruar per kembenguljen dhe perkushtimin e tyre ne zbulimin e nafteve e gazit. Vete historia e puseve 622 Visoke, Ballshit 8 e 14, Divjakes 2 e vecanerishte e puseve Gorishti 1 e 2 dhe Koculi 3, te imponon t'i vleresosh dhe t'i admirosh. Kur puset e pare jepnin shenja nafte nga gelqeroret, vetem gjeologe te tillë e Koço Plaku, Milto Gjikopulli, Thanas Nasto, Petraq Xhaçka, Protoko Murati, Menyr Arapi etj, mund te mernin mbi vete perqejjesi te tillë dhe te projektonin per te kerkuar nafte ne kushte specifike periklinale, ne nje strukture te eroduar siç ishte struktura e Patos Verbasit dhe ne nje objekt te ri siç ishin gelqeroret ne ate periudhe. Jane keta gjeolog qe me nje analize te kujdeseshme te rezultateve te pusit Gorishti 1, i cili çuditerishte ne tavan te gelqeroreve te pritshem, merr devijim te madh dhe diskretiton mendimin gjeologjik, vendosin me guxim shkencore duke projektuar pusan Gorishti 2. E per gjithe kete perkushtim, diktatura ne vend qe ti ngrinte ne piadestal keta gjeologe, çuditerisht u dha plumbi dhe vitet e gjata te burgut. Si te mos kujtojme sot ato dite te veshitura kur pusi Cakran 12 nuk po arinte objektin e gelqeroreve, e kur presioni mbi gjeologet tane ato dite ishte i jashtezakonshem. Ishin specialistet tane te mikropaleontologjise Deko Shehu, Pellumb Sadushi e gjeologet Hektor Dalipi, Luçi Pleqi e Petraq Xhaçka qe morren mbi vete perqejjesine dhe insistuan ne vazhdimin e shpimit, i cili me se fundi konfirmoj zbulimin e vendburimit me te madh te nafteve e gazit ne gelqerore ne vendin tone.

Brezi me i ri i gjeologeve , ai i viteve 80 - 90, vazhdoi punen mbi themelet e ngritura duke zgjeruar vendburimet e Ballsh Hekalit, Arzes, zbulimin e Amonices, Delvines, Poveçes, Pliocenit ne Divjake Ballaj, Panajase, Durresit, rritjen e rezervave ne Divjake e Frakull si dhe zgjerimin e Marinzes drejt perendimit. Ne keto vite kemi tashme nje binom te suksesshem gjeolog-sizmik, i cili funksionon si nje i vetem. Gjeologet Ajet Mezini, Reshat Myftari, Beg Canaj, Mihal Gjoka, Vlashi Bano, Todi Bardhi, Bejo Sejdini, Fotaq Lula, Hasan Bakia, Zyhdi Xhafa, Niko Papa, Vlashi Nakuçi, Trifon Sota, etj, i sheh krah per krah me specialistet e sizmikes Enriko Veizi, Petrit Sadushi, Vangjel Jani, Vilson Bare, Aleko Stamati, Eduard Mahile, Kristaq Jano, etj apo gjeofizikeve kantjeral Idai Haxhiu, Vangjel Ndrio, Daver Çano, Stefan Baldadori, Fejzi Kafexhiu, Thanas Andoni, Kliti Veria, Vladimir Dodbiba, Nazif Kapedani, etj. Te me falin koleget sepse nuk arrrij dot te permend emrat e te gjitheve, sepse ata jane shume dhe te gjithe te admirueshme. Konsolidimi i shkences se gjeologjise te nafteve dhe realizimi i objektivave qe ajo kishte marre persiper, kerkornin domosdoshmerisht krijimin e konsolidimin e degeve ndihmese te saj. Keshtu studimet paleontologjike arriten nivelet bashkekohore dhe ballafaqimi ne arenen nderkombetare ishte i suksesshem. E kjo ishte merite e specialisteve Anastas Kondo, Ded Marku, Irakli Pejo, Pellumb Sadushi, Vangjel Kici, Liri Ylli, Violeta Dalipi, Hazbi Shehu, Simon Prillo, Skender Myftari, Deko Shehu, etj, apo petrografeve Jani Ikonomi, Bilbil Meçaj, Rapo Çela, Viron Skela, etj. S'mund te le pa permendur specialistet e perkushtuar te sektorit te gjeokimise Ilia Dhimulla, Dhimiter Prifti, Petraq Shtepi, Fotaq Diamanti, Theodori Stamuli, Foto Çuri, etj.

Zbulimi dhe me tej intensifikimi i vendburimeve te reja te nafteve, kerkonte domosdoshmerisht dhe percaktimin e tipareve dhe karakteristikave te rezervuarit. Studimet dhe puna plot perkushtim e shkencetarit Tomi Kristo dhe kolegeve e vazhduseve te apasionuar Gjergji Kajana, Gjergji Foto, etj, vleresohen sot si studime shkencore kapitale te cilat sherbyen dhe sherbejne si baze ne trajtimin e vendburimeve te nafteve e gazit. Duke hedhur veshtrimin ne fushat naftembajtese, pa dyshim te del perpara puna vtmohuse e gjeologeve te kantjerit, te cilet me studimet dhe aplikimet e tyre direkt ne prodhim, kane rolin dhe vendin e tyre te pa diskutushem ne shkencen e gjeologjise te nafteve. Eshte e admirueshme puna e Kozma Linos, Shaban Xhezos, Mihallaq Xhekes, Xhelal Shehu, Margarita Fotos, Mustafa Dostit, Shemsi Hensit, Natasha Fili, Bajram Muratit, Skender Elbasanit, Marjeta Nakuçi, Lavdosh Luarit, Maksim Tares, Tajar Hoxhes, Lida

Bonjakut, Nihat Brahos, Flamur Gishtit, Sokrat Gorea, Sokrat Ndoni, Maks Nikollas, Fatmir Hykes, Bilbil Shehut, Ramis Hoxhes, etj.

E gjithe kjo armate gjeologesh te detyron te vleresosh dhe te mos harrosh ate pune te çmuar dhe te pa loddur qe kryen pedagoget e Fakultetit te Gjeologjise e Minierave, e ne veçanti katedra e nafteve, profesoret Ziver Meko, Servet Pasho, kollosi Tomi Kristo, Vangjel Melo, Fotaq Diamanti, Ligor Lubonja, Alfred Frasher, Selarm Meço, Luan Peza, Haki Dakoli, Andon Grazhdani, Gjergji Foto, etj, te cilet perqatiten dhe mesuan armaten e madhe te gjeologeve tane.

Ne kete jubile, shkenca e gjeologjise se nafteve vjen me nje bilance te pasur. Pervec sa trajtuam me siper, ne sot kemi te mbuluar gjithe territorin perspektive me harta te detajuara gjeologjike, te mbeshtetura ne studime te mirefillta stratigrafiko petrografike. Eshte realizuar interpretimi dhe lidhja gjeologjike toke det, etj.

Ngjarjet e viteve 90 - 91 dhe ato te 97, kane lene pasoja te renda ne ekonomine e nafteve. Prodhim i tij sot eshte ne shifra te ulta, krasuar me kulmin e tij. Mundesite reale per ritjen e tij jane te pa diskutushme. E ketu del dhe duhet vleresuar domosdoshmerisht roli i gjeologut, i cili tashme eshte gati i shperfillur ne kantjeret e nxjerjes dhe i tkurur ne Institutin e Nafteve. Pasojat e kesaj situate po te mos riparohen do te jene fatale deri ne shuarjen e prodhimit te nafteve ne vend, sepse rezervat e mbeturat te nafteve jane te pakten 4 here prodhimin e nxjere deri sot. Me gjithe perpjekjet aktuale qe ka ndermare stafi i sotem i Alpetrolit, kjo kerkon nje pune te perhereshme te gjeologeve te nafteve.

Zhvillimet e viteve 90 e ne vazhdim, i kane detyruar specialistet tane te marrin rruget e mergimit. Shume specialist tane tani punojne jashte atdheut e nje pjese e mire e tyre ne pune te rendomta.

Armata e madhe e gjeologeve, e krijuar ne 50 vjet, ben apel per nje rivleresim te rolit dhe mundesive te saja. Te mos harojme se shqetesimi i gjeologeve per punen ne vite, per rezultatin e pritshem, kane gjetur zgjidhje tek sakrifika jo vetem individuale apo kolektive, por edhe ne familjet e tyre e me gjere.

Ballafaqimi me shkencen gjeologjike boterore tregoi vlerat e verteta te shkences gjeologjike shqiptare. Ne kemi realizuar shume studime te perbashketa me shume institucione prestigjoze nderkombetare. Ne menyre te veçante, une do te permendja bashkepunimin e frytshem me institucionet Franceze si Institut Francez i Nafteve dhe me Universitetin Pier e Mari Kyri, per te cilin me kete rast me lejoni te shpreh falenderimet me te mira per Ambasaden Franceze ne Tirane.

Prezantimi i specialisteve tane ne nje numer te konsiderushem konferencash nderkombetare ka qene dhe mbetet dinjitoz, ku atje ne prezantojme jo vetem vlerat individuale por dhe ato te vendit nga vijme.

I gjithe ky bilanc aktiv le te sherbeje si fije nxitje dhe mbeshtetje per shkencen e gjeologjise, qe ajo te rikonsolidohet dhe te japi kontributet e saj ne zhvillimin ekonomik te vendit.

GJEOFIZIKA NE 50 VJETORIN E SHERBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Prof. Dr. Radium AVXHIU

Drejtore i Departamentit te Gjeofizikes ne Sherbimin Gjeologjik Shqiptar, Kryetar Shoqates Shqiptare te Gjeofizikes

Prof. Dr. Alfred FRASHERI

Fakulteti i Gjeologjise dhe i Minierave

Prof. Dr. Vilson BARE

Agjencia Kombetare e Hidrokarbureve

Merita e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar, themeluar 50 vjet me pare, ishte edhe inkuadrimi qe ne fillim i metodave gjeofizike ne kerkimet gjeologjike, ne fillim nepermjet ekspeditave me specialiste te huaj dhe ne vitet 60-te me gjeofizike shqiptare. Do te insistojme rreth ketij fakti, mbasi futja e kerkimeve gjeofizike ne kuadrin e studimeve gjeologjike te konsoliduara si shkence ne Europen e zhvilluar dhe ne SHBA, nderon Prof. Teki Bokon.

Lidhur me kete duhet te bez nje sqarim: Metodat gjeofizike ne Europen Perendimore, ne SHBA dhe ne BS u futen ne kerkimet gjeologjike nga mesi i viteve 30-te. Eshte nje fakt, ndoshta pa precedent, qe Shqiperia e voge1 dhe e pa zhvilluar, qe ne krijimin e Sherbimit Gjeologjik te vet, bashkerendon edhe metodat gjeofizike, te cilat vendet e zhvilluara, i kishin futur gradualisht vetem 15-20 vjet me pare.

Kerkimet gjeofizike u perqendruan ne tre qendra kryesore: ne Ndermarrjen Sizmike-Gravimetrike ne Fier, Ndermarrjen Gjeofizike te Tiranes dhe ne Ndermarrjen Kantierale (karrotazhi) ne Patos, te cilat, deri ne fund te viteve 80, bene studime, me te vertete madheshtore. Ne vitet 90-te, kur u hoq ndalimi drastik "rreth sekreteve te kerkimeve" specialistet e institucioneve me prestigjoze te Europe Perendimore dhe ato Amerikane kane vleresuar jo vetem nivelin shkencor te studimeve gjeofizike ne vendin tone, por kane shprehur habine edhe per vellimet jashtezakonisht te medha te vrojtimeve fushore te kryera ne territorin e Shqiperise.

Ne Sherbimin Gjeofizik per kerkimin e naftes e gazit, sikurse theksuan puna ka filluar ne vitet 50-te dhe eshte dhene nje kontribut i rendesishem ne zbulimin dhe ne zhvillimin e vendburimeve te naftes dhe gazit. Dy nga deget kryesore te ketij sherbimi, sizmika dhe gravimetria, te drejtuar nga specialistet shqiptare mbajten peshen kryesore per kerkimin e zonave nafta-gazmbajtese. Nga Gjeofizika Shqiptare gjate kesaj periudhe 50-vjeçare jane kryer rreth 19.000 km profil sizmik, duke mbuluar tere territorin shqiptar perspektiv per nafta e gaz. Me punime gravimetrike te kryera bashke me Qendren Gjeofizike te Tiranes, eshte mbuluar i gjithe territori i Shqiperise dhe eshte ndertuar harta, ku veçohen zonat perspektive per nafta e gaz. Punimet e para sizmike u kryen me mbulim njefish dhe me stacione oshilografike, te cilat jepninen informacion te pjesshem per ndertimin gjeologjik ne thelles. Me futjen e teknologjive te reja ne vitet 70-te fillojte perparoje edhe metodika e kryerjes dhe interpretimit te informacionit sizmik, duke perdorur metoda fushore te kohes.

Sidoqoftë per perdorimin e metodave sizmike dhe konsolidimin e tyre, krahë specialisteve te huaj, meriten kryesore e kane patur specialistet tane te nderuar: Hasan Topçiu, Enriko Veizi, Novrus Kodheli dhe fizikantet Nikolin Leka e Engjell Saliu.

Me vone, nga vitet 70-te, u futen ne pune stacionet me regjistrim magnetik, fillojte perdorimi i skemave me mbulim shumefish. Kjo u shoqerua me krijimin e Qendres Llogaritese Elektronike, kur ne Shqiperi, sa po kishin ardhur kompjuterat e pare.

Eshte koha kur punimet moren formen e kerkimeve te kompletuara dhe komplekse, me ndryshime cilesore ne interpretim, duke perdorur skemat e thellesis direkte, nga prerjet e kohes deri ne bashkeinterpretim me gjeologjet.

Ne kete etape kemi kontributin e rendesishem te sizmikes ne zbulimin e vendburimit te Cakranit, Amonices, etj, ku u krye nje bashkepunim i frutshem midis sizmikes e gjeologjise nga specialistet Hektor Dalipi, Luçi Pleqi, Petraq Xhaçka, Petrit Sadushi, Pertef Nishani, Reshat Myftari, Menyr Arapi, Vullnet Xhango, Vilson Sullo, Frederik Qyrana, etj.

Numri i specialisteve ne kete periudhe erdhi duke u rritur dhe nje sere specialistash ta rind si Kristaq Jano, Arqile Berberi, Et'hem Seiti, Spiro Bonjaku, Fasili Fejzullai, etj, dhane kontribut te rendesishem si ne rritjen e volumit dhe te cilesise se punimeve sizmike.

Megjithate permiresimet e bera nuk i kenaqen specialistet, te cilet synonin ne perfytyrime te sigurta te ndertimit gjeologjik, per te projektuar puse me shkalle te larte sigurie ne zbulimin e naftes dhe gazit. Kjo solli domosdoshmerine e futjes se teknikes digitale ne regjistrimin sizmik fushor. Ne kete periudhe u kryen per here te pare edhe punimet sizmike dhe elektrometrike detare ne distanca 10-15 km nga vija bregdetare, te cilat kontribuan ne zbulimin e vendburimit te gazit te Povelces, si edhe ne marrjen e rezultave pozitive Divjake, Ballaj, ne Durres, etj. Ne zbatimet e gjeofizikes detare shquhet kontributi i ekipit kompleks gjeologo gjeofizik, midis te cilil punuan Hasan Topçiu, Asti Papa, Alfred Frasher, Vasillaq Leci, Agron Kokobobo etj. Rezultatet pozitive shpune ne rritjen e konsiderueshme te prodhimit te naftes e gazit. Kjo pra erdhi si rezultat nje hapi tjeter cilesor dhe krahë paraparmit ne teknologji u futen nacionet e modelimit sizmik ne ndertimin gjeologjik sidomos ne zonat me mbihipje ku kontribuan Naum Priftaj dhe Xhelal Tahiraj, por edhe nga aplikimi elementeve te sizmikes stratigrafike, nen kontributin e shume specialisteve si Sazan Guri, Eduard Maili, Vullnet Xhango, Aleko Stamat, Vangjel Jani, Andrea Toska, Arqile Berberi, Nuri Rakipi, Ilia Fili, Vilson Bare, Jani Skrami, Et'hem Seiti, etj.

Punimet fushore sizmike vazhduan te kryhen ne vendin tone deri ne vitin 1994. Mbas kesaj periudhe fillojti gradualisht degradimi i stacioneve sizmike, deri sa ne vitin 2001 u shkri komplet Ndermarrja Gjeofizike qe administronte sherbimin gjeofizik dhe te mbetet vetem grupi i interpretimit sizmik qe e ushtron aktivitetin e vet ne perberje te Qendres Kerkimore Kombetare te Hidrokarbureve ne Fier.

Volumi i konsiderueshem i punimeve sizmike eshte perdorur dhe perdoret edhe sot nga kompanit e huaja, qe kane ushtruar dhe ushtrojne aktivitet ne vendin tone. Profillet sizmike te kryer nga specialistet shqiptare, vazhdimisht jane vleresuar dhe shfrytezuar nga keto kompani, bile vendimin per te kryer kerkime ne rajone te caktuara behet pasi vilet informacioni prej punimeve sizmike te kryera me pare nga ekspeditat shqiptare. Kontributi i Salo Arapi dhe Vladimir Veizaj dhe inxhinjereve te tjere te gravimetrise eshte i çmuar ne kerkimet e naftes dhe te gazit, si edhe ne studimet krahinore te Albanideve te Jashtme ku shtrihen vendburimet e naftes e te gazit.

Sherbimi kantieral i studimit gjeofizik te puseve, karotazhi, e fillojti aktivitetin e vet per studimin e puseve te naftes me anen e karotazhit elektrik qysh ne vitin 1950. Nga nje grup i voge1 ne ate vit, ky sherbim u rrit ne vite dje gjate 50 vjeteve arriti te krijoje nje ndermarje nga me te rendesishmet e industrise se naftes. Specialisti e karotazhit Hamdi Bejtja, Alfred Frasher, Agim Luari, Idai Haxhi punuan per ngritjen e ketij sherbimi ne fillimet e viteve 50-te. Me pas Rushan Liço, Daver Çano, Vangjel Ndrio, Nikolla Zendeli, Thanas Andoni, Kliti Verria, Stefan Baltadori, operator Zylal Mahmuti etj. e ngriten kete sherbim ne nivel kompleks te kohes, duke perdorur metoda elektrike, radioaktive, akustike, termike etj. si edhe perpunimin kompjuterik te rezultateve te regjistimeve ne pus. Pa kete sherbim, do te ishte e pamundur te realizohej kerkimi dhe zbulimi i vendurimeve te naftes e te gazit.

Kerkimet gjeofizike te mineralete te ngurta, te mineralete te kromit, te bakrit, te qymyreve, te boksiteve, te fosforiteve, etj, iu ngarkuan nje grupi specialistesh gjeofizike te rind dhe me pak eksperience, por me vullnet dhe deshire per pune. Brenda disa viteve, keta specialisti, dhane prova per efektivitetin e metodave gjeofizike ne ndihme te kerkimeve gjeologjike te mineralete te dobishme. Ata arriten te ngrine ne nivel te kenaqshem, metoda te elektrometrise, te magnetometrise, te gravimetrise se saktesise se larte, te radiometrise dhe te karrotazhit elektrik dhe radioaktiv. Ne kete pune te lavderueshme mund te permenden: Ligor Lubonja, Alfred Frasher, Esat Daja, Zoto Rrjepaj, Llambi Langore, Anastas Dodona, Neim Çavani, Sillo Muçko, Radium Avxhiu dhe nje grup i mrekullueshem teknike operatore.

Arritjet shtyne ne vitin 1970, inxhinjerat Esat Daja dhe Radium Avxhiu te propozonin krijimin e Ndermarres Gjeofizike te Tiranes, propozim i cili u realizua ne janar te vitit 1971. Ndermarra Gjeofizike e Tiranes, per nje çerek shekulli, me mund dhe sakrifika, punoi ne gjithe territoret malore te vendit ne kerkimin e mineraleve. Ne kushte te strehimit ne çadra, i xhiniret dhe tekniket gjeofizike, te ushqyer keq dhe me nje pune rraskapitese, nuk kerkuan shume per vehte, por paisje me aparatura te teknologjise se perparuar. Ishte nje brez i mrekullueshem specialistesh, qe me gjithe izolimin, diten te vene ne pune metodat me moderne te kohes, ku vend te veçante zene metodat e elektrometrise, e sidomos metoden e Polarizimit te Provokuar, per te cilen eshte botuar edhe nje nga tekstet e para ne bote. Ne kete tekstu te perpiluar nga Ligor Lubonja dhe Alfred Frasherri, jepen ilustrimet me arritjet ne vendin tone, duke perdorur nje aparature te pershtatur nga Alfred Frasherri, Esat Daja dhe Radium Avxhiu.

Kerkimet gjeofizike kane kontribut te shquar ne kerkim-zbulimin e vendburimeve te bakrit te Gjegjanit, te Kaçinarit, te Qafbarit, te Lakut te Roshit, te Palucave, te Munelles, etj. Ato kontribuan ne zbulimin e disa vendburimeve te kromit, te boksideve, te qymyreve te Tiranes dhe ne pellgje te tjera.

Ketu eshte mundi dhe i shume specialisteve te tjere si Mihallaq Malaveci, Salvatore Bushati, Pirro Leka, Sami Nenaj, Llesh Prenga, Fatmir Duli, Petrika Kosho, Perparim Alikaj, Aleksander Kospiri, Vojo Dishnica, Safet Dogjani, Vladimir Kavaja, Idriz Jata, Nustret Kastrati, etj. Ne menyre te veçante duhet permendur kontributi i Perparim Alikaj, i mirenjohur ne bote, e veçanerisht ne Kanada, ku metoda e tij e re e prerjes reale per vrojtimin e polarizimit te provokuar, njihet me emrin e tij dhe perdoret ne shume vende me sukses ne kerkimin e mineraleve te bakrit, te arit etj.

Duhet te permend edhe drejtuesit inxhinjeret Xhafer Lezha, Anastas Dodona, Llambi Langore, Mihallaq Malaveci, Fatmir Dule, Asim Zajmi, por edhe te gjithe te tjeret qe per mundesi vendi nuk permendem, inxhiniere dhe tekniket tane te mrekullueshem, gjeologet dhe gjeokimista qe punuan dhe interpretuan bashkarisht. Per kete mjafton te permend se vetem Qendra Gjeofizike e Tiranes, disponon mbi 22 milion matje fushore, te cilat per mungese te teknikes perpunuese te kompjuterizuar, nuk i jane vjele as 50 % e informacionit te mbledhur. Ne arkivat e Qendres Gjeofizike, ndodhet nje material shume vlefshem, i cili mund dhe duhet te riperpunohet dhe te studiohet edhe ne te ardhmen. Kete e theksojme mbasi politikat ekonomike te shtetit te sotem, por edhe ne te ardhmen zor se do te investojne shuma te tilla per kerkimet gjeologjike dhe gjeofizike.

Nje drejtim shume i rendesishem i gjeofizikes eshte edhe sismologjia, e cila levrohet nga Instituti i Sizmologjisë ne Akademie e Shkencave. Sizmologet Akademik Prof. Dr. Eduard Sulstarova, Prof. Dr. Siasi Koçiu, Prof. Dr. Shyqyri Aliaj, Prof. Dr. Betim Muço etj, per disa dhjetevjeçare organizuan ne nivel bashkekohor studimet ne fushat e sizmicitetit dhe monitorimin e ngjarjeve sismike te Shqiperise, te sizmotektonikes, te sismologjise inxhinerike dhe ta inxhinerise se termeteve. Jane realizuar dhe botuar shume monografi, studime, raporte dhe shume artikuj te botuar ne revista shkencore brenda dhe jashte vendit, midis te cilave, veprat me te rendesishme kolektive jane: Rajonizimi sismik i Shqiperise, na dy gjuha shqip dhe anglisht, Katalogu i Termeteve te Shqiperise etj. Sizmologet, qysh ne fillim te viteve 70-te kane marre pjese ne projekte nderkombetare per studimin e sizmicitetit te rajonit te Ballkanit, te Europes dhe te Mesdheut. Nga viti 1999 jane angazhuar ne Projektin "NATO" per paqen per vleresimin e rrezikut sismik.

Paralel me kerkimin e mineraleve ta dobishme metodat gjeofizike u zhvilluan edhe per studimet me karakter gjeoteknik dhe gjeologo-inxhinerike. Instituti i Sizmologjisë realizoi studime te mikrozonimit sismik, qysh ne fillim te viteve '80 dhe deri tani jane realizuar mikrozonime ne shkallen 1:10.000 ose 1:5.000 te disa qyteteve: Tirana, Durresi, Vlorë, Fieri, Korça, Pogradeci, dhe Shkodra si dhe hapesira Tirane-Vore-Durres, ne shkallen 1:25.000. Ne kete drejtim, nje kontribut te veçante kane dhene dhe jepin edhe Seksioni i Gjeofizikes ne Fakultetin e Gjeologjisë dhe te Minierave, si edhe Departamenti i Gjeofizikes se Sherbimit Gjeologjik Shqiptar. Jane studiuar shtrati i lumbit Drin ne vendin ku eshte ndertuar diga e hidrocentralit te Vaut te Dejes, trualli ku u ndertua uzina e plehrave azotike ne Fier, trashea e autostrades Fushe Kruje - Milot, e hekurudhes Milot - Klos, eshte kontrolluar gjendja teknike e digave te hidrocentraleve, jane studiuar vendndertimet e urave te Mifolit, te Matit, te urave te tjera hekurudhere ne Fan, tuneli i Qafe Thanes, etj.

Ne 50 vjetorin e krijimit te Sherbimit Gjeologjik Shqiptar, i cili organizoi kerkimet gjeologjike komplekse te suksesshme, kane ndodhur ndryshime thelbesore ne gjendjen, organizimin dhe drejtimet e zbatimeve te ketyre kerkimeve. Keto ndryshime kane prekur edhe gjeofiziken, e cila gjithashtu duhet te perballoje sfidat e kohes, ne kushtet e ekonomise se tregut.

Aktualisht, ne per gjithesi, behen pak kerkime komplekse te mineraleve te dobishme dhe te kerkimeve te ujit, etj, te cilat permbajne pasuri te padiskuteshme kombetare. Behen pak studime ta mirefillta, atje ku ndertohen godina shumekateshe, ne autostrada dhe rruge automobilistike, ne urat dhe aeroportet, ne studimin e impakteve ne ekosistemet dhe ne monitorimin e mjedisit, te ndotjes se horizonteve ujambajtese dhe te ndertimeve. Dukuri ta tilla sjellin pasoja shume te rrezikshme per vendin, sikurse u vertetua nga permbytjet e ketij viti. Eshte lehtesish e kuptueshme se veprat e ndertuara pa studimet dhe kontrollin e duhur gjeologo-inxhinierik nuk kane garanci per qendrueshmerine e tyre.

Megjithese Qendra Gjeofizike, qe perpara, por sidomos ne vitet 90-te, ka pershtatur plotesisht tekniken dhe metodat gjeofizike per kerkimet hidrogjeologjike, per ato gjeologo-inxhinerike dhe te gjeologjise civile ne per gjithesi, ato perdoren pak ne keto fusha.

Ne ndryshim nga shume institucionet te gjeologjise ne vendet e tjera te Europes Lindore, ne Shqiperi nuk e ruajten ekipet ekzistuese shume te kualifikuar, as laboratoret e gjeofizikes se nafteve dhe te mineraleve te dobishme te ngurta. Ato nuk u ndihmuani per t'u fuqizuar me teknike e teknologji per t'u bere te afta qe te punonin jo vetem ne vend, por edhe jashte shtetit. Faktikisht sot ne Shqiperi vijne e kryejne punime per kerkimin e nafteve e gazit ekipe sismike te huaja, duke perdorur specialiste dhe punonjesit tane.

Prandaj normal lind pyetja, po a mundet qe gjeofizika shqiptare te perballoje sfidat e kohes? Mendimi yne eshte pozitiv. Gjeofizika Shqiptare eshte e afle t'i perballoje keto sfida. Ky mendim mbeshtetet ne arritjet pesedhjete vjecare te gjeofizikes shqiptare, ne kuadrin e kerkimeve komplekse gjeologjike te nafteve dhe te gazit, si edhe te mineraleve te dobishme te ngurta, hidrogjeologjike dhe te gjeologjise inxhinerike. Gjeofizika shqiptare tashme eshte e mirenjohur edhe ne nivel nderkombetare. Per kete mjafton te permendim qe edhe ne vitet nentehjete, gjeofizikanet shqiptare kane paraqitur me sukses rezultatet e studimeve te tyre me te mira ne 260 kumtesa neper Kongrese dhe Konferanca Shkencore Nderkombetare, ku kane marre edhe vleresimet me te mira.

Institucionet gjeofizike te mbetura dhe te reduktuara ne forme drastike prap jane ne gadishmeri qe, edhe ne kushtet e reja, ne interes te vendit, por edhe te institucioneve qeveritare, te ngrene ne kembe sherbimet e domosdoshme ne kushtet e politikave ekonomike te kohes. Ato mund te behen instrumente te punes, te kontrolluara, te oponencave dhe keshillimore te nivitet te larte shkencor per institucionet shteterore dhe publike te interesuara.

KOOPERIMI I SHQIPERISE ME INDUSTRINE NDERKOMBETARE TE NAFTES E GAZIT DHE SITUATA AKTUALE E KERKIMIT DHE PRODHIMIT NE SHQIPERI

Inxhinjer Gjeolog Agron XHAVO

Drejtori i Agjencise Kombetare te Hidrokarbureve

NJE HISTORIE SHKURTER E NAFTES DHE E GAZIT NE SHQIPERI

Historia e industrise se naftes dhe e gazit i ka fillimet e saj ne vitet 1903-1913, kur filluan studimet e para gjeologjike dhe kerkimet e naftes dhe te gazit. Shpimi i pusit te pare u be ne 1918.

Zbulimi i rezervave te naftes ne Shqiperi terroqi disa prej kompanive me te medha te naftes te kesaj kohe, te perfaqesuara nga kompani te tilla Britanike dhe Italiane si SIMSA apo AIPA (Azienda Italiana Petroli d'Albania) dhe D'Arcy Exploration Company Ltd., (UK).

Ne 1925 Qeveria Shqiptare i kaloi koncesione te rendesishme Anglo Persian Oil Co., Societa Italiana Minerarea, Standart Oil Co., of New York, Syndkat d'Etude Franco--Albanais dhe The Financial Group of London.

Marreveshet e para hidrokarbure te lidhura ndermjet Qeverise Shqiptare dhe kompanive te huaja te naftes konsistuan kryesisht ne marreveshet e tipit te koncesioneve. Zbulimet dhe zhvillimet e para te rendesishme ishin ato te vendburimit te Kuçoves.

Pas luftes se Dyte Boterore, perfshirja e kompanive te huaja ne kerkimin dhe zhvillimin e naftes dhe te gazit ne Shqiperi nuk ekzistonte. Bashkepunimi me industrine nderkombetare te naftes u reduktua thjesht ne disa kualifikime, ne shkembimin e eksperiencave dhe pranine e grupeve te specialisteve ruse dhe me vone kineze, prane sherbimeve gjeologjike te naftes dhe mineralave te ngurte.

Megjithë izolimin e Shqiperise nga bota perendimore per pothuajse 50 vjet te regjimit komunist, operacionet hidrokarbure vazduan dhe u intensifikan pasi, duke njohur rendesite strategjike te industrise se naftes, Qeveria Shqiptare i dha prioritet te larte kesaj industrie dhe shteti kontrollonte programin e kerkimit dhe te zhvillimit. Si rezultat, u zbuluan dhe e zhvilluan vendburime te rendesishme te naftes dhe te gazit, sidomos ne pjesen Jug-Perendimore te Shqiperise.

KTHIMI I INVESTIMEVE TE HUALA NE KERKIMIN E NAFTES DHE TE GAZIT

Meqenese sistemi komunist e kuptoi, sidomos pas vitit 1985, qe zhvillimi metejshem i kerkimeve dhe rritja e nivelit teknik e teknologjik nuk mund te behej duke u mbeshtetur ne forcat e veta, Qeveria Shqiptare ndryshoi politiken e saj te izolimit. Si rezultat, ne vitin 1988, Qeveria Shqiptare ndermori hapat e para per t'u hapur dyert kompanive te huaja te naftes dhe te gazit per te investuar ne Shqiperi, duke u bere keshtu Shqiperia nje nga vendet e para ne Evropën Lindore dhe Qendrore qe u hapi dyert investitoreve te huaj. Duke qene se deti Shqiptar ishte nje zone krejtesisht e paeksploruar dhe ku te dhenat mungonin teresisht, ndaj dhe hapja filloj prej tij. Per me teper, ne pjesen tokesore te Ultesires Pranadriatike, shume prane zones se detit ts hapur per kerkim, ishin bere disa zbulime dhe ishin ne prodhim nje numer vendburimesh nafta dhe gazi. Faktor tjeter, dhe i rendesishem, ishte se ne bregun lindor te Italise ishin zbuluar nje numer vendburimesh nafta dhe gazi ne det.

1. Aktiviteti i detit dhe i tokes ne Shqiperi

Raundi i Pare i Detit.

Qeveria Shqiptare organizoi hapjen e Raundit te Pare te detit ne 1989. Si rezultat, nje numar i kompanive nderkombetare te naftes, te tilla si Chevron (SHBA), Hamilton Brothers Co, (SHBA), Agip (Itali), Deminex

Agron XHAVO

(Gjermani), Occidental Petroleum (USA), Total (Franca), Elf Acquitane (Franca) dhe mjaft te tjera, treguan gadishmerine e tyre per te investuar ne kerkimin e naftes dhe te gazit ne detin Shqiptar. Ne perfundim te raundit u nenshkruan kontrata me ndarje prodhimi per 5 bloqet e detit, me kompani te kerkimit te tilla si Occidental Petroleum, Hamilton (me pas BHP), AGIP, Chevron Co., dhe OMV (harta bashkangjitur). Deri tani jane kryer mbi 9,000 km punime sizmike dhe jane shpuar 6 puse kerkimi. Si rezultat, jane identifikuar struktura te ndryshme nafte dhe gazmbajtase dhe pusi "A4- 1X" ka evidentuar grumbullime hidrokarbure, te cilat ne kushtet aktuale nuk jane gjykuar komerciale per t'u shfrytezuar. Nje zbulim i ri ne kete zone do t'a ktheje ata te shfrytezueshem. Investimi total i bere ne detin Shqiptar, nga kompanite e siperpermendura arrin ne mbi 145 milion USD.

Raundi i Pare i Tokes

Ky Raund u hap ne vitin 1992 dhe ne te u ofruan 6 bloqe, te lokalizuar kryesisht mbi Ultesiren Pranadriatike. Ne perfundim te ketij raundi u lidhen 3 marrveshje per 4 bloqe, si me poshte:

- Per Bllokun "C" me kompanine INA-NAFTAPLIN;
- Per Bllokun "E" me kompanine COPAREX;
- Per Blloqet "B" dhe "F" me kompanine SHELL.

Aktualisht operohet ne dy bloqe:

- Ne Bllokun "C" nga Kompania INA-NAFTAPLIN,
- Ne Blloqet "D" dhe "E" nga Kompania COPAREX.

Raundi i Dyte i Tokes

Ne kete raund, i cili u hap ne vitin 1995, u ofrua per kerkim e gjithe siperfaqja e paliçensuar e Shqiperise, qe perbehej nga tete bloqe te reja dhe dy bloqe te mbetura nga raundi i pare. Ne perfundim te ketij raundi u lidhen 6 marrveshje per 7 nga 10 blloqet e ofruara:

- Per Bllokun 2, 3 dhe A u lidhen tre marreveshje me Kompanite OCCIDENTAL, FOREST OIL dhe LUNDIN OIL.
- Per Blloqet 1, 4 dhe 5 u lidhen marreveshje me OMV, ENTERPRISE OIL, CLYDE dhe MOL.
- Per Bllokun "D" u lidh nje marreveshje me Kompanine COPAREX

Bazuar ne Ligjin "Mbi Hidrokarburet (Kerkimi dhe Prodhimi)", AKH ka Liçensuar Albpetrolin par aktivitet te perbashket me kompanite e huaja na 4 bloqe kerkimi, te cilet aktualisht jane ne administrim te Albpetrolit, si dhe ne vendburimet ekzistuese:

1. Liçensen e prodhimit per vendburimin e Patos-Marinzes dhe zonen e kerkimit te Dumrese.
2. Liçensen e prodhimit per vendburimin e Gorisht-Koculit.
3. Liçensen e prodhimit per vendburimet e Ballsh-Hekalit dhe Cakran-Mollaj.
4. Liçensen e kerkimit per bllokun e Velçes.
5. Liçensen e kerkimit per bllokun e Panajase.
6. Liçensen e kerkimit dhe prodhimit per bllokun e Delvines.

Ecuria e ketyre Liçense - Marreveshjeve jo ne te gjitha rastet ka qene e suksesshme dhe Albpetroli tashme operon, ne bashkepunim me kompanite e huaja, vetem ne vendburimin e Patos-Marinzes dhe ne bllokun e Panajase.

POLITIKA E QEVERISE SHQIPTARE PER NAFTEN DHE GAZIN.

Politika e Qeverise Shqiptare per sektorin e naftes dhe te gazit, ne menyre konstante dhe te pandryshuar prej mese 10 vjetesh, konsiston dhe synon arrijten e objektivave te meposhtme:

1. Hapjen e industrise se naftes dhe te gazit ndaj konkurrences te lire dhe liberalizimit te tregut hidrokarbur.
2. Inkurajimi i investimeve te huaja te naftes dhe te gazit nepermjet krijimit te nje legjislacioni me fleksibilitetin e duhur dhe inkurajues.
3. Inkurajimi i thithjes se investimeve te huaja nepermjet hartimit te nje legjislacioni atraktiv ne lidhje me regjimin fiskal dhe taksat.

REZULTATETE ARRITURA PER SHKAK TE NDRYSHIMIT TE POLITIKES.

Deri tani, ky qendrim i ri ndaj investimeve te huaja ne fushen e naftes dhe te gazit kane sjelle zhvillime pozitive, dhe konkretisht:

2. Ne Det

Duke bere nje permblehdje te shkurter te aktivitetit te kompanive te kerkimit te naftes ne det do te theksojme se gjate ketyre viteve, nga kompanite e huaja jane investuar ne kete aktivitet rreth 144 992 027,00 \$. Keto operacione perfaqesohen, pavec studimeve dhe pergjithesimeve te ndryshme gjeologo-gjeofizike, si me poshte:

- 9200 km punime sizmike,
- 4379 km punime gravimetrike,
- 2220 km punime magnetometrike dhe
- 1659 km punime batimetrike,

Gjithashtu jane shpuar 21628,80 ml.

Si rezultat i ketyre investimeve jane prognozuar disa objekte perspektive per naftë e gaz:

Veç pusit "A4- 1X", qe cituan me siper, jane evidentuar 21 struktura, nga te cilat 10 ne depozitimet terrigjene dhe 11 me objekt ne gelqerore. Nga keto struktura 9 prej tyre konsiderohen me mjaft interes dhe do te perbejne nje objekt te rendesishem te punes se AKH per t'i promocionuar ne te ardhmen.

3. Ne Toke

Jane kryer rreth 2100 km punime sizmike ne kontratat e realizuara ne te dy raundet e Licënsimit ne toke, me nje vlere rreth 30 milion USD, si dhe eshte duke u shpuar pusi i katert i kerkimit prej kompanive te huaja. Jane evidentuar me shume se 25 prospekte, nje pjese e te cilave jane atakuar keto pese vitet e fundit dhe 3 prej tyre pritet te atakohen gjate vitit 2003.

Dhe ajo qe eshte me e rendesishmjë, qe ne fund te fundit materializon dhe i ben te prekshme keto investime, eshte zbulimi i deklaruar nga kompania amerikane Occidental ne strukturen e Sqepurit, Berat. Ky zbulim eshte i rendesishem per ne jo vetem se jemi shume prane zbulimit te nje vendburimi naftë, por edhe per faktin e padiskutueshem te ngritjes dhe bazueshmerise me te larte te kerkimit ne kete brez strukturor. Njeheresh ai konfirmoi perseri saktesine e interpretimeve dhe konkluzioneve shkencore te paraqitura prej studjuesve shqiptare.

Pas kryerjes se nje studimi serios lidhur me rezervuarin, ne menyre qe te behet i mundur komercializimi i ketij zbulimi, per vitin ne vazhdim eshte planifikuar dhe do te punohet per shpimin e nje pusi te thelle kerkimi, krahas nje volumi te konsiderueshem punimesh sizmike ne rajone ku pergjithesisht nuk jane kryer me pare.


Eshte ne shpim nje pus i thelle kerkimi ne strukturen e Panajase, nga kompania kroate INA-Naftaplin, i cili pritet te perfundoje ne fillim te vitit 2003, dhe qe shpresojme te konkretizohet me nje zbulim te ri.

Akoma me ambicioze jane synimet e kompanive per vitin e ardhshem. Jane planifikuar te shpohen tre puse kerkimi, dy prej te cileve te thelle, si dhe nje sasi e konsiderueshme profilesh sizmike.

Nje perfitim jo i vogel eshte edhe informacioni gjeologo-gjeofizik i bollshem i perfthuar nga ky bashkepunim, kualifikimi i metejshem i specialisteve shqiptare nepermjet angazhimit te tyre ne pjesen me te madhe te projekteve, shkembimi i eksperiencave dhe vizioneve mbi ndertimin gjeologjik te territorit shqiptar, si dhe futja e teknikave dhe teknologjive te reja, si ne kerkimin ashtu dhe ne nxjerrjen e hidrokarbureve, dhe azhornimi i specialisteve shqiptare me to.

Duke qene se kjo konference zhvillohet ne kuadrin e nje sere aktivitetesh kushtuar 50 vjetorit te Sherbimit Gjeologjik Shqiptar, do te doja te theksoja ne menyre te veçante se pergjithesimet dhe rezultatet e studimeve dhe puseve te shpuar kane konfirmuar pergjithesisht idete dhe modelet gjeologjike te paraqitura ne vite nga specialistet shqiptare. Gjithashtu ballafaqimi i specialisteve tane me ata te huaj ka qene mjaft dinjitoz dhe i vleresuar nga nje sere drejtuesish te kompanive te huaja qe kane punuar e punojne ne Shqiperi.

ALBANIA Licensed Exploration Areas



PËRSHËNDETJE

Në radhë të parë dëshiroj t'ju falenderoj për mundësinë që më dhatë të përshëndes këtë takim jubilar. Po të shprehem me termat e gjeologut do të thoshja që pas një periudhe në hapje (riftingu) për gjeologjinë shqiptare, tani ajo ndodhet në një periudhë ndrydhjeje (kompresioni) prandaj duhet të mendojmë për perspektivën sa nuk është vonë.

Duke qenë se objekti kryesor i punës sonë si gjeologë naftë është kërkimi i naftës dhe i gazit në territorin e vendit tonë, atëherë për perspektivën (të paktën për periudhën 2003 - 2005) ne gjeologë dhe specialistë të naftës do të punojmë për:

Evidentimin e strukturave perspektivë naftëgazmbajtëse në territorin e Republikës;

Rritjen e rezervave të gazit në UPA;

Thellimin e njohjes në blloqet e Albpetrolit;

Gjithashtu do të punojmë për

Eleminimin e ndotjeve të ujравe sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nga hidrokarburet dhe mbetjet e tyre;

Infrastrukturën në grumbullim, transport dhe tregëtimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj;

Në fushën e ruajtjes së mjedisit nëpërmjet monitorimit dhe projekteve konkrete;

Informatizimin e të dhënave gjeologo – gjeofizike të të gjithë materialit fundor etj.

Po i përgjigjen edhe pyetjes:

Si dhe ku do ta kërkjmë naftën në Shqipëri?

Përgjigje pozitive edhe ka edhe s'ka; unë po ju parashtroj disa prej tyre. Ja kam shtruar pyetjen vehtes; si ta kërkjmë naftën sepse naftë ka, specialistët e Institutit e kanë zbuluar, Albpetroli, ARMO e shfrytëzojnë atë, ka akoma për të zbuluar dhe për këtë duhen shpuar puse kërkimi pasi të janë bërë studimet. Por jam i ndërgjegjshëm që Shteti nuk mund të financojë shpimin e puseve të reja të kërkimit, dhe Albpetroli si kompani kërkimi nuk mund t'i financojë, por fare mirë si Shteti dhe Albpetroli duhet të financojnë studimet e reja për kërkimin e hidrokarbureve. Në fondin tonë ka materiale studimore që para 15 – 20 vjetësh ku janë përcaktuar edhe rajonet prognozë. Në atë kohë kërkohet që të bëhen profile të rindës sismikë që sot nuk mund t'i bëjnë për arsy financiare, por sot, pa hequr asnjëherë dora nga çekiçi dhe busulla, të paktën të na krijohen kushte që të rishikojmë me mijete të fuqishme kompjuterike ato profile. Prandaj po e theksoj që me fonde Shteti duhet të financojnë për kërkimet ose më saktë studimet për kërkimin e hidrokarbureve të lëngët dhe të gaztë.

Aktualisht Albpetroli po kërkon në zona të njohura që tashmë shfrytëzohen, shfrytëzimi i tyre bëhet edhe me metoda të pastudiuar, jo shkencore nga kompanitë e huaja. Ka gjithashtu shfrytëzim pa kriterë dhe pa ruajtje të vendburimeve. Prandaj naftën mund ta kërkjmë edhe duke ruajtur, duke shfrytëzuar më mirë ato vendburime që kemi dhe për këtë duhen studime dhe sidomos vënia e tyre në jetë.

Fondi studimor që disponon Qendra jonë si dhe gjithë sistemi i naftës është thesar i paçmuar, mbulimi i territorit me të dhëna bruto është shumë i lartë, por gjithë ky material është vështirë të konsultohet në këtë gjendje, në mos është e pamundur. Bota përdor metoda të sofistikuara për shfrytëzimin e materialeve fondore dhe të dhënave bruto, ne nuk kemi filluar akoma. Edhe duke shfrytëzuar këto materiale nxirret naftë, sepse risim besueshmërinë me partnerët e vendit dhe të huaj. Prandaj të realizojmë sa më shpejt dhe me mijete të kohës shfrytëzimin sa më maksimal të të dhënave fondore. Kushtet teknike mund të financohen edhe nga Ministria, mendja e gjeologut duhet të bëjë përgjedhjen. (Dua t'ju them se shumë të dhëna na kanë fluturuar privatish jashtë shtetit).

Jemi të ndërgjegjshëm që shkejncë për shkencë nuk mund të bëjmë, por shkencën për Shqipërinë në fushën e hidrokarbureve jemi ne që e kemi bërë dhe do ta bëjmë. Por si do ta bëjmë?

Ministria duhet të na financojë edhe studime me problematikë të caktuar (p.sh. problemet që kanë dalë nga harta, etj.).

Për të qenë më afér shkencës së naftës në botë na duhet të komunikojmë me homologët tanë, por edhe të kualifikohemi.

Duhet të marrin në punë specialistë të rinj, për të siguruar perspektivën.

Duhet t'u krijojmë të gjitha kushtet dhe me përulje t'u kërkojmë të gjithë gjeologëve të moshuar, të na lënë të shkruar kujtimet dhe eksperiencën e tyre.

Është e natyrshme që sot hidrokarburet në vendin tonë shfrytëzohen tërësisht për energji dhe ligji i ekonomisë së tregut vepron mbi to. Karakteristikat petrofizike të hidrokarbureve tanë janë të përshtashme për tu përdorur si lëndë e parë në industrinë kimike, prandaj duhet të vazhdojmë t'i këkojmë që sot që t'i përdorin brezat e ardhshëm kur nafta do të jetë më e shtrenjtë se floriri.

Të gjitha sa thashë më sipër janë disa përgjigje të pyetjes se si dhe ku mund të kërkjmë naftë dhe dua t'ju ritheksoj se nuk duhet t'i nënshtron hemi periudhës së ndrydhjes, atë duhet të paktën ta ndalojmë.

Së fundi, më duhet të theksoj se gjeologët tanë meritojnë një trajtim më të mirë financiar dhe kushte më të mira pune, që edhe puna shkencore të jetë sa më rezultativ.

Ju faleminderit

Kristaq MUSKA

Drejtor i Qendrës Kombëtare të Hidrokarbureve Fier

PERGATITJA DHE KUALIFIKIMI I SPECIALISTEVE TE GJEOSHKENCAVE

Prof. Dr. Selam Meço

Dekan i Fakultetit te Gjeologjise dhe Minierave

Fakulteti i Gjeologjise dhe i Minierave ka tashme një tradite 50-vjeçare. Fillimi i këtij fakulteti është i lidhur me Institutin e atershem Politeknik dhe me pas si dege e Fakultetit te Inxhinierise ne Universitetin e Tiranës (1957). Duke filluar nga viti 1962 e deri sot, pra plot 40 vjet ai funksionon si Fakultet me vehte. Fakulteti yne eshte e vërtetë e shkollës së lartë universitare dhe pasuniversitare ne fushen e Gjeoshkencave ne vendin tonë dhe gjatë gjithe historise se tij ka perballuar veshët e medha, por e cila ka realizuar detyra shume te rendeshishme.

Dinamika e zhvillimit te Fakultetit ka qene per gjithësisht tepër e Shpejtë

Duke pasur parasysh nevojat e ekonomise se vendit ne vite, ne fusha te tilla kryesore si ajo e gjeologjise se mineralev te ngurte dhe ajo e gjeologjise se hidrokarbureve, Fakulteti yne qysh ne themelimin e tij eshte konceptuar si një shkollë inxhinierike që ka pergatitur kuadro, te cilet kane punuar kryesisht ne kerkim-zbulimin e mineralev te dobishem ne te gjithe vendin.

I orientuar fillimi i këtij fakulteti nga planet dhe programet mesimore te shkollave lindore, me kalimin e viteve, gradualisht e gjithmone e me tepër orientimi dhe atrimi po behet drejt shkollave te larta perendimore, te cilat siç dihet janë ne nivele shume te larta e tepër moderne.

Qe nga themelimi i tij si dege e Institutit Politeknik dhe e Fakultetit te Inxhinierise eshte drejtuar nga pedagoge te shquar si Eshref Pumo, Zihni Sinojmeri e Ziver Meko dhe me krijimin si Fakultet nga dekane shume te respektuar e te afte Si Rexhep Reka, Eshref Pumo, Nikolla Konomi, Andon Grazhdani, Muhamet Doracaj, Fotaq Diamanti, Thoma Korini e Spiro Thodhorjani.

Kuadrot qe kane perfunduar kete Fakultet e qe janë diplomuar si inxhiniere janë te shumte e te larmishem ne profesionin e tyre. Gjate historise 50 vjecave dinamika e specialisteve eshte si vijon: Gjithesej kane perfunduar studimet ne Fakultet 4131 inxhiniere. Sipas degeve ndarja eshte si me poshtë vijon: Inxhiniere gjeologe per mineralet te ngurta- 1227, inxhiniere gjeolog naftë 308, inxhiniere gjeofizike- 257, inxhiniere miniere - 831, inxhiniere markshajder- 250, inxhiniere pasurues- 165, inxhiniere prodhues naftë e gazi- 492 dhe shpues -601.

Per keto arritje kane punuar me perkushtim, dije dhe energji trupi pedagogjik efektiv dhe shume pedagoge jo efektive nga institucionet te ndryshme te gjeologjise. Midis tyre permendim Profesoret e shquar Injac Gj. Ndoja, Servet Pasho, Hajredin Shtino, Luan Peza, Ligor Lubonja, Vangjel Melo, Dhori Kote, Sotir Guxha, Minella Hido, Besnik Ostrosi, Alfred Frasherri, Artan Tashko, Aleksander Vranaj, Andon Grazhdani, Skender Osmani, Pertef Nishani, Rushan Liço, Vasil Jorgji, Agim Sinoimeri etj.

Aktualisht vazhdojnë Fakultetin 429 studentë nga te cilet ne degen e gjeologjise (xeherore e naftë se bashku) - 152 vete, ne Inxhinierine e Burimeve Minerare - 94 veta, ne Inxhinierine e Burimeve te Energjise - 118 vete dhe ne Gjeofizike - 65 vete.

Fakulteti ne vite, perfshi edhe vitet e fundit ka kualifikuar e specializuar kuadro pasuniversitare edhe ne fusha me te ngushta si ato te : petrografise, gjeokimise se naftes, gjeokimise, paleontologjise, rilevimeve, sismikes, hidrogjeologjise, gjeologjise inxhinierike, projektim-ndertim minera, ndertime minerare, nxjerrje e naftes, teknologjia e shpimit te puseve ne zona me presione anormale, teknologjia e shpimit te puseve etj. Numri i specialisteve te pergatitur ne keto fusha eshte i konsiderueshem dhe, duke perfshire edhe kursin 1 vjeçar te para dy vjeteteve ne fushat e gjeologjise inxhinierike, hidrogjeologjise dhe gjeologjine e mjedisit arrin ne 167 vete.

Ne Fakultetin e Gjeologjise dhe te Minierave ka funksionuar dhe se shpejti do te rihapet Shkolla Pasuniversitare (SHPU) ne fushen e gjeoshkencave, ku kane arritur te kualifikohen e te fitojnë graden e

Doktorit te Shkencave jo vetem punonjes te Fakultetit, por nga i gjithe vendi, madje edhe jashtë kufijve shteterore siç janë ata nga Universiteti i Prishtines apo Maqedonia.

Aktualisht FGJM, sikurse te gjitha shkollat e tjera te vendit, funksionon mbi baze departamentesh, ku funksionojne 4 te tille: Departamenti i Shkencave te Tokës, Departamenti i Gjeologjise se Zbatuar dhe Mjedisit, Departamenti i Inxhinierise se Burimeve Minerare, Departamenti i Inxhinierise se Burimeve te Energjise dhe Sektori Shkencor i Gjeologjise. Aktualisht ushtrojne aktivitetin pedagogjik e shkencor gjithesej 41 kuadro te larte, te kualifikuar si vijon: profesore 14, profesore te asociuar 10, mjeshter kerkimesh 2, Doktor i Shkencave 11, pedagoge 2, asistente 2. Fatkeqesish duhet te veme ne dukje se qysh nga viti 1992 e deri me sot janë larguar gjithsej 45 vete, nga te cilet 38 janë vendit, ne emigracion dhe 7 te tjere ne institucionet te tjera brenda vendit. Nga te larguarit janë vendit, disa prej tyre, por keta janë pak, punojne ne specialitetet e tyre. Theksojme se dukuria e emigracionit na ka derriuar shume, sepse janë larguar kuadro te specializuar e kualifikuar ne perendim, shume prej tyre me grada e tituj shkencore dhe ne moshen me efektive. Ne Fakultetin tone funksionojne një numer i caktuar laboratoresh te cilet perbejne një baze te rendeshishme si per realizimin e procesit mesimor ashtu edhe per pune kerkimore. Laboratoret ne fjale janë te shperndare sipas te gjithe departamenteve dhe ne total janë 37 te tille, ku punon një staf relativisht i kualifikuar laborantesh.

Gjate gjithe dinamikës se zhvillimit te Fakultetit, pavaresisht ruajtjet se diplomimit si inxhiniere, janë bere edhe mjaft nderhyrje e permiresime ne planet mesimore. Mbës një nderprerjeje disa vjeçare te pajustifikueshme, ne vitin akademik 2000-2001 u rihap dega e gjeofizikes, e cila tashme ka arritur ne vitin e trete te riekzistences se saj. Ne vitin akademik aktual 2002-2003, mbës shume perpjekjesh eshte hapur opzioni i manaxhimit, i cili funksionon ne vitin e peste (te fundit) dhe perfshin studentet me te mire te çdo profili e dege. Ne departamente te ndryshme janë futur lende te reja si GIS, Gjeomorfologjia dhe Gjeologjia e Kuaternarit, Gjeostatistika, etj.

Fakulteti yne ne kuadrin e gjithe Universitetit Politeknik, aktualisht po pergatitet per te zbatuar sistemin e kreditimit, qe do te jape mundesi per levizjen e lire te studenteve neper universitetet evropiane si edhe Konventa e Bolonjes, e cila parashikon shkallëzimin 3 e 5 vjeçar ne pergatitjen e kuadrit.

FGJM gjate gjithe ekzistences se tij eshte perpjekur te mbaje lidhje e te realizoje projekte te perbashketa me shume universitetet perendimore e amerikanoveriore e sidomos me Universitetin e Prishtines. Shume pedagoge te Fakultetit tone kane vizituar universitetet te huaja per marrje pervoje dhe kualifikime e specializime te ndryshme, por edhe shume profesore, shkencetare perendimore kane dhene pervojet e tyre ne procesin mesimor dhe punen kerkimore.

Aktualisht Fakulteti ka projekte te perbashketa me universitetet gjermane, italiane, belge, franceze, austriake, greke, kanadeze etj.

Ne jemi te ndergjegjshem se Fakulteti yne si Fakultet i perbashket i gjithe specialisteve te gjeoshkencave ne Shqiperi krahas arritjeve ka edhe shume probleme. Keto probleme mund e duhet te zgjidhen bashkarishë edhe me Sherbimin Gjeologjik Shqiptar, edhe me Qendren Kerkimore Kombetare te Hidrokarbureve (ose Institutin Gjeologjik te Naftes e Gazit) edhe me Institutin e Minierave, edhe me kompanitë apo shoqeritë anonime qe operojne ne Shqiperi ne kuadrin e Gjeoshkencave.

Ne e konsiderojme, dhe mendoj se keshtu mendojne te gjithe specialistet, se Fakulteti eshte shtepia jone e perbashket, pavaresisht nga vendi i punës aktual te gjithesecilit prej nesh, prandaj ky Fakultet duhet konsideruar si pjese perberese e Sherbimit te Gjeologjise, e Gjeologjise se Naftes e Gazit dhe aktivitetit minerar. Kur themi pjese perberese kemi parasysh jo vetem thjesht anen shpirtore e morale te ketyre institucioneve, por konkretisht bashkepunimin ne fushen e tematikes, te projekteve, te fondeve per ngritjen e nivelit te infrastrukturës ne Fakultet etj.

Ne mendojme se ka ardhur koha qe Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, Qendra Kerkimore Kombetare e Hidrokarbureve, Institut i Minierave te kene një strategji te qarte te pakten per një periudhe 10-15 vjeçare, se ne cilat drejtime do te punohet me tepër se çfarë specialistesh do te jene me te nevojshem sipas fushave te ndryshme, duke vene një theks te veçante psh ne fushen e mjedisit apo në drejtime te tjera.

Ne kete kuader edhe ne si Fakultet duhet te rishikojme se si duhet te perqatiten specialistet e ardhshem, se ndoshta krahas atij inxhinierik klasik, duhen edhe drejtime e profilizime te reja. Por keto mund e duhet te realizohen me kontributin mendor e intelektual te te gjitheve.

Ne mendojme se Ministria e Industrise dhe Energetikes dhe Qeveria duhet ti konsiderojne Gjeoshkencat si albanologji. Gjeologjine e Shqiperise ne tere kompleksitetin e saj do ta bejne mire vetem shqiptaret. Te gjithe e dime sa eshte investuar ne kete vend, sa eshte investuar per gjeologjine qofte ne njerez, qofte ne burime monetare, sa vete jane sakrifikuar e flijuar per ti sherbyer vendit.

Eshte e palejueshme qe ne mjaft raste, nga ana e organeve kompetente te konsiderohet Fakulteti i Gjeologjise dhe i Minierave, si nje Fakultet i dores se dyte sa qe ka pasur tentativa edhe per ta larguar nga godina e sotme, ku ka kabinete dhe laboratore moderne te ngritur edhe me projektet e UNESCO dhe te Komunitetit European.

Per fatin e mire te shqiptareve, Shqiperia eshte nje vend i pasur me minerale te dobishme nentoktsore, por edhe mbi toke, dhe pavaresisht nga kostoja qe duhet per shfrytezimin e tyre ne periudhen aktuale, ato nje dite do te shfrytezohen ne dobi te shqiptareve.

Ka ikur nje here e mire ndonje mendim se Gjeologjine e Shqiperise do ta bejne disa shtegtare apo firma te huaja, te cilat vijne ne Shqiperi me objektiva te caktuara dhe me kontrata dhe afate po te caktuara. Gjeologjine e Shqiperise, ne rradhe te pare e mbi te gjitha, ashtu si gjuhen meme shqipen, e kane bere, e bejne e do ta bejne shqipetaret.

Ne kete rast jubilar, qe na gezon te gjitheve, gjej rastin te ve ne dukje, dhe kjo vlen ne rradhe te pare per organet qeveritare, se gjeologji nuk eshte vetem shfrytezimi fjala vjen i nje miniere kromi apo bakri, nuk eshte vetem shpimi i puseve te kerkimit per nafte ne thellesi 5000-7000 m, qe ne fillim te prishin mendjen se kane kosto te larte dhe vendi yne ne periudhen aktuale nuk ka mundesi te investoje, por gjeologjia ka nje diapazon shume me te gjere, qe i duhet pikerisht ekonomise se tregut, i duhet shoqerise shqiptare sot. Ne duhet te nenvizojme me force para qeveritareve se gjeologjia eshte turizem, eshte rruge, eshte uje, eshte mjedis, eshte mbrojtje nga rreziqet etj. etj. Pra Gjeologjia eshte nje shkence qe ve ne levizje shoqerine e sotme, eshte nje force krijuese per progres.

REZOLUCION

I KONFERENCES : 50 VJETORI I SHERBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

MIRATUAR NJE ZERI NGA PJESEMARRESIT E KONFERENCES, TIRANE 1 NENTOR 2002

Paraqitur nga Prof. Dr. Gjergji Foto

Fakulteti i Gjeologjise dhe i Minierave, Sekretari Shkencor i Bashkimit Shqiptar te Gjeoshkencetareve dhe Inxhinjereve.

Konferanca jubilare "50 Vjetori i Sherbimit Gjeologjik Shqiptar" u mbajt ne Tirane, me date 1 Nentor 2002, ne zbatim te detyrate te Kongresit te 8-te te Gjeoshkencave ne Shqiperi, me pjesemarjen e mbi 500 specialisteve dhe shkencetareve te fushave te ndryshme te kerkimeve gjeologjike nga i gjithe vendi, Ministri i Industrise dhe Energifikes Inxhinieri gjeolog Viktor Doda, perfaqesues te Drejtorese se Minierave dhe Mineraleve prane UNMIK, te KEK dhe Universitetit te Prishtines nga Kosova, perfaqesues diplomatike te disa ambasadave te akredituara ne Tirane, specialiste te kompanive te huaja qe kryejne kerkimet gjeologjike te naftes dhe te gazit ne Shqiperi etj.

Konferanca, nepermjet disa referateve e perqendroi vemendjen ne kontributin qe ka dhene gjeologjia ne zhvillimin ekonomik dhe mireqenien e Shqiperise, ne vendin e merituar qe ka zene gjeologjia shqiptare ne zhvillimet e shkences se gjeologjise ne teresi por edhe ne aftesite potenciale te saj per te mbeshtetur strategjite afatgjata te shtetit per evidentimin e ketyre potencialeve, ruajtjen zhvillimin e metejshem te te gjithe pasuri te minerale, te naftes e te gazit, ujerave dhe venien e tyre ne perdom per te mbeshtetur zhvillimin e metejshem ekonomik, por edhe zvogelin e problemeve sociale me te cilat eshte lidhur edhe periudha e tranzicionit.

Ne kete konference e evidentua gjithashtu roli i kompanive te huaja ne kerkim -shfrytezimin e pasurive minerale dhe te naftes e gazit ne dhjetevjeçarin e fundit, si edhe u konfirmua nevoja per krijimin e te gjitha kushteve te nevojshme per te rritur pjesemarjen e tyre ne punen per aktivizimin e te gjitha rezervave potenciale te nentokes sone, ne bashkepunim te ngushte me specialistet dhe shkencetaret shqiptare.

Konferanca evidento arritjet ne fushen e perqatitjes dhe te kualifikimit te specialiteve te fushave te ndryshme te gjeoshkencave.

Konferanca konstatoi dhe u rekomandon organeve shteterore sa me poshte vijon :

Eshte e domosdoshme qe te reformohen strukturat gjeologjike te vendit, qe te vene me mire ne eficience ate kontigjent specialistesh dhe shkencetaresh te gjeoshkencave, te perqatitur dhe te perkushtuar per pune dhe per vendin, pervojen e pasur te tyre dhe rezultatet e shkelqyera ne veprimtarine e deritanishme. Tashme, te çliruar nga politizimet mund te arrihen rezultate te shpejta per te perballuar sfidat e shumta te ekonomise se tregut.

Nuk ka fushe te veprimtarise ekonomike ku te mos jene ne themel rezultatet e punes se gjeologeve, nuk ka fushe te ekonomise qe te siguroje ate nivel te ardhurash per njesine e mjeteve financiare te shpenzuara. Studimeve dhe kontolleve gjeologjike komplekse duhet ti jepet vendi i duhur edhe ne zgiidhjen e te gjitha problemeve te infrastruktureve, te njobjes, ruajtjes dhe mbrojtjes se mjedisit, te administrimit te territorit etj. Gjeologjia e ka vertetuar vehten gjithashtu se eshte e afte te perfshi ne pune nje mase te konsiderueshme te forcave te punes, duke kontribuar keshtu ne rritjen e drejtperdrejtje te mireqenies dhe nivelit kulturor edhe ne skutat me te thella te vendit. Keto potenciale te gjeologjise ende nuk Jane programuar te shfrytezohen ne maksimum nga qeverite e tranzacionit.

Ne jemi krenare per arritjet dhe kontributin qe kemi dhene per kete vend, por edhe te heshtur e ne pritej ndaj trajtimit jo ne nivelin qe i perqigjet perfitimeve qe ka patur ekonomia shqiptare nga veprimitaria jone. Konferanca shpreson se ajo do te sherbeje per te terhequr vemendjen e vendimarresve.

RIVLERESIMI I VENDBURIMEVE TE BAKRIT TE RAJONIT PERLAT-MUNELLE

Viktor Doda*, Lirim Hoxha**

ABSTRAKT

Artikulli trajton probleme te gjeologjise, metalogenjise, tektonikes dhe disa çeshtje ekonomike te rajonit Perlat-Munelle, nje nga me te rendesishmit ne pikepamje te xehoreve te zbuluar dhe resurseve te mundshem.

Ofiolitet e ketij rajoni jane pjese perberese e Brezit Ofiolitik Lindor te Shqiperise te pranuara si te formuara mbi zonen e subduksionit (ZSS), me tipare te dallueshme petrografike, petrologjike, xehore dhe tektonike. E kahasuar me prerjen e idealizuar te ofioliteve (pjeshemarresit e Konferencës Penrose, 1972) pjesa veriore e rajonit (Reps-Munelle/Qafe Mali) paraqet ndryshime te rendesishme ne pikepamje petrologjike, te stilit te mineralizimeve dhe veçanerisht tektonikes, pavaresisht moshes se perafert te ketyre ofioliteve (Jurasik i mesem-fillimi i Jurasikut te siper). Nisur nga kjo pikepamje, vetem segmenti Reps-Munelle (Qafe Mali) mund te kahasohet me prerjen Penrose, ndersa sektori i vendburimit Perlat-Kurbnesh, nisur nga natyra boninitike e ketyre vullkaniteve, duhet te perfaqesoje nje stad me te hershem te ofioliteve te ZSS.

Prerjet e segmentit Reps-Munelle (Qafe Mali), si ne pikepamje petrologjike dhe ne ate te stilit te mineralizimeve jane te ngashme me ato te ofioliteve te Lindjes se Mesme (Qipros dhe Omanit) pavaresisht nga mosha me e vjeter e ofioliteve shqiptare, duke u njesuar qe te tre me prerjen e idealizuar te ofioliteve. Ngashmeria e stilit te mineralizimit, veçanerisht te pjeses veriore (Reps-Munelle/Qafe Mali) me "tymuesit e zi/bardhe" qe formohen aktualisht ne kurrioren mes-atlantike, ne pikepamje te unitetit te xehoreve masive me ata shtokverkore dhe perberjes lendorre te elementeve kryesore eshte gjurmelenese.

Ne ndryshim nga radha tradicionale e pranuar e formimit te sulfureve tek ne, pirit-kalkopirit-sfalerit, mbeshtetur ne studime dhe vrojtime te fundit te literaturore, do te sugeronim kete radhe formimi: ne stadin e pare, sfalerit+galenit+pirit+barit, ne rreth 200 °C dhe ate te fundit, pirit+kalkopirit+kuarc, ne rreth 300-350 °C.

Matjet e fundit te izotopit $\delta^{34}\text{S}$ jane ne perputhje me percaktimet e bera me pare dhe tregojne qe fluidet magmatike kane gjeneruar mineralizimet sulfure.

Studimet per kete rajon, ne perputhje edhe me ato te bera me pare, flasin se xehoret sulfure janë formuar nga fluide me origine magmatike.

Tektonika mbulesore ka luajtur nje rol te rendesishem ne formimin e tipareve gjeologjike te te gjithe rajonit dhe veçanerisht sektorit Perlat-Kurbnesh. Kjo tektonike e ka fshehur vazhdimesine direkte jugore te segmentit verior Munelle-Reps. Perseritja disa here ne prerje e mbihipjeve deri te niveleve me te poshtme gabro-diorite-ultrabajke te ofioliteve, gjate orogenezes Jurasike-Kretake, eshte ndjekur nga formimet e fllshit te Berriasian-Valanzhinianit i cili mbihihet nga ultrabajket, te cilet nga ana e tyre mbulohen transgresivisht nga depozitimet karbonatike te Barremian-Aptianit.

Evidentimi i tektonikes mbulesore eshte shfrytezuar me sukses si mjet per kerkimine mineralizimeve sulfure nen keto rrufshe.

Nga kahasimi i rezervave te zbuluara ne ofiolitet shqiptare me ato te Lindjes se Mesme (Qipros, Omanit dhe Turqise) rezulton se ne ato shqiptare jane zbuluar me shume rezerva. Ne pikepamje te perberjes lendorre dhe elementeve te çmueshem (Au, Ag) ka ngashmeri te dukshme.

Nisur nga fakti se, bashkeshoqerimi sfalerit-kalkopirit-pirit, kryesisht masive, ka patur mbi 3g/t Au (p.sh. ne Gurth Spac), edhe gjate shfrytezimit ky tip duhet seleksionuar si dhe duhet te vleresohen dhe zonat argjilore me pak sulfure. Tipi piroline-kalkopirit-kuarc (Kurbnesh) apo tipi Cu-(Au-Pt) ne gabrot e

shtresezuar te Omanit duhet te jete objekt i një kerkimi te kujdeshem, ne pjesen e gabrove shtresore (Qafe Mali-Kurbnesh).

Aplikimi i një modeli financiar ne industrine e bakrit si dhe permiresimet ne Legjislacionin Minierar janë te domosdoshem per ringjalljen e ketij sektori te ekonomise.

HYRJE

Ofiolitet shqiptare janë konsideruar se perfaqesojne nje nga prerjet me te plota dhe te qendrueshme midis ofioliteve Mesdhetare (Fig. 1a) dhe perbehen nga dy breza gati paralele me shtrirje VVP-JJL, brezi i ofioliteve perendimore (BOP) dhe brezi i ofioliteve lindore (BOL) (Shallo etj., 1985, reference e cituar; Beccaluva etj., 1994), (Fig. 1a).




Fig.1a Harta e Shqiperise me ophiolitet, konturin e vendburimeve te Mirdites Qendore, Rehoven dhe kufirin e perafert midis ophioliteve perendimore dhe lindore

Mbeshtetur ne marredheniet strukturore dhe stratigrafike midis ofioliteve dhe shkembijnjeve sedimentare eshte sugjeruar formimi i ofioliteve ne nje basen te vogel ne kufirin perendimor te mikropllakes se Korabit (Pelagonise) si rezultat i perhapjes Jurasike dhe se levizjet relative midis ofioliteve dhe shkembijnjeve rrethues pushuan gjate periudhes Jurasike-Kretake (Shallo etj., 1990).

Me vone (Robertson dhe Shallo, 2000), duke u mbeshtetur ne te dhena nga Greqia dhe Jugosllavia, per territorin e Albanideve, nga fillimi i Mesozoit e ketej shkruajne se *Neotethisi ne Shqiperi ka egzistuar si nje vazhdimesi veriore e oqeanit te Pindit ne Greqi (oqeani Pindi-Mirdita)*. Po keta autore pranojne nje subduksion drejt perendimit dhe formimin e ofioliteve te tipit lindor mbi zonen e subduktuar gjate Jurasikut te mesem-siperme te ndjekur nga mbizhvendosja drejt lindjes, mbi zonen Korabi dhe formimin e melanzhit (qe kish filluar te formohet mbi pllaken e subduktuar) gjate periudhes se Jurasikut te siperme-Titonianit. Autore te tjere kane shprehur mendime se mjedisi gjeografik i formimit te ofioliteve nuk eshte hullia e Krasta-Cukalit midis platformes Kruja ne perendim dhe Korabit ne lindje (Kodra dhe Gjata, 2002).

Shallo (1990) pershkruan bazalte me shume magnezium apo *bazalte komatitike* qe ne diagramat e FeO-MgO dhe Al₂O₃-MgO bien afer trendit te xhamit boninitik nga kompleksi ofiolitik i Trudosit dhe Transha Mariana, te ngjashem me *serite marianite-boninite*. Pranine e xameve si *boninite* midis ofioliteve lindore ai e sugjeron te formuar ne nje mjedis te ngjashem me ate te Trudosit.

Mosha e vullkaniteve te ofioliteve, ne mbeshtetje te mbuleses radiolaritike eshte konsideruar Jurasik i mesem (Marcucci etj., 1994; Prela, 2000) apo deri ne fillim te Jurasikut te siperme (Hoxha, 1995, reference e cituar).

Gjata dhe Marku (1989, reference e cituar) mendojne se pakaja argjilite me copa e Jurasikut te siperme-Kretakut te poshtem vendoset transgresivisht mbi te gjitha formacionet duke filluar nga ato te Triasikut te poshtem, mesem, siperm dhe Jurasikut te poshtem-siperm dhe se zona Mirdita, si ajo ofiolitike ashtu edhe periferia karbonatike jane autoktone, me nje prirje me teper mbihipese me sens drejt perendimit.

Mbeshtetur ne pranine e nje sere mbulesash eshte pranuar qe mbizhvendosja e ofioliteve drejt perendimit ka ndodhur gjate Jurasikut te siperme-Kretakut te poshtem mbi nje platforme karbonatike te Triasikut te siperme te mbuluar nga melanzhi i Jurasikut te siperme-Kretakut te poshtem. Kjo ngjarje orogenike eshte ndjekur nga dy te tjera: mbivendosja drejt perendimit te platformes karbonatike mbi depozitimet si fliish te Kretakut te hershem dhe te kesaj te fundit mbi fliishin e Eocenit gjate levizjeve Alpine (Hoxha, 2001) duke mos patur nje stratigrafi normale te ofioliteve nga Jurasiku ne Kretak te poshtem, por nje tektonostratigrafi (Hoxha, 2002).

Ne kete artikull do te behet nje rivleresim i gjeologjise dhe metalogenise se rajonit me synim evidentimin me te plote te perspektives xehlerombajtse duke analizuar aspektet gjeologjike, metalogenike, tektonike dhe ekonomike.

Ne kete punim jemi mbeshtetur ne punen shumevjeçare te bere ne kete rajon nga disa autore si dhe ne nje volum te madh punimesh te perfshire ne raporte e studime te publikuara dhe jopublikuara (ISPGJ-FGJM, 1988, 1989; Ndermarjet gjeologjike te Rubikut dhe Pukes) si dhe per gjithesimet e punimeve te integruese gjeologjike-gjeofizike-gjeokimike te kryera keto ne shkallet 1: 5 000 dhe 1: 10 000 ne gjithe territorin e Shqiperise, nga vitet 1960 deri ne vitin 2002.

GJEOLOGJIA E RAJONIT PERLAT-MUNELLE

Nisur nga fakti se ketu jane zbuluar rezervat me te medha te lidhura me ofiolitet shqiptare ky rajon i eshte nenshtruar nje sere punimesh, studimesh dhe artikujsh (ISPGJ-IGJN, 1982; ISPGJ-FGJM, 1989, Bezhani etj., 1985; Mustafa etj., 1996; Mustafa etj., 1998; Avxhiu dhe Hoxha, 1998; Hoxha etj., 2001; Hoxha etj., 2002; Zaçaj etj., 2002)

Rajoni sulfurmajt Perlat-Munelle (Qafe Mali) ben pjese ne ofiolitet lindore ku dallohet qarte brezi Qafe Mali-Reps rreth 25 km i gjate, ndersa ne pjesen jugore te tij nuk dallohet me nje brez, por vendburimet e Perlatit dhe Rrenjolles ne vullkanitet dhe ai i Kurbneshit, ne gabrot (Fig. 1b).

Rajoni ben pjese ne Brezin e ofioliteve lindore (BOL) qe perbehet nga seria bazalt-andezite-dacite (riolite) e Jurasikut te mesem-siperme te nderprere nga kompleksi i dajkave paralele, kuarcdioritet-plagiogranitet,




Fig. 1b. Vendndodhja e vendburimeve dhe shfaqjeve sulfure ne Brezin e Ofioliteve Perendimore dhe ne Brezin e Ofioliteve Lindore (sipas Hartes Metalogenike te Shqiperise, 1989)

gabrot, gabronoritet dhe rrallehere nga harzburgite te mantelit te siperme duke zene keshtu gjithe zonen nga Qafe Mali ,ne veri, deri ne Perlat, ne jug (Fig.2).

Pjesa me e siperme e vullkaniteve mbulohet nga silicore radiolaritike manganmbajtes te Jurasikut te mesem-siperme-Jurasikut te siperme, te ndjekur me papajtueshmeri nga melanzhi i Jurasikut te siperme-Kretakut te poshtem (me bllloqe alkalinoresh te Triasikut te mesem-siperme, karbonatikesh te Triasikut te siperme, vullkanitesh Jurasike, ranore, rreshpesh argjilore etj.). Per efekt te tektonikes mbulesore, mbi plagiogranitet vendosen depozitimet flishoidale te Berrasan-Valanzhinianit, te cilat mbihipen nga ultrabaziket, qe nga ana e tyre mbulohen transgresivisht nga formimet karbonatike te Barremian-Aptianit (Bardhaj, Kurbnesh, Munelle).

Vullkanitet bazike-mesatare jane per gjithesish me *pak-Ti*, te ngopura deri te mbingopura ne SiO₂ dhe me permbajtje shume te ulet K. Ne pikepamje petrokimike ato i takojne serise toletitike kalcalkalinore te pasura ne Al.

Siq pranojne shumica e autoreve (ISPGJ-FGJM 1989; Shallo etj., 1994; Bezhani etj., 1985; Kamberaj dhe Deda, 1987; Avxhiu dhe Hoxha, 1998; Deda etj., 1995; Leka etj., 2001; Hoxha etj., 1994; Hoxha etj., 2001; Zaçaj etj., 2002) shumica e vendburimeve sulfure te zbuluara deri tani si dhe potenciali me i madh i resurseve ndodhen ne brezin lindor te vullkaniteve te ofioliteve lindore, veçanerisht ne brezin me shtrirje VL, 25 km te gjate Qafe Mali-Reps duke shfaqur nje vazhdimesi te rendesishme ne planin vertical dhe shtrirje.

Siq duket nga harta (Fig.2) pjesa veriore dallon nga ajo jugore veçanerisht nga zhvillimi ne shkalle te larte i tektonikes mbulesore qe e ka komplikuar shume situaten gjeologjike.

Shkembinje vullkanike, ne per gjithesi, mund te ndahen ne :

Vazhdimesia e poshtme e llavave jastekore (kryesisht) bazalt-andezitike e Jurasikut te mesem-siperme

Vazhdimesia e siperme vullkanoklastike (dhe me ndershtresa te rralla llavash jastekore) e andezit-bazalteve, andeziteve, daciteve (rioliteve) e fillimit te Jurasikut te siperme.




Fig.2 Harta gjeologjike e rajonit Qafe Mali-Perlat me vendburimet dhe shfaqjet sulfure (ne mbeshtetje te studimeve dhe punimeve te ndryshme deri ne vitin 2002)

Formimet sedimentare

Perfaqesohen nga silicoret radiolaritike, melanzhi, depozitimet flishoidale dhe formimet konglomeratike-karbonatike.

Silicoret radiolaritike

Zene pjeset me te siperme te prerjes se vullkaniteve.

Ne silicoret radiolaritike te vendburimit Perlat ka radiolare te ruajtuara mire, por te vogla si: *Tritrabs ewingi* (Pessagno), *T.cosmaliensis* (Pess.), *T.cf.rhododactylus* Baumgartner, *Sethocapsa cetia* Foreman, *Parrvingula dhimenaensis* Baumgartner, *Hsum brevicostatum* Ozvoldova, *H.ex.gr. maxwelli* Pessagno, *Obesacapsula rotunda* (Hinde), *Eucyrtidiellum ptyctum* (Riedel and Sanfilippo) qe tregojne per Kallovian te siperim deri ne Oksfordian (fundi i Jurasikut te mesem- fillimi i Jurasikut te siperim (rreth 158-150 Ma) (V.Vishnevskaja, 1993).

Ne mbeshtetje te percaktimit te asambleve te radiolareve te vendosur mbi vullkanitet ne rajonin e Munelles, mosha e vullkaniteve eshte konsideruar kryesish Jurasik i mesem deri fillim i Jurasikut te siperim (Maruccci etj., 1994; Prela, 2000).

Melanzhi

Perhapet kryesish ne rajonin e vendburimit Perlat- Malaj ku arrin nje trashesi deri 300m dhe me pak ne rajonin Spaç-Munelle.

Eshte konsideruar si vazhdimesi direkte, normale mbi mbulesen me te siperme radiolaritike dhe nisur nga gjetjet ne turbiditet e rrjedhura nga melanzhi te kater zonave me *Calpionelides* (p.sh. *Crassicollaria*, *Calpionella*, *Calpionellopsis* dhe *Calpionellites* eshte percaktuar mosha si Titonian-Kretaku i hershem (Shallo, 1990, 1994; Robertson dhe Shallo, 2000); me moshe Jurasiku i siperim- Kretaku i poshem, apo Titonian gjykuar nga vendosja transgresive e depozitimeve flishoidale me biozonen me *Crassicollaria* mbi kete melanzh (Gjata etj., 1989); si e Titonian-Berriasianit mbi bazen e gjetjes ne kete melanzh te *Saccocoma*, *Cadosina sp.*, *Globochaete alpina* (Hoxha, 1990) dhe si mospajtuese me formimet vullkanogene (Hoxha, 2001).

Ne literatoren me te fundit (Robertson dhe Shallo, 2000), ne skemen e evolucionit tektonik te Albanideve, koha e formimit te melanzhit jepet gjate Jurasikut te mesem-Jurasikut te siperim (rreth 140 Ma deri rreth 130 Ma) te formuar ne bazament te ofioliteve (plakes) te zones se suprasubduksionit, te cilat mbizhvendoseshin drejt lindjes mbi zonen e Korabit (zonen Pelagoniane). Ne punime me te fundit melanzhi konsiderohet me moshe Jurasik i siperim (Titonia) (Zaçaj etj., 2002).

Lidhur me vendin e formimit te melanzhit ne literature jane shprehur mendime se *melanzhi (dhe shistet me glaukofan) formohen ne thelesi, ne bazament te plakes qe obduktohen, mbi koren oqeanike, ne thelesi te harkut te jashtem* (Garson dhe Mitchell, 1977, reference e cituar).

Kohet e fundit, ne favor te kesaj ideje per melanzhin Osa, ne Kosta Riken e Jugut eshte shprehur mendimi i formimit te melanzhit nga *erozioni gjate subduksionit* (Meschede etj., 1999).

Siç shihet, vendi dhe koha e formimit te melanzhit eshte shume e diskutueshme. Mbeshtetur ne gjetjen e vullkaniteve te Jurasikut te mesem-fillimit te Jurasikut te siperim, mosha e melanzhit ne kete artikull konsiderohet si Jurasik i siperim-Kretak i hershem. Ne literature ka nje tendence qe si moshe e nje njesie konsiderohet kufiri me i siperim moshor.

Depozitimet flishoidale

Depozitimet si flish te Jurasikut te siperim-Kretakut te poshem (Titonian-Berriasian) te krahut lindor

Ne zonen e Kurbneshit, plagiogranitet mbulohen nga nje horizont mikrobrekçiesh te karbonatizuara (kokrriza vullkanitesh, ultrabajikesh dhe gabrosh) rreth 5m, te ndjekur nga rreth 40m depozitimesh si flish te datuar si Berriasian-Valanzhinian. Sipas Shallo etj., (1981) (reference e cituar) depozitimet si flish te

Berrasiyan-Valanzhinianit mbulohen me pajtueshmeri nga karbonate neritike te Hoterivian-Aptianit, ndersa Peza (1983) (reference e cituar) pranon nje pushim ne depozitim gjate Hoterivianit, te ndjekur nga nje transgresion i per gjithshem i Barremianit mbi nivele te ndryshme te ofioliteve. Per nje transgresion te tille te Barremian-Aptianit mbi melanzh dhe vullkanite ne zonen e Gurth Spacit dhe gjithe ofiolitet eshte shprehur dhe Hoxha (1988) (reference e cituar).

Sipas Marku (2002) asambli faunistik i me poshtem: *Terebratulina arguensis*, *Terebratulina Sailensis hajnautensis*, *Dimorphastrea fungiomorpha*, *Cyclolithes intumescens* dhe amonitet: *Fauriellaboissieri*, *Haploceras carachtheis*, *Halcaphyllorceras taurini* eshte i ridepozituar dhe se Barremian-Aptiani vendoset transgresivisht mbi gjithe formimet ofiolitike.

Duhet menduar se depozitim flishore ne perendim te bashkesise ofiolitike-gelqerore dhe ne brendesi te tyre (Derven, Kurbnesh) perfaqesojne perkulje (thellime) ne ballin e mbulesave qe avanconin drejt perendimit gjate orogjenezes Jurasike-Kretake.

Mineralizimet sulfure ne vazhdimesine e poshtme bazalt-andezitike te Jurasikut te mesem-sipermet "Brezi i Perlatit"

Perfaqeson pjesen jugore te te ashtuquajturit "brez sulfur Qafe Mali-Perlat" me disa ndryshime ne pikepamje te ndertimit gjeologjik, stilit te mineralizimit dhe veçanerisht te tektonikes.

Vendburimi Perlat

Jane zbuluar rreth 3.5 milion tone, me nje mesatare rreth 2.2 % Cu si dhe 0.5 milion ton me rreth 40 % S ne vazhdimesine e siperme vullkanoklastike (Hysi dhe Jonuzi, 1974; Doda, 1983; Daci etj., 1995.) Aktualisht, kane mbetur pa u shfrytezuar rreth 0.9 milion tone me rreth 2% (ALB-ITA BAKER, 1994, ISTM, 2002)

Jane dalluar: a) pakua e poshtme e llavave jastekore spilitike bajamore dhe b) pakua e siperme e hiallospiliteve dhe tufoaglomerateve te Jurasikut te mesem-sipermet (Doda, 1983).

a) *Pakua e poshtme e llavave jastekore spilitike bajamore* perbehet nga spilite, mikrosplilite bajamore, me diameter te bajameve 1.5 deri 2 mm, te mbushura me kalcit, kuarc, epidot, klorite dhe rralle pirit e kalkopirit dhe qe zene 10-15% te mases. Me rralle ato zene deri 50% te mases dhe kane diameter te bajameve 1-2 deri 7-10mm dhe tashesi rreth 500m

b) *Pakua e siperme e hiallospiliteve dhe tufoaglomerateve* perfaqesohet nga nderthurje hialospilitesh jastekore me tufe dhe tufe aglomeratike. 60-70m te pjeses se poshtme perfaqesohen nga llava jastekore mikrosplilitike bajamore. Rralle takohen dajka dhe rryma te crregullta mikrosplilitesh e porfiritesh diabazike. Perberesit e saj kane bajame te mbushura me klorit, kalcit e rralle, epidot. Facia aglomeratike tufitike ze pjesen e siperme te prerjes (hialospilite, spilite bajamore te cimentuara me tufe) me ngjyre te zeze te emertuara dhe si "spilitet e zeza" nga gjeologet e zbulimit. Duhet theksuar se pjesa me e siperme me nje trashesi 10-20m, perfaqesohet nga tufe me permbajtje argilo-hematitike. Trashesia, rreth 400m Ne punime te mevonshme qe mbeshteten ne analiza te reja eshte perdonur termi bazalte andezitike apo edhe andezite bazalte per pjesa te veçanta.

Pakua e poshtme pershkruhet dhe si e llavave jastekore dhe rrymave llavore andezit bazaltike te epidotizuara gjeresisht dhe *pakua e siperme* e andeziteve me nderthurje aglomeratike (vullkanoklastite) te cimentuar me material tufosilicor, xhamor hialloklastit dhe karbonate. Andezitet me permbajtje te ulet te TiO_2 (0.2-0.65%) dhe permbajtje te larte te MgO (0.66-6.99%) sipas Shallo (tek Zaçaj etj., 2002) shprehin qarte natyren boninitike.

Trupat xeherore

Nga punimet e kerkim - zbulimit (Hysi, 1974; Doda, 1983 dhe Daci, 1986) zona ne te cilin jane gjetur trupa sulfure eshte rreth 2.5 km ne shtrirje dhe rreth 350m ne gjeresi. Trupat kane forma te crregullta (Fig. 3a, 3b, 3c, 3d) dhe verehen kalime graduale nga xeherore masive ne pikzimore damarore dhe anasjelltas. Permasat e trupave kryesore, sipas ketyre punimeve levizin nga dhjetra metra, ne shtrirje dhe deri ne

qindra metra, ne renie (p.sh. trupi 3, me gjatesi 500m dhe renie, 160m; trupi 53, 200m ne shtrirje dhe 150m ne renie etj.)

Nga te dhenat e minieres trupat xeherore kane nje shtrirje verilindore, jane ne forme linzash te crregullta, shume te kufizuara ne gjeresi (sipas te dhenave te minieres rreth 100 m) dhe nje trashesi qe shkon deri ne 20m. Permasat me te zakonshme jane 15x20m dhe rralle 20x25m Ndryshimet hidrotermale kryesore Jane kloritizimi, sericitizimi vende- vende kaolinizimi (Hysi dhe Jonuzi, 1974; Doda, 1983; Daci, 1986).

Xeheroret sulfure te vendburimit, ne disa punime (Zaçaj, 1987; ISPGJ-FGJM, 1989, Shallo 1994) jane menduar ne forme te nje "çarçafi" te rrudhosur dhe te perhapur ne gjithe zonen e vullkaniteve. Me vonë xeheroret Jane konsideruar te jene analoge me "tymuesit e zinj" (Hoxha, 1995, reference e cituar) gje qe pasqyrohet edhe ne te dhenat e minieres.

Tektonika mbulesore

Duhet theksuar se perben elementin me te rendesishem te kerkimit ne kete vendburim dhe rajonin perqark tij. Ne raportin e pare te vendburimit Perlat eshte menduar se struktura e vendburimit perfaqesohet nga nje strukture sinklinale me berthame melanzhin, te permbysur ne perendim dhe te komplikuar ne lindje nga tektonika zhvendosese (Hysi etj., 1974; Shallo, 1985 reference e cituar). Me vonë, nisur nga te dhenat e shpimeve dhe tektonika mbulesore e ketij rajoni, ne raportin e llogaritjes se rezervave Jane vizatuar disa rrafshe mbulesash, qe te gjitha pas formimit te melanzhit, dhe llogarita e rezervave eshte bere ne disa planimetri horizontale (Doda etj., 1983; Daci etj., 1986). Ne nje kuader me te gjere eshte evidentuar roli dhe karakteri i tektonikes mbulesore te rajonit, perfshire dhe vendburimet (Hoxha etj., 1988, reference e cituar; Hoxha etj., 1988; Hoxha, 2001; Hoxha etj., 2002)

Siq pranohet gjeresisht tashme, vendburimi ndodhet ne nje zone shume te prekur nga tektonika mbulesore (Fig.2, Fig.3c, Fig.3d.). Ketu, per te vertetuar mundesine e perseritjes se xeheroreve per shkak te tektonikes mbulesore, eshte kryer kerkimi i detajuar me gjeofizike te thellisise (IPR-10, prodhim i SINTREX, Canada). Ne pjesen jugore, gjate aksit kryesor te vendburimit Jane zbuluar dy zona anomalist (Fig.4), respektivisht 800 x 600 m dhe 400 x 400 m, qe risin perspektiven e resurseve xeherore rreth 50 % (Hoxha, 1995, reference e cituar; Leka etj., 1995)




Fig.3 Profillet 6 (trupi 3,21,38,39), 20 (trupi 3) dhe 53 (trupi 108) te vendburimit Perlat (Az.118°)




Fig.3, d. Prerje gjatsore ne vendburimin Perlat (mbeshtetur ne te dhenat e zbulimit nga viti 1983 deri ne vitin 1988)




Fig.4 Prerje terthore ne vendburimin Perlat (a) me te dhenat e elektrometrise dhe (b) te shfrytezimit

Vendburimi Rrenjolle

Ndodhet brenda llavave jastekore bazaltike(bazalt andezitike). Karakteristike eshte se ,ndonese ne vazhdimesine e poshtme, verehet nje zonalitet vertikal me trupat e piritit, poshte, te bakrit, me lart dhe ne pjesen e siperme te zinkut.

Ne Rrenjolle jane zbuluar rreth 100 000 tone rezerva me rreth 1% Cu (Llubani, 1972) si dhe nje trup masiv piriti, tashme te shfrytezuar.

SEGMENTI REPS-MUNELLE

Vendburmi i Repsit (Laj)

Mineralizimi ndodhet ne llavat jastekore bazalt-andezitike dhe rrymat masive te prera nga dajka te shumta doleritike, keratofireve kaurcore si dhe gabro-plagiogranitet.

Eshte karakteristike se ne siperfaqe (rruga automobilistike Mashterkor-Orosh) dhe ne prerje te ndryshme me shpime vrojtohet “*injektime*” te melanxit ne nivelet me te thella te shkembinjve ne bazalte masive deri gabrodiabaze. Kjo provon se, ky melanzh eshte depozituar gjate zhvendosjeve masive drejt perendimit te ofioliteve.

Mineralizimi *pirit-kalkopirit* eshte i stilit damaror-shperndare i shoqeruar me kloritizim dhe epidotizim. (Fig. 5). Keto perfaqesojne dhe nivelin me te ulet hipsometrik (lumi Fand eshte ne nivelin rreth 250 m mbi nivelin e detit) ndersa me shpime jane prere dhe gabrot. Rezervat e provuara me shpime jane rreth 1 milion ton me 0.75 % Cu (Ndoci, 1984; Ndreca etj., 1986). Aktualisht, sipas burimeve per rezervat (ne tabelen bashkangjitur) nuk kane mbetur me rezerva pa u shfrytezuar.




Fig.5, Laj-Reps

Vendburimi i Spaçit

Prerja e vendburimit ndertohet nga llava jastekore dhe rryma bazalt-andezitike te intruduara nga një sasi e madhe dajkash doleritesh dhe keratofiresh (riolitesh) si dhe shkembinje plutonike gabro-plagiogranitike (Fig.2, Fig.6).

Mineralizimi sulfur ndodhet ne llavat jastekore dhe dajkat paralele (Kolndreu etj. 1984; Hoxha , 1987, reference cituar). Krahas kalkopiritit jane takuar sasi te vogla borniti, hematiti, magnetiti, kalkozine, koveline dhe bakri nativ. Forma dhe madhesia e trupave xeherore te bakrit eshte percaktuar nga vlera ekonomike, ndersa trupat e piritit kane qene deri 15 m te trashe, *dhe siç duket te rrudhosur* (Fig.8).

Rezervat e provuara me shpime kane qene rreth 10 milion ton me rreth 1.24 % Cu, ndersa trupat e piritit kane qene me 40-50 % S. Kloritizimi eshte ndryshimi hidrotermal qe rrerthon trupat e bakrit, rreth trupave te piritit eshte kryesish kaolinizimi.Rezervat e pashfrytezuara jane rreth 3.63 milion ton me 1.23 % Cu (ALB-ITA-BAKER.CO, 1994, ISTM, 2002).Mundesia per rritjen e rezervave eshte poshte planit te mbihipjes si dhe ne lindje (*Lamskon*) ku jane zbuluar me shpime rreth 0.5 milion ton me 0.85 % Cu (Kaza dhe Ndreca, 1996).

Me ne verilindje ne *Letitna* ne llavat jastekore jane zbuluar me shpime rreth 0.2-0.3 milion ton me 0.9 % Cu.




Fig.6 Prerje gjeologjike te (a) vendburimit Spaç-Dith (b) Gurth Spaç-Suke Pele (c) Qafe Lisi-Munelle




Fig.7 Maja e Madhe-Shenmeri

Ne krahun perendimor (*Maja e Madhe*) jane gjetur rreth 0.15 milion ton me 1.34 % Cu, ne llavat jastekore, derdhjet masive dhe ne gabro (Fig.7).

Vendburimet sulfure ne vazhdimesine e siperme vulkanoklastike te andezit bazalteve dhe daciteve (rioliteve)

Vendburimi Kullaxhi

Ndodhet ne vulkanoklastite spilitike brenda nje zone minerale me gjatesi 300m dhe trashesi deri ne 150m. Brenda zonave te mineralizuara te dobeta ndodhen trupat xehore ne forme thjerezash, me gjatesi si ne shtrirje dhe ne renie nga metrat e para ne dhjetra metra. Mineralet kryesore jane pirit, kalkopirit, sfalerit, markazit. Jane zbuluar gjithsej 373 000 ton me Cu, 1.06%, dhe rreth 4000 ton me 1% Zn (Lulo dhe Jonuzi, 1982). Ne anen e shtruar vendburimi mbizhvendoset mbi vete vazhdimesine e siperme vulkanoklastike dhe melanzhin.

Vendburimi i Gurth Spaçit

Xeherore masive dhe shume pak te stilit te shperndare ndodhen gjate kontaktit midis vazhdimesise se poshtme te llavave jastekore bazalt-andezitike dhe asaj te siperme vulkanoklastike (Fig. 6, 8). Trupat xehore kane forme thierzore te çrregullt me gjatesi nga pak metra ne 300m te gjata, nga disa metra ne me pak se 150 m te gjera, me një trashesi maksimale deri 15 m, te vendosura gjate nje zone me shtrirje veriore gati 4.5 km te gjate (Llubani dhe Kodra, 1977; Kodra dhe Llubani, 1979; Llubani dhe Kodra, 1984).

Mineralet kryesore jane piriti, kalkopiriti dhe sfaleriti. Ne sasi te pakta jane takuar tenantit-tetraedriti dhe borniti e si gjurmë galeniti. Ne pjesen me te poshtme te vazhdimesise vulkanoklastike andezit-dacite (riolite) verehet qe sasia e tenantit-tetredritit fillon e rritet duke u ngjitur lart siç ndodh dhe me kovelinen, kalkozinen, galenitin dhe sidomos Au dhe Ag. Keta trupa jane te vegjel dhe levizin nga pak mije tone ne disa dhjetra mije tone, kane pak S (20-25 %) por kane shume Zn (5-13 %), Cu (2-4.5 %), Au (5-6 ppm), Ag (10-30 ppm).

Raporti Cu/Zn eshte 1:2 dhe ndryshimet kryesore hidrotermale jane kuarcizimi, kloritizimi dhe sericitizimi, si dhe kaolinizimi rreth trupave te piritit. Verehet gjithashtu pak ceolitizim.

Rezervat e provuara me shpime kane qene 2.7 milion ton, me rreth 2.5 % Cu, 1% Zn, 1 ppm Au, 10-20 ppm Ag, 20 ppm Pb, 6 000 ppm Ba, 160 ppm As (Llubani dhe Kodra, 1977; Kodra e Llubani, 1979). Rezerva te pasfrytezuara jane rreth 0.481 milion ton me 1.31% Cu (ALB-ITA-BAKER.CO, 1994, ISTM, 2002).


Shpimet e kryera ne fund te vitit 1996 (NEBEX Ltd.), rreth 400 m ne pjesen lindore te trupave te zbuluar, nderprene ne thellesine rreth 450 m, 12 m xeherore masive kalkopirit-sfaleriti me permbajtje te larte Cu, Zn dhe Au, qe me sa duket flet per pranine e një aksi paralel.

Ne kete pjesë te sekunes vullkanike ndodhen Gurth Spaçi, Munella dhe Qafe Bari ne pjesen veriore te brezit dhe Perlati ,ne pjesen jugore te tij.

Vendburimi i Munelles

Eshe konsideruar si vendburimi me i madh i zbuluar deri tani. Ndertimi gjeologjik i Munelles dhe zones perqark (Qafe Lisi-Munelle) perfaqesohet nga vazhdimesia e siperme e vulkanoklasteve andezit-dacitike, kupolat dacit-riolite dhe intruzionet kuarciorite-plagjiogranite. Vullkanitet jane te prekura nga tektonika shkeputese mbulesore me drejtim zhvendosje perendimore, gje qe ka çuar ne vendosjen transgresive te brekçieve dhe gelqeroreve mbi keto nivele dhe melanzhin (Hoxha, 2001) te vulkanoklasteve.

Mineralizimet sulfure ndodhen ne vazhdimesine e siperme piroklastike andezit-dacite, dhe ne kupolat dacit-riolite ne anen e varur (Fig.6c, 8c) (Kamberaj dhe Bardhoshi, 1980; Kamberaj dhe Deda, 1987; Lleshi etj., 1989; Deda etj., 1995; Hadroi etj., 2000; Leka etj., 2001)



Mineralet kryesore jane pirit, kalkopirit dhe sfalerit e me pak tenantit-tetraedrit e si gjurme galenit (Koçi, 1977; Kati etj., 1987; Koçi dhe Kati., 2002, reference e cituar).

Ne Munelle eshte pershkruar elektrum ne paragjeneze me bornitin dhe qe mendohet te jetet precipituar ne hematit ne rreth 250°C , me madhesi $0.01\text{-}0.05 \text{ mm}$ si dhe inkluzione elektrumi ne galenit apo kalkopirit deri ne μm (Sinojmeri, 1990).

Ne nje studim te fundit mbi mineralizimet e Munelles (Ferrini dhe Mignardi, 2002) rezulton si me poshtë: Nga 62 kampione te mbledhur nga niveli 3 qe pret thierzen e siperme xeherore midis 0 dhe 30m dhe nga shpimet qe presin thierzen e poshtme ne thellesi midis 320 dhe 620m, rezultatet analitike tregojne se xeheroret masive permabajne pirit (50% te vol.), kalkopirit (25% te vol), sfalerit (20% te vol) dhe 5% vol markazit, falerc, galenit, bornit dhe elektrum (aliaz natyral i arit dhe argjendit). Elektrumi ndodhet ne trajte xhepesh te vegjel (zakonisht $10\text{-}20\mu\text{m}$) dhe eshte me shumice ne thierzen e siperme xeherore. Provat e bera te kampioneve nga thierza e siperme xeherore kane dhene nga 12.9 dhe 70.9 g/t Au , ndersa ato nga thierza e poshtme permabajne Au nga 5.9 ne 13.5 g/t . Ne Munelle ari ndodhet tek elektrumi me nje paragjeneze polimetaleke kryesisht pirit, kalkopirit, sfalerit, galenit dhe falerc. Permabajtja mesatare e Au ne elektrum nga thierza e poshtme leviz nga 66.8 deri

ne 71.4% ndersa elektrumi nga kampionet e thierzes se siperme ka nje perberje me aurifere ($75.2\text{-}79.25\% \text{ Au}$). Per me teper, kampionet nga thierza e mesiperme kane disa grimca elektrumi qe jane pothuaj ar i paster, me nje permabajtje Au zakonisht me te larte se 90% . Permabajtja mesatare e elektrumit ne te dy thierzat eshte pak a shume njelloj, $1.5\text{-}1.2\%$, respektivisht.

Mbeshtetur ne vlerat e $\delta^{34}\text{S}$ te sulfureve qe levizin nga 0.8 ne 3.4% , ndersa ne barit nga nje kampion ne thierzen e siperme 17.7% rezulton se S, qe ndodhet ne fluidet mineralizuese, ka origine magmatike ndersa vlerat e baritit sugjerojne qe burimi i S i ketij minerali ka te ngjare te perfaqesohet nga nga sulfatet joorganike te ujit te detit. Gjithashtu raportet molare te Se/S te piritit te shperndare tregojne se fluidet ishin kryesisht magmatike. Bashkeshoqerimi sfalerit-falerc flet per temperaturat $rreth 250^{\circ}\text{C}$ gjate depozitimite sulfideve te fundit, ndersa kloriti duhet te jetet formuar ne temperature midis $150\text{-}200^{\circ}\text{C}$. pH i fluideve duhet te kete qene nen 5 ne $T < 250^{\circ}\text{C}$. Sfaleriti i shoqeruar me ar ndoshta ne pH rreth 6 .

Raportet Zn/Cd flasin per perqendrim progresiv te Cd ne fluide me evolucionin e procesit mineralizues.

Sipas autoreve te mesiperme, fluidet mineralizuese te Munelles kane qene te temperaturave te uleta ($150\text{-}250^{\circ}\text{C}$) me pH neutral ne alkalin, me aktivitet te larte te S dhe fugacetet te ulet te O. Ne keto kushte ari duhet te jetet transportuar apo rimobilizuar si kompleks bisulfid [Au(HS)-2]. Ne kete pikepamje, pasurimi relativ i arit ne kampionet nga thierza e siperme minerale e Munelles, ndoshta mund te shpjegohet me rimobilizimin e arit nga sulfuret e hershme te pasura ne ar nga thierza e poshtme sulfure (Ferrini dhe Mignardi, 2002).

Autoret e mesiperme perfundojne se nga keto studime paraprake, proceset metalogjenike dhe kushtet fiziko-kimike te fluideve mineralizuese, qe formuan vendburimin polimetetalik te Munelles, jane te ngjashme

me ato vendburimeve sulfure masive (VSM) tipike armbajtese *dhe ne kete pikepamje zona mund t'i nenshtrohet nje kerkimi per ar*. Megjithese keto mineralizime, aktualisht Jane te pashfrytezuara per ar keto perfaqesojne sasi te rendesishme ari te parakoncentruar (Ferrini dhe Mignardi, 2002).

Ne pikepamje te madhesise se trupave xeherore, kater trupat me te medhenj sulfure levizin ne shtrirje nga 150 m ne 300 m , kane trashesi 10 m deri ne 70 m dhe vazhdojne ne thellesi 100 m deri ne 250 m .

Mbeshtetur ne shpimet, ne pjeset e poshtme Jane takuar xeherore masive piriti dhe baker-zinku dhe ne pjeset me te siperme xeherore shtokverkore me pak baker-zink, te gjithe te rethuan nga xeherore te tipit te shperndare dhe ndryshime hidrotermale si sericitizimi e kuarcizimi qe permabajne gjithashtu barit dhe fluorit rreth mineralizimeve damaro te sfalerit-piritit (Kati etj., 1987).

Me shpime Jane vertetuar rreth 10 milion tone me $1.3\% \text{ Cu}$, 1.4 ppm Au dhe rreth 15 ppm Ag (rreth 0.4 milion tone Jane xeherore piriti dhe zinku) (Kamberi etj., 1980; Leka dhe Deda, 1990). Nga pozicioni i mineralizimeve kryesisht sulfure qe ndodhen ne anen e varur te nje mbihipjeje duken se ato Jane te permbyrsura drejt perendimit (Hoxha etj., 2002). Ka mundesi qe punimet e shfrytezimit te percaktojne modelin e plote te xeheroreve masive, ne pjesen e siperme me ata shtokverkore, ne thellesi.

Vendburimet sulfure ne shkembinje intruzive

Dejza kuarc-sulfur dhe damare kuarc sulfurmbajtes te trashe, te shoqeruar me ndryshime hidrotermale, zhvillohen kryesisht ne gabro dhe me pak ne kaurcdiorite-plagiogranite te brezit lindor te ofioliteve. Mineralizime sulfure, me sasi shume te kufizuar, Jane gjetur dhe ne shkembinje vulkanike te brezit perendimor te ofioliteve si dhe ne ultrabaziket.

Vendburimet me te rendesishem ne shkembinje gabrore Jane Kurbneshi, Golaj, Nikoliqi dhe Thirra, ne vullkanit Gjazuj dhe ne ultrabaziket Babja.

Vendburimi i Kurbneshit




Fig. 9 Prerje terthore ne vendburimin Kurbnesh me xeheroret sulfure dhe rrafshin e mbihipjes me kend te bute

Rivleresimi i vendburimeve te bakrit te rajonit Perlat-Munelle

Eshe vendburimi me i madhi i gjetur deri tashti ne intruzivet. Xeheroret ndodhen ne gabronorite. Mineralizimi perfaqesohet nga dejza e damare me te trashe te pirrotine-kalkopiritit dhe me rralle, te piritit ne kuarc. Trashesia e zones minerale ka qene rreth 250 m dhe eshte e perpunuar intensivisht nga kloritizimi. Rezervat e provuara me shpime kane qene rreth 3 milion tone me 2 % Cu, 0.05 deri 0.1 % Co dhe rreth 1 ppm Au (ne disa raste me shume se 3-5 ppm deri 40 ppm) (Jorjani, 1967). Aktualisht, kane mbetur vetem 50 000 tone ne thellesi. Ne pjesen me te poshtme te prerjes jane takuar piroksenite. Siç eshte vertetuar me shpime, vendburimi i Kurbneshit eshte i mbihedhur mbi vulkanitet e mbuluara me melanzhi, duke krijuar mundesine per te kerkuar nen planin e mbihipjes, ne gabro (Fig. 2, 9) (Hoxha etj., 1989; Hoxha etj., 2002). Nisur nga trashesia e madhe e zones me kuarc-sulfure dhe paraleлизmi pothuajse ideal i trupave xeherore mund te mendohet se eshte formuar ne gabro te stratikuara si ne Oman (ne Hoxha etj., 2002)

Tabela N-1

N-p	N-r	Vendburim i	Pershkrimi i shkurter i xeherorit	$\delta^{34}\text{SVCD}$ T ‰
2	45	Perlat	Kryesisht pirit-karbonate	5.3
8	47	Gurth Spaç	Kalkopirit	4.1
9	50	Munella	Pirit-kalkopirit	5.7??
10	46	Kurbnesh	Kalkopirit-kuarc	3.5

Mbi gjenezen e vendburimeve

Izotopet e $\delta^{34}\text{S}$

Sipas Faure (1986, ne Hoxha etj., 2002) nje nga arsyet parimore te studimit te izotopeve te S ne gjeologji, eshte te kontribuohet per nje kuptim me te mire te origjines dhe kushteve te formimit te vendburimeve xeherore sulfure. Eshte e rendesishme, si ne pikepamje teorike dhe ate praktike, te dallosh midis vendburimeve xeherore te formuar si rezultat i aktivitetit magmatik dhe atyre te formuar me origjine sedimentare.

Marrja e kampioneve, pergatitja, matjet dhe rezultatet e analizave per $\delta^{34}\text{S}$

1. Per percaktim izotopike te squfurit pra te $\delta^{34}\text{S}$ jane marre gjithsej 12 kampione (me grup gjeologesh) ne vendburimet e ofioliteve te Shqiperise sic tregohen ne tabele):

Ne 10 kampione te vendburimeve te bakrit te Mirdites te analizuar ne Vjene, ne Austri per izotopet e $\delta^{34}\text{S}$ nga Park, rezultojne vlera nga nga +0.8 % deri maksimum 5.3 %. Plagiogranitet kane vlera te ketij izotopi si sulfidet dhe konsiderohen se ato kane qene burimi kryesor i sulfideve hidrotermale (Kolndreu, 1992). Nga analizimi i 11 kampioneve te fraksioneve monominerale per $\delta^{34}\text{S}$ ne vendburimin e Munelles vlerat levizin nga +1.4 0/00 ne +5.3 0/00 dhe kane rezultuar si me poshte.

Ne pirit = 3.26 0/00

Ne sfalerit = 3.85 0/00

Ne kalkopirit = 4.25 0/00

Keto vlera, te krahasuara me Qipron dhe Ngritjen e Paqesorit Lindor (East Pacific Rise) flasin me shume per origjine magmatike. Nisur dhe nga temperatura e larte e formimit te xeheroreve masive rreth 250 °C konkludohet se vlerat e $\delta^{34}\text{S}$ nuk mund te jene nga proceset bakteriale (Sinoimeri, 1990)

Duhet theksuar se te dhenat e vendburimeve sulfure te ofioliteve shqiptare ngjajne shume me ato te oxhaqeve te sotem qe kane vlera te $\delta^{34}\text{S}$, 0.9-5.7 0/00 (ne Hoxha etj., 2002) duke treguar per nje burim nga manteli (magmatik). Vlerat me te ngritura ne disa raste duhen spjeguar me kontaminim nga ujet e detit.

Diskutim

Rajoni Perlat-Munelle perben rajonin ku jane zbuluar rezerva sulfure te rendesishme dhe ka resurse potenciale.

Rajoni ben pjese ne ofiolitet e brezit lindor apo te vendosura mbi zonen e subduksionit (ZSS) me tipare te dallueshme te petrografise, petrologjise, mineralizimit dhe tektonikes.

Rajoni i vendburimit Perlat, me gjithe moshen me sa duket te njeje te ofioliteve (Jurasik i mesem-fillimi i Jurasikut te siperm) ka dallime te dukshme te prerjes se ofioliteve, te mineralizimeve sulfure dhe veçanerisht te tektonikes.

Ne studimet me te fundit (Robertson dhe Shallot, 2000) kollona e ofioliteve lindore (ZSS) ne pjesen e mesme nga poshte-lart fillon me gabro-plagiogranitet per te vazhduar me kompleksin e dajkave paralele, derdhjet boninitike IAT, derdhjet mesatare-acide, silicoret radiolaritike te Jurasikut te mesem-siperm dhe perfundon me vendosje normale te rrymave te rrjedhura nga ofiolitet te Jurasikut te siperm-Kretakut te poshtem. (Fig. 10)




Fig. 10. Kolona permbledhese te ofioliteve perendimore lindore (sipas Robertson dhe Shallot, 2000)




Fig. 11 Prerja e idealizuar e ofioliteve sipas Galley dhe Koski, 1999




Fig. 12 Perhapje e komplekseve ofiolitike te njoitura ne bote me vendburimet sulfure masive te njoitura me mire me suitat ofiolitike te treguara ne kuadrate (sipas Galley dhe Koski, 1999).

Ne prerjen e idealizuar te ofioliteve (Penrose Conference, 1972) te perpiluar nga Galley dhe Koski (1999) pjesa e mesme fillon me kumulate bazike, vijon me sistemin e dajkave paralele, llava jastekore dhe dajka dhe perfundon me sedimente (pelagjike). (Fig.11)

Qiprua (kompleksi ofioilitik i Trudosit) dhe Oman (ofioliti i Semailit) te dy me moshe Kretakut i siperim, kane keto prerje per gjithesuese nga poshte-lart: ne Qipro, gabro-plagiogranite me mineralizime sulfure te Fe-Cu-Co-Ni, kompleksi intruziv i shtresezuar (diabaze) me mineralizime sulfure te Fe-Cu te mbushjes se çarjeve, grupi bazal, llavat e poshtme jastekore, vendburime sulfure masive te nenshtuar nga mineralizime shtokverkore, ohre (shtresime te

varfera ne Mn, te pasura ne Fe, me sasi te ndryshme te nderthurjeve te silices, materialit tufik dhe gelqeroreve), llavat e siperme, transgresivisht vendoset umber (sedimente mikrokokrrizore te lehta, te buta, me ngjyre çokollate-kafe) manganifere te pasura ne Fe (xeherore te oksiduar), transgresivisht formacioni Perapedhi i Kretakut te siperim (Kampanian) per te vijuar me siper me gelqeroret e grupit Lefkara te Kretakut te siperim-Miocenit te poshtem dhe per te vazhduar me mergele dhe gelqerore rifor te Miocenit te mesem-siperim (Constantinou dhe Govet, 1972; Robertson dhe Xenophontos, 1993, ne Hoxha etj., 2002).




Fig. 13 Prerje terthore e vendburimeve hidrotermale ne veprim permes çarjes Snake Pit (Kurizorja mesatlantike me shpejtësi perhapje te ulet) qe tregon maredheniet gjeologjike dhe hidrotermale , sipas Fouquet etj.(1993). Legjenda: 1. Llava jastekore 2.Oxhaqe te pasur me zink, 3.Sulfide masive te pasura me hekur, 4. Sulfure masive te pasura ne Cu, 5. Shtokverkore sulfure te pasura ne Cu dhe pjesa qendrore e oxhakut, 6. Prishje normale (sipas Fornari dhe Embley,1995).

Prerja e Ofiolitit te Semailit, ku ndodhen vendburimet e Omanit, ne pjesen e mesme fillon me gabrot e shtrezezuara me mineralizime magmatike sulfure pajtuese te Cu-(Au-Pt), vijon me gabrot e niveli te siperim (gabro izotropike), kompleksin e intruzioneve te vonshem gabro-diorite-plagiogranite, njesine e poshtme vulkanike, sulfure masive te Fe-Cu-Zn-Au-Ag te nenshtuar nga mineralizime shtokverkore, njesia e mesme vulkanike me mineralizime shtokverkore te Fe-Au-(Cu), sedimente metalifere dhe pelagjike dhe perfundon me njesine e siperme vulkanike (Batchelor, 1992, ne Hoxha, 2002).

Ofiolitet kane nje perhapje relativisht te gjere ne bote, ndersa vendburimet sulfure masive ne to njihen ne me pak vende (Fig.12).

Nje vemendje e veçante aktualisht eshte perqendruar ne vendburimet hidrotermale ne veprim (oxhaqet apo tymusit e zinx apo te bardhe). Ne figurën 13 tregohet nje prerje vertikale ne kurrioren Mesatlantike me llavat jastekore, mineralizimet shtokverkore te pasura ne Cu ne pjeset qendrore, sulfure masive te pasura ne Cu, sulfure te pasura




Fig.14 Te dhenet e izotopave te S te sulfideve masive vulkanogene (SHMSD) nga autore te ndryshem. Bishtat (shigjetat e gjata) ne shperdarjen e vlerave te delta 34-5 kure derohen nga Eldridge etj. (1988) nga prania e pirlit te

ne Fe dhe me siper, oxhaqe te pasur ne Zn (Fornari dhe Embley, 1995, ne Hoxha, 2002). Ne literatoren tone, lidhur me radhen e formimit te xehoreve, eshte pranuar skema e per gjithshme pirit-kalkopirit-sfalerit.

Mbeshtetur ne vrojtimet e oxhaqeve ne fund te detit dhe matjet e temperaturave pranohet kjo radhe e formimit te xeheroreve: stadi i pare, xeherore te zinj masive (sfalerit+galenit+pirit+barit) te formuar ne rreth 200 °C; stadi i dyte, egzalacione hekuore-silicore dhe me shume xeherore te zinj masive, te formuar ne rreth 250 °C; stadi i trete, xeherore te verdhe (pirit+kalkopirit) masive dhe xeherore shtokverkore pirit+kalkopirit+kuarci ne rreth 300-350 °C te formuar nga solucionet te pasura me baker; ne stadin e katert, ne rrugen e zevendesimit te xeheroreve te verdhe, formohet prerja bazale me e poshtme (e pasur me pirit dhe e varfer ne Cu, ne rrugen e zevendesimit te xeheroreve te verdhe (Evans, 2001; ne Hoxha, 2002).

Nga disa studime te kryera per izotopet e $\delta^{34}\text{S}$ (Instituti i Gjeologjise dhe Paleontologjise, Universiteti i Tuebingenit, Gjermani) por dhe ne ato te meparshmet rezulton se keto vlera flasin per xerore te formuar ne rruge magmatike (Fig. 14).




Fig.15. Përje pengjthesues litologo-stratigrafike me mineralizimet sulfur ne ofiolitetin Lindore
 a) Rajoni Qafa-Mall-Reps
 b) Rajoni Perlat-Kurbnesh
 Ne prerje tregohen efektet e tektonikës gjimesesore

Nga lista e vendburime sulfure ne bote qe ndodhen ne ofiolite ne Lindjen e Mesme (Oman, Qipro dhe Turqi) te Galley dhe Koski (1999) rezulton se:

rezervat totale ne Qipro jane 43.7 milion tone, ne Oman, 19.75 milion tone dhe ne Turqi 3.41 milion tone. Vendburimet me te medha jane Hyal As Safil dhe Lasail (Oman) me 8 milion tone dhe Kalavasos-Mousoulos e Skouriotissa (Qipro) respektivisht me 6.9 dhe 5.4 milion tone dhe te tjeret, te rendit 0.3 deri 4 milion tone.

Permbajtja e Pb ne Oman leviz nga 0.01-0.04% ne Qipro 0-0.2%; zinku 9 % - 25% ne Oman ne Qipro nga 0.06-0.8%; Ag, nga 11-25 g/t ne Oman dhe nga 2.7 ne 39 g/t ne Qipro; Au, nga 1.2-19 g/t ne Oman (ku eshte percaktuar dhe elektrumi) dhe nga 0.3-3.39 g/t ne Qipro. Per shume vendburime nuk ka te dhena, sidomos per Au.

Ne pikpamje tektonike, te dy ofiolitet qe i permabajne keto vendburime konsiderohen si mbulesa.

Duke i permbledhur sa me siper rezulton se:

1. Ne kollonen per gjithsues te Robertson dhe Shallo (2000) ka nje vazhdimesi te plete nga Jurasiku i mesem deri ne Kretak te poshtem duke qene melanzhi pjesa me e siperme normale e prerjes.

Ne pikpamje petrologjike, me prerjen e idealizuar te ofioliteve (pjesemarresit e Konferences Penrose, 1972) ngjan vetem segmenti Qafe Mali-Reps. Prerja e Perlatit dhe asnje pjese tjeter nuk ngjan. Nisur nga prania e boniniteve, kjo mund te perfaqesoje stadin e fillimit te ZSS.

Ne prerjen e idealizuar te ofioliteve si dhe ne prerjet e Qipros dhe Omanit melanzhi nuk eshte pjesa perberese e kollones se ofioliteve.

Sic eshte shprehur fillimisht nga Garson dhe Mitchell (1977) dhe Meschede etj., (1999) ai formohet ne bazament te pllakes mbihipese dhe nxirret ne fund te detit gjate obduksionit. Per ofiolitet shqiptare eshte konsideruar si prodhim i sinobduksionit te ofioliteve (Hoxha, 2001).

Duke i krahasuar mineralizimet sulfure me ato te Qipros dhe Omanit rezulton se segmenti Reps-Munelle ka ngjashmeri ne baze te zonalitetit te per gjithshem te mineralizimeve dhe sidomos pranise se xehorereve masive te nenshtruar nga ata shtokverkore. Ne ndryshim nga Qiprua, ne rajonin Perlat-Munelle nuk ka shperlarje dhe formim xeheroresh te oksiduar.

Prerja e oxhaqeve qe formohen sot ne fund te oqaneve me zonalitetin sulfur eshte shume tipike dhe mund te krahasohet shume mire me zonalitetin e segmentit Reps-Munelle (Qafe Mali).

Nga te dhena e fundit (Galley dhe Koski, 1999) rezulton se ne ofiolitet e Shqiperise jane zbuluar rrith 55 milion tone ose rrith 26% me shume rezerva se ne Qipro (43.7 milion tone) dhe 2.7 here me shume se ne Oman (19.75 milion tone) dhe shume me teper se ne ofiolitet e Turqise (3.41 milion tone), duke rezultuar Spaçi (me rrith 10 milion tone tashme kryesisht te shfrytezuara) dhe Munella (me rrith 9.6 milion tone) si vendburimet me rezerva me te medha ne keto ofiolite. Vendburimi i Perlatit futet ne 5 vendburimet e tjere me te medhenj pas atyre te mesiperm.

Lidhur me radhen e formimit te mineraleve sulfure, per vendburimet e ketij rajoni eshte pranuar si skeme e per gjithshme pirit-kalkopirit-sfalerit (Kati etj.; Koçi; Zaçaj etj., 2002)

Lidhur me zonalitetin vertikal te mineralizimeve, i shprehur dhe ne zgjedhimin e raportit Cu: Zn nga vazhdimesia e llavave jastekore, per pjesen me te siperme te vazhdimesise se siperme vullkanoklastike eshte trajtuar ne nje artikull te veçante (Hoxha dhe Zaganjori, 1998).

Mbeshtetur ne zonalitetin e mineralizimeve te oxhaqeve (tymuesve) dhe matjet e temperaturave te sulfureve mund te sugjerohet rishikimi i kesaj skeme. Pra, radha te jete kjo a) sfalerit+galenit+pirit+barit (xeherore e zinj) te formuar ne rreth 200°C; b) pirit+kalkopirit (xeheroret e verdhe) te formuar ne rreth 300-350 °C dhe c) xeheroret bazale te pasur me pirit qe zevendesojne ata te meparshmit, te formuar ne rreth 300-400 °C.

Ne pikepamje te elementeve kryesore perberes si Cu, Pb, Zn, Ag, Au dhe elementeve gjurme, permbajtja eshte si me poshte:

- a) Pb(%) eshte i ulet ne Qipro, Oman dhe rajonin ne studim;
 - b) Zn(%) eshte me i larte ne segmentin Gurth Spaç-Qafe Mali (veçanerisht ne Gurth Spaç-Munelle) se sa ne Qipro dhe Oman, duke formuar dhe trupa zinku;

c) Ag (g/t) ne segmentin Gurth Spaç-Munelle eshte pothuajse njelloj me Qipron dhe Omanin; dhe Au (g/t) ne segmentin Gurth Spaç-Munelle eshte pothuajse njelloj me Qipron dhe Omanin. Duhet theksuar se per Au mungojne shume te dhena. Nje krasim i mundshem mund te behet me Kurbneshin ku ne bashkeshoerimin pirotine-kuarc-klorite ka patur trupa me permajtje te mbi 3g/t ar (Puloi, doreshkrim, 1980)

Ka disa te dhena per permajtjen e Cd ne kete segment, por qe duhen verifikuar.

Duhet theksuar se ne pikepamje te tektonikes, rajoni Perlat-Munelle eshte shume i prekur nga tektonika a) rrudhosese dhe; b) shkeputese.

a) tektonika rrudhosese eshte evidentuar pothuajse ne tere raportet nga rrudhosjet e shkembinje vullkanike dhe silicoreve radiolaritike (p.sh. Lapidar, Kaçinar). Ajo eshte evidentuar ne rrudhosjen e trupave kuarc-sulfure ne Kurbnesh (Jorjani, 1967; Tasimi, te dhenat e minieres Kurbnesh, 1970), trupave te piritit ne Spaç dhe trupave masive ne Munelle (Hoxha etj., 2002) (Fig.7), te trupave xeherore (3, 39, 108 etj. dhe qe duken mire dhe ne prerjen gjatesore (Fig.3a,b,c,d) (Doda, 1983).


Veçanerisht ne Munelle dhe Spaç, duket qarte qe drejtimi i forcave ka qene perendimor.

b) tektonika shkeputese eshte e zhvilluar veçanerisht ne rajonin e vendburimit Perlat-Kurbnesh (Fig.2, 3, 4, 6, 8). Evidentimi i tektonikes mbulesore, veçanerisht ne vendburimin Kurbnesh qe mendohej i ngritur me kend te madh (ISPGJ-FGJM etj. 1990), dhe ne vendburimin Perlat ka çuar ne perpilimin e nje sere projektesh per te kerkuar nen rrafshet e ketyre mbulesave nga viti 1987-1993.

Prerjet per gjithesuese tektonostratigrafike me mineralizimet sulfure jepen ne fig. 15.

PROBLEME TE GJEOLLOGJISE EKONOMIKE

Sic dihet, minierat, ne per gjithesi konsiderohen si nje pune me shume rrezik per investuesit dhe si rrjedhim ,nje investim potencial do te kerkonte fitime te larta per te kompensuar gjithe keto te papritura. Per metalin e bakrit ka nje kerkese te qendrueshme, sepse çmimi i tij eshte me pak i varur nga faktoret e jashtem ne nje kohe kur cmimi i kromit varet plotesisht nga kerkesat e industrise se çelikut. Nje qendrueshmeri e çmimeve te bakrit ne nje periudhe 12 vjeçare tregohet ne fig.16.



Nje model me i plote finanziar sipas Collinge (2002) kerkon te merren ne konsiderate keta faktore: vendndodhja, gjeografia, infrastruktura, politikat e vendit, ekonomia e vendit, tregjet financiare te vendit, regjimi fiskal, sistemi juridik, ligji minerar, te drejtat minerare te vendit, gjeologjia e per gjithshme dhe gjeologjia e vendburimit, perfshire rezervat xeherore siaps sistemit JORC, te dhena historike lidhur me

Tabela, 2 me gjendjen e rezervave te nxjerreshme te vendburimeve te rajonit Perlat-Munelle me gjendje 1.12.2002, sipas Institutit te Teknologjise Minerare, Tirane

N. I Vendbur.	Gjendja Aktuale e Rezervave, ne t	Cilesia Cu %	Viti i fillimi te punes	Viti I mbyllje Se punes	Privatizuar Po/Jo	Viti i privatizimit
Munella. 1	603626	1.43	1982	1991	Jo	
Munella. 2	7968940	1.3	1985	Vazhdon	Po	1990
Spaç	3638000	1.23	1964	1999	Jo	
Gurth 1	58000	2.85	1979	1997	Jo	
Gurth 2	223000	1.14	1985	1988	Jo	
Gurth 3	200350	1.063	1986	1991	Jo	
Kullaxhi	272952	1.06			Jo	
Laje	0		1982	1990	Jo	
Maja e madhe	0		1977	1988	Jo	
Kurbnesh	0				Jo	
Perlati Verior	236275	1.68			Jo	
Perlati Jugor	649444	2.81			Jo	
Shuma	13 850 587					

shfrytezimin ne zonen e vendburimit, furnizimi me energji elektrike, furnizimi me uje, politikat mjedisore te vendit, kostoja e mallit (metalit)/treziku apo tregu, çeshtje operative, kostoja e perpunimit, ana ekonomike e projektit.

Mungesa e nje klasifikimi te rezervave sipas sistemit perendimor JORC eshte konsideruar si nje mangesi per gjithesisht per vendet e lindjes, perfshire dhe Shqiperine, sepse ajo qe quhet "rezerve" per sistemin rus, ne sistemin JORC quhet "resurse", pra ka nje shkalle shume me te ulet besueshmerie. Ky problem ka rezultuar dhe ne nje artikull te fundit, pavaresisht se autoret mendojne se me permiresime te legislacionit, kryesish per barazi ne zgjedhjen e te punesuareve te vendit me ata te huaj, ka vend per investime dhe ne industrine e bakrit (Eyre etj., 2002). Po ne kete kuader duhet theksuar se rezervat e xeheroreve te bakrit te pranuara nga Alba-Ita-Baker Corp.S.A.1994 jane perafersisht te njejtta me ato te Institutit te Teknologjise Minerare, Tirane (2003).

Vitet e fundit ne Shqiperi eshte bere klasifikimi ne mbeshtetje te rekomandimeve te OKB (UN.1995) i cili per kete rajon tregohet ne tabele dhe qe e zgjidh kete problem (Tab.3).

KLASIFIKIMI PER REZERVAT DHE RESURSET NE RAJONIN PERLAT-MUNELLE

Korniza e Kalsifikimit te OKB (United Nations, 1995) permban:

Stadin e vleresimit gjeologjik

Stadin e vleresimit te shfrytezimit

Shkallen e leverdishmerise ekonomike

Mbeshtetur ne klasifikimin e Komisionit Ekonomik per Evropen, Keshilli Ekonomik dhe Shoqeror i Kombeve te Bashkuara, Nentor, 1996 per vendburimet mund te behet ky klasifikim i rezervave te vendburimeve sulfure te rajonit Perlat-Munelle (Tab.3):

Tabela, 3, me klasifikimin e vendburimeve sipas Kombeve te Bashkuara

VB	Klasifikimi kodifikuar	Aksi Ekonomik E	Aksi per mundesi per shfrytezim F	Aksi Gjeologjik G
Reps	3 2 1	3 (potencialisht ekonomik-kufitar)	2 (mundesish i shfrytezueshem)	1 (zbulim i detajuar)
Spaç	2 2 2	2 (potencialisht ekonomik)	2 (mundesish i shfrytezueshem)	1 (zbulim i detajuar)
Lamshkon	2 2 2	2 (potencialisht ekonomik)	2 (mundesish i shfrytezueshem)	1 (zbulim i detajuar)
Gurth Spaç	1 1 1	1 (ekonomik)	1 (mundesish i shfrytezueshem dhe raport miniere)	1 (zbulim i detajuar)
Munella	2 2 1	2 (potencialisht ekonomik)	2 (mundesish i shfrytezueshem)	1 (zbulim i detajuar)
Perlat	2 1 1	2 (potencialisht ekonomik)	1 (mundesish i shfrytezueshem dhe raport miniere)	1 (zbulim i detajuar)
Kullaxhi	3 2 1	3 (potencialisht ekonomik-kufitar)	2 (mundesish i shfrytezueshem)	1 (zbulim i detajuar)
Kurbnesh	- 3 3	-	3 (studim gjeologjik)	3 (studim gjeologjik)

KONKLUZIONE

Rajoni Perlat-Munelle perben segmentin me te rendesishem per sa i perket rezervave, resurseve dhe cilesise te xehoreve sulfure.

Ne pikpamje petrologjike dhe metalogenike, prerjet e sektorit Munelle-Reps jane te ndryshme nga ato te sektorit Perlat-Kurbnesh. Ne per gjithesi ne kete rajon dhe veçanerisht ne zonen Perlat-Kurbnesh nuk mund te flitet per stratigrafi te ofioliteve, por per tektonostratigrafi. Nje kuptim i tille i gjeologjise ka ndihmuar dhe ndihmon ne menyre te drejtperdrejt kerkimin.

Zhvillimi i tektonikes mbulesore intensive ne sektorin Perlat-Kurbnesh e ka erresuar nje vazhdimesi normale per ta quajtuar rajonin Perlat-Munelle (Qafe Mali) "brez" sulfur. Mbeshtetur ne faktore petrologjike, stilin e mineralizimit dhe tektoniken mund te veçohet "segmenti Reps-Munelle (Qafe Mali)" me ngashmeri pothuajse te plote me prerjen e idealizuar te ofioliteve dhe sektori/zona Perlat-Kurbnesh.

Marrja ne konsiderate e tektonikes shkeputese-mbulesore per kerkim te metejshem ka rendesi te dores se pare ne te gjithe rajonin.

Analogjia e mineralizimeve sulfure me ato te Omanit (Ofoliti i Semailit) dhe ato te Qipros (Ofoliti i Trudosit) pavaresisht nga ndryshimet eventuale ne moshe etj. ka rendesi. Analogjia me tymuesit e zinj qe formohen sot, ne pikpamje te radhes se formimit dhe zonalitetit vertikal, veçanerisht per sektorin Reps-Munelle (Qafe Mali) ka rendesi te dores se pare. Edhe per vendburime si Munella, aktualisht, nuk mund te flitet per zonalitet, por per disa lloje xeheroresh. Nje problem i tille do te zgjidhet me avancimin e shfrytezimit.

Nisur nga prania e bashkeshoqerimit sfalerit-kalkopirit-pirit, kryesisht masiv te vertetuar dhe te shfrytezuar ne Gurth Spaç me permbajtje mbi 3 gr/t Au dhe te pranise se mineralit te elektrumit ne Munelle, duhet t'i jepet nje rendesi e veçante studimit te metejshem te elementeve te çmueshem d.mth. arit, çmimi i te cilin kete vit eshte ngritur mbi 330 \$/onc (330 \$/33gr) ndersa çmimi i argjendit eshte rreth 5 \$/once (CNN, EoroNews, 2003).

Ne vendburimin e Kurbneshit, nisur nga trashesia e madhe e zones me trupa xehore dhe paralelizmi midis trupave, tashme te vertetuar nga miniera, duket se mineralizimet jane formuar ne gabro te shtrezezuara

ne rruge magmatike. Vendburime te tilla te tipit magmatik me sulfure Cu-(Au-Pt) ne gabrot e shtrezezuara jane zbuluar dhe shfrytezuar ne Oman. Ne disa trupa te Kurbneshit ka pasur permbajtje te ngritura ari deri mbi 3 gr/t e me shume. Ky tip mineralizimi mund te kerkohet ne rajonin e Qafe Mali-Kurbneshit ku mendohet se jane gabrot e shtrezezuara dhe kane shenja sulfure. Modeli ekonomik pervjuar ne kete artikull ka nevoje te zbatohet per te krijuar nje tablo me te qarte per investitoret serioze.

Falenderim- Falenderojme gjithe koleget e Ndermarrjes Gjeologjike Rubik, Ndermarrjes Gjeologjike Puke, Qendres Gjeofizike dhe Gjeokimike Tirane dhe IKGJ Tirane per bashkepunimin e vlefshem per shume dekada. Falenderojme oponentin T.Deda per verejtjet e vlefshme.

LITERATURA

- Alba-Ita-Baker Corporation S.A., 1994 Studim tekniko ekonomik per nederhyrje ne sektorin e miniera-metalurgji (Studio tecnico-economico per gli interventi nel comparto miniero-metallurgico). Tirane, 47 f.
- Avxhiu R. and Hoxha L., (1998) Integrated geological-geophysical-geochemical methods for sulphide mineralization explorations, Mirdita ophiolite zone, Albania. Per. Mineral.67: 71-85
- Bakallbashi J., Qendro S., Stoja L., Mehilli V. dhe Hajdini G., 1996 Copper potential resources in ophiolites of Albania and new possibilities of their development.Takim Shqiptaro-Italian: Pasurit minerale te ofioliteve shqiptare dhe rinovime teknologjike f.137-142.
- Beccaluva L., Coltorti M., Premti I., Saccani E., Siena F. and Zeda O. 1994., Mid-ocean ridge and supra-subduction affinities in ophiolitic belts from Albania. Ofoliti. Special issue on «Albanian ophiolites: state of the art and perspectives » (Beccaluva L.Ed.) (19) 1: 77-96.
- Bezhani V., Turku I., Zaçaj M., Deda T., Shtjefanaku D., Hoxha L. and Kamberi R., 1985 Mineralizimet e bakrit ne vullkanitet e Mirdites Qendrore. Pozicioni gjeografik, gjeneza, perspektiva. Bul. Shk. Gjeol. Tirane 4:181-191.
- Daci A., 1986., Raport mbi rezultatet e punimeve gjeologo-zbuluese dhe llogaritjen e rezervave ne vendburimin Perlat. Fondi Qendor i SHGJSH.
- Daci A., Doda V., and Zaçe M., 1995 Pseudostratiform copper deposit in the upper lavas (Perlati area, Mirdita zone). Workshop on Albanian ophiolites and related mineralization. IUGS/UNESCO Modeling Programme. Documents du BRGM 244. f.77.
- Deda T., Sinoimeri A., Lleshi N., Leka Gj. Etj., 1995., Geological and mineralogical aspects of the Munella gold-bearing sulphide deposit. Workshopen Albanian ophiolites and related mineralization, IUGS/UNESCO Modeling Programme, fq 78-79.
- Delaj E. 1985 Rreth gjeologjise dhe mineralizimit sulfur te rajonit bakermajtes Palaj-Karme. Buletini i Shkencave Gjeologjike nr. 3.
- Doda V., 1983 Raport mbi rezultatet e punimeve gjeologo-zbuluese per vendburimin Perlat dhe llogaritjen e rezervave me gjendje 1.1.1983. 165f. Fondi Qendor i SHGJSH
- Eyre J.M., Stewart A., Scott P.W., Hoxha L. and D.Gega, 2002 The climate for development of Albania's mineral resources. Transactions of the Institution of Mining and Metallurgy(Sect.B: Applied Earth Science), vol.p.B95-B99.London.
- Ferrini V. and Mignardi S. 2002., Gold in the polymetallic deposit of Munelle (Northeastern Albania). Extended abstract, 11th IAGOD Quadrennial Symposium and Geocongress, Windhoek, Namibia. Geological Survey of Namibia. CD.
- Galley G.A. and Koski A.R., 1999., Setting and characteristics of ophiolite-hosted volcanogenic massive sulphide deposits. Reviews in Economic Geology, Vol.8, f.221-246
- Hadroj Xh., Gjoni S., Pjetri N., Ndoka M., Lleshi., N Aliaj P., Hasa B... etj. 2000., Pasurite minerale te rrethit te Pukes dhe Harta gjeologjike ne shkalle 1:50000. Fondi Qendor i Deges Rajonale Puke.

- Hoxha L, Berxhiku P and Daci A., 1988 Efektet e tektonikes shkeputese-mbulesore per kerkimin e mineralizimeve sulfure ne rajonin Kurbnesh-Tarazh-Perlat. Bul. Shk. Gjeol. 3:7-20.
- Hoxha L. and Zaganjori B. 1998., Sulphide mineralization zoning of the Spac-Gurthspac area (SSZ Ophiolites, Albania): a Case history. Per. Mineral. 67, 87-93.
- Hoxha L., Prenga Ll., Deda, T., Imami S., dhe Gjeçi K., 2001 Pergjithesimi i punimeve komplekse gjeologo-gjeofizike-gjeokimike te kryera ne rajonin Reps-Spac-Gurth Spac-Qafe Bari-Qafe Mali, Bicaj, Shmi. Fondi Qendor i SHGJSH.
- Hoxha L., 2001., The Jurassic-Cretaceous orogenic event and its effects in the exploration of sulphide ores, Albanian ophiolites, Albania Eclogae geol. Helv. 94 (2001) 339-350.
- Hoxha L., 2002., Tectonostratigraphy of Albanian ophiolites. 2002 Abstracts 37th Annual Meeting NE Section, Spring Massachusetts, USA, Vol.34, N-1, 2002, ISSN 0016-7592.
- Hoxha L., Çakalli P. dhe Shtjefanaku D., 2002 Rivleresimi i vendburimeve te bakrit te Shqiperise dhe perspektiva e metejshme e kerkimit. Fondi Qendor i SHGJSH
- Hysi Sh. dhe Jonuzi S., 1974 Raport i llogaritjes se rezervave ne vendburimin Perlat ISPGJ-IGJN 1990., Gjeologja e Shqiperise, Tirane, Albania, f.1-432.
- ISPGJ-FGJM ne bashkpunim me ndermarjet gjeologjike dhe Ndermarrjen Gjeofizike, Tirane, Metalogjenia e RPSSH, 1988, 563f.
- ISPGJ-FGJM., 1999 Harta Metalogjenike e Shqiperise; shkalle 1: 200 000,Tirane, Albania.
- Jorjani V., 1967., Raport i llogaritjes se rezervave ne vendburimin Kurbnesh
- Kamberaj R., Bardhoshi N., 1980., Raport mbi rezultatet e punimeve te kerkim-zbulimit gjendja e rezervave te vendburimit Munelle me gjendje 1.1.1980. Fondi Qendor i SHGJSH
- Kamberaj R., Deda T., 1987., Pozicioni hapesinor dhe gjenetik i mineralizimeve sulfure ne rajonin Mushte - Qafe Mali. Bul. i Shkenc. Gjeol. nr 2 f. 13-37. Fondi Qendor i SHGJSH
- Kati P., 1971., Perhapja e sfaleritit ne zonen e Mirdites dhe formimi i mineralizimit sulfid ne pergjithesi. Permblehdhe Studimesh nr 2. f29-40.
- Kati P., Çarçani T., Deda T., Sinoimeri A., Pjetri N., 1987., Mineralogja dhe kimizmi i xehoreve te Munelles, f. 172.
- Kaza Gj., Ndreca N., 1996., Raport mbi rezultatet e punimeve te kerkim-zbulimit ne vendburimin Lamskon me gjendje 1.7.1994 (Material ne doreshkrim, Dega Rajonale Rubik).
- Koçi M., 1977., Ndryshimet anesore perrreth trupave xehore te bakrit ne baze te studimeve mineralogo-petrografike. Permblehdhe Studimesh Nr. 2, f. 37-48.
- Kodra B., Llubani B., 1979., Raport mbi vlersimin kompleks te vendburimit Gurth dhe llogaritja e rezervave me gjendje 1.1. 1979. Fondi Qendor i SHGJSH.
- Kolndreu D., Sulejmani Ll., Jonuzi S., Zeçollari., B., Lleshi K., 1984., Ndertimi gjeologjik dhe llogaritja e rezervave te vendburimit Spac me gjendje 1.1.1984, f. 218. Fondi Qendor i SHGJSH.
- Kolndreu D., 1992., Some sulphur isotopic data copper ore deposits in the central Mirdita ophiolite complex. A genetic discussion. Working Group Meeting nr 256. Kongresi i 8 te Shqipetar i Gjeoshkencave, f. 31-32.
- Leka P., Nenaj S and Hoxha L., 1995., The deep geophysical survey of sulphide ores in Albania. Bul. Shk. Gjeol. 2: 69-75.
- Leka, Gj., 2001 Gjeologja e vendburimeve Qafe Bari-Munelle (Disertacion ne proces), 2001.
- Lulo P., Jonuzi K., 1982., Raport i lllogaritjes se rezervave ne Kullaxhi. Fondi Qendor i SHGJSH.
- Lleshi N., Leka Gj., Deda T., 1989., Raport mbi rezultatet e punimeve gjeologjike te kerkim-zbulimit ne vedburimin Munelle dhe llogaritja e rezervave me gjendje 1.1 1989. Fondi Qendor i SHGJSH.
- Llubani B., 1972 Raport i lllogaritjes se rezervave ne Rrenjolle. Fondi Qendor i SHGJSH
- Llubani B., Kodra B., Koka R., 1977., Raport mbi rezultatet e punimeve te kerkim-zbulimit ne vendburimin Gurth dhe llogaritja e rezervave me gjendje 1.4. 1977. Fondi Qendor i SHGJSH.

- Llubani B., Kodra B., 1984., Raport mbi rezultatet e punimeve te kerkim-zbulimit ne vendburimin Gurth dhe llogaritja e rezervave me gjendje 1.1. 1984. Fondi Qendor i SHGJSH.
- Marcucci M., Kodra A., Pirdeni A., and Gjata T., 1994., Radiolarian assemblage in the Triassic and Jurassic cherts of Albania. Ofioliti. Special issue on Albanian ophiolites: «state of the art and perspectives» (Beccaluva L. Ed.), 19 (1), 105-115.
- Marku D., 2002., Kretaku i rajonit Zepe-Guri i Nuses. 62 f. Arkivi I IKGJ, Tirane
- Meschede M., Zweigel P., Frisch W. and Völker D., 1999 Mélange formation by subduction erosion: the case of the Osa mélange in southern Costa Rica. Blackwell Science Ltd. P.141-148.
- Mustafa F., Legisi M., Shtjefanaku D., Pulaj H., Daci A., Doda V., 1996., Petrology and metallogenetic features of volcanics of the two ophiolitic belts of Albania f. 234-239.
- Mustafa F., 1998., Metalogeny of the sulphide mineralization related to the volcanics of the two ophiolite belts of Albania. (Veçorite metalogenjike te shkembinjeve vulkanogjene te dy brezave ofiolitike te Shqiperise). Buletini i Shkencave Gjeologjike, f. 51-68.
- Ndreca N., Ndoci M., Jonuzi S., 1986., - Raport mbi rezultatet e punimeve te kerkim-zbulimit dhe llogaritja e rezervave te vendburimit Lgjin-Reps-Laj dhe objektet Shkalla e Repsit me gjendje 1.5.1986. Fondi Qendor i SHGJSH.
- Ndoci M., 1984., Raport i llogaritjes se rezervave ne Laj-Reps. Fondi Qendor i SHGJSH
- Penrose field conference on ophiolites., 1972: article on conferences proceedings: Getimes, v.17, p. 24-25.
- Puljo H., 1980., Raport i llogaritjes se rezervave te vendburimit Kurbnesh (i paperfunduar)
- Prela M., 2000., Korrelimi i sekuenave radiolaritike te mbuleses paresore sedimentare te dy brezave ofiolitike te zones Mirdita. Tirane, pp 1-109.
- Robertson A., Shallo M., 2000 Mesozoic-Tertiary tectonic evolution of Albania in its regional Eastern Mediterranean context, 2000., Tectonophysics 316 (2000) 197-254.
- Sinoimeri A., 1990., Minéralogie et paragenèses du gisement volcanogénè à Munella, Mirdita Central, Albanie. These pré senté Université d' Orléans, France pp.161.
- Shallo M., Kote Dh., Vranaj A. and Premti I., 1985., Magmatizmi ofiolitik i Shqiperise. Tirane, Albania, pp 1-362.
- Shallo M., Kodra A and Gjata K., 1990., Geotectonics of the Albanian ophiolites. Ophiolites oceanic crustal analogues. Proceed. Of the Sympos. "Troodos 1987" edited by Malpas J., Moores E.M., Panayiotou and Xenophontos. Publ. By The Geolog. Survey Dep. Ministry of Agricul. And Natural Resources, Nicosia, Cyprus, f. 265-269.
- Shallo M., 1990 Volcanic glasses of the Albanian ophiolitic belt. Ophiolites oceanic crustal analogues. Proceed. Of the Sympos. "Troodos 1987" edited by Malpas J., Moores E.M., Panayiotou and Xenophontos. Publ. By The Geolog. Survey Dep. Ministry of Agricul. and Natural Resources, Nicosia, Cyprus, f.271-278.
- Shallo M., 1994., Outline of the Albanian ophiolites. Ofioliti (19) 1: 57-75.
- Shallo M., 1992 Geological evolution of Albanian ophiolite and their platform periphery. Geol. Rundsch. 81 (3), 681-694.
- Turku I., 1992., Vullkanizmi ofiolitik dhe mineralizimi lidhur me te. Dizertacion. Tirane, 210 f.
- Zaçaj M. 1987., Mineralizimi baker-sulfur ne vedburimin Perlat te rrethit te Mirdites dhe ne rajonin rreth tij (Disertacion).
- Zaganjori, B., 1987 Raport i lllogaritjes se rezervave ne Letiten.
- Zaçaj, M., Shallo, M., Deda, T., Daci, A., Çina, A. dhe Alliu, I., 2001 Gjeologja dhe metalogjenia e mineralizimeve sulfure te bakrit te Shqiperise (Monografi). 239f.
- Zoi N., Kamberaj R., 1984., Raport mbi rezultatet e punimeve te kerkim-zbulimit dhe llogaritja e e rezervave te vendburimit Munelle me gjendje 1.1.1984. Fondi Qendor i SHGJSH.

United Nations, Economic and Social Council, Economic Commission for Europe, United Nations International Framework., 1995 Classification for Reserves/Resources (In accordance with decision of the Workshop held in Hannover, Dec.1995, ENERGY/WP.1/R.54, par.13 (9)

ABSTRACT

The paper deals with geological, metallogenetic, tectonic issues and some economic aspects of Perlat-Munelle region, from the most important areas in viewpoint of discovered sulphide ores as well as potential resources.

The ophiolites of the areas are constituent part of Albanian Eastern Ophiolite Belt widely accepted, formed on a supra subduction zone (SSZ) with distinct petrologic, petrographic, style of the mineralization as well as tectonics.

Compared with idealized section of ophiolites (participants of Penrose Conference, 1972) northern part of the area (Reps-Munelle/Qafe Mali) displays important changes in viewpoint of petrology, style of mineralization and especially tectonics, despite almost the same age of these ophiolites (Middle Jurassic-early Late Jurassic).

In this point of view only Reps-Munelle (Qafe Mali) segment can be compared with Penrose section, whilst Perlat-Kurbnesh area based on boninitic content of volcanics, should present an early stage of SSZ ophiolites.

The sections of Reps-Munelle (Qafe Mali) area both in petrologic point of view as well as on style of mineralization, similar with Middle East (Cyprus and Oman) ophiolites, despite the oldest age of Albanian ophiolites, being compared the three above ophiolites with idealized ophiolite section.

The similarity of mineralization style, especially of northern part (Reps-Munelle/Qafe Mali) with "black/white smokers", actually under formation at mid-Atlantic ridge, especially in unity of massive with stockwork mineralization point of view as well as in principal constituent elements is impressive.

In change from traditional order of sulphide phases accepted to us, pyrite-chalcocite-sphalerite, based on the up to date studies and the latest literature data, would suggest this order of sulphide phases: in the first stage, sphalerite+galena+pyrite+barite in about 200 °C and the late stage with pyrite-chalcocite+quartz, in about 300-350 °C.

The latest measurements of $\delta^{34}\text{S}$ isotope are in conformity with the previous determinations and indicate that magmatic fluids had generated sulphide mineralizations.

Thrusting tectonics has determined the geological features of the region and especially the Perlat-Kurbnesh area. The thrusting tectonics has prevented to be displayed southern continuation of northern Munelle-Reps segment. The repeating several times in section down to the lowermost levels of ophiolites (gabbro, diorite-quartzdiorite, ultramafics) during late Jurassic-Early Cretaceous orogenesis event, is followed by Berriasian-Valanginian deposits which in turn is overthrust by ultramafics overlain by Barremian-Aptian carbonates.

The evidencing of thrusting tectonics has been used as a tool in exploration for searching beneath the thrusting planes.

Comparing the reserves found in Albanian ophiolites with the reserves found in Middle East (Cyprus, Oman and Turkey) ophiolites, come about that, in Albanian ophiolites are found more reserves than the above mentioned areas. In principal constituent elements as well as precious elements (Au, Ag) point of view the analogy is alike.

Based on the facts that sphalerite-chalcocite-pyrite assemblage, mainly massive ores, has been high grade in Au, in average more than 3 g/t. (e.g. Gurth Spac), also during mining this type of mineralization, needs to be selected. The low sulphide zones as well as argillite ones, needs to be evaluated for precious elements.

Phryrotite-chalcocite-quartz type (e.g. Kurbneshi deposit) or Cu-(Au-Pt) type hosted by stratified gabbros, should be a target of a careful exploration, at the possible stratified gabbros of Qafe Mali-Kurbnesh area.

Applying of a comprehensive financial model in copper industry as well as improvements in Mining Legislation are necessary for reviving of this sector of economy.

DISA LIGJËSI TË PËRHAPJES SË ZN DHE PB NË VENDBURIMIN E HAJVALISË

Bedri Durmishaj*, Artan Tashko**, Sylejman Hyseni*

HYRJE

Ky artikull paraqet rezultatet e studimit te përbajtjes së Zn dhe Pb, si dy komponentët me rëndësi më të madhe ekonomike në horizontet shfrytëzuese të vendburimit polimetalar të Hajvalisë si dhe elementit kryesor shoqëruesh, Ag. Vendburimi Hajvalisë është një nga vendburimet polimetaloore më të pasura në Zn në Europë. Ai bën pjesë në fushën xherore "Hajvali – Badovcë – Kishnicë", metalogjenia e së cilës lidhet gjenetikisht dhe në kohë me magmatizmin andezitik të terciarit [1, 8, 9].

Në bazë të hulumtimeve të deritanishme, shihet se në kuadër të kësaj fushë xherore, xehet e plumbit e zinkut janë përqëndruar në tri vendburime kryesore: Hajvali, Badovcë e Kishnicë si dhe në një numër të madh të shfaqjeve xherore si Lëndina e Matçanit, Gradinë, Gvozdenik etj..

Shoqërueshit kryesorë të Zn në këtë vendburim janë Pb dhe Ag, ndërsa elementë të tjera si Cd, Bi, Au etj., gjenden në sasira më të vogla.

Interesi i këtij studimi qëndron përveç se në aspektin njohës teorik edhe në faktin që në gjendjen aktuale po bëhen përpjekje për një riaktivizim të kësaj pasurie të madhe të Kosovës, duke synuar dhe mundësinë e zgjerimit të mëtejshëm të fushës xherore. Të dhënat gjeokimike që paraqiten në këtë artikull do të ndihmonin në këtë drejtim për një interpretim sa më real të të dhënavë gjeologjike dhe minerare.

Studimi bazohet ne të dhënat e minierës së Hajvalisë të marrune gjatë viteve të shfrytëzimit të tij [2, 4, 6, 11, 15, 16]. Përbajtjet e Zn dhe Pb janë përcaktuar në prova të veçanta në rrugë kimike për llogaritje të rezervave në laboratorin e minierës, kurse përbajtjet e Ag, Cd, Bi etj. janë analizuar vetëm në prova të bashkuara. 30 prova përfaqësuese të vendburimit janë analizuar veçmas për Zn, Pb dhe Ag në laboratore të BRGM, Francë.

NDERTIMI GJEOLOGJIK I VENDBURIMIT DHE VENDOSJA E MINERALIZIMIT.

Në ndertimin gjeologjik të vendburimit të Hajvalisë marrin pjesë shkembinjt paleozoikë (deri në T?) të serisë metamorfike, serpentinitet me depërtimet e gabro – diabazeve, sedimentet flishore të kretakut dhe depozitimet më të reja te kuaternarit [2, 6, 11, 12, 13]. (fig.1)


Është me rëndësi për t'u theksuar se, në kuader të fushes xherore të këtij vendburimi, pjesëmarrje më të madhe kanë shkëmbinjt e serisë metamorfike, që e dallon këtë vendburim nga dy vendburimet e tjera te fushës xherore "Hajvali - Badovcë – Kishnicë". Një karakteristikë tjeter është fakti që në këtë vendburim mungojnë vullkanogenjet e terciarit me të cilët mendohet se lidhen gjenetikisht vendburimet e fushës xherore. Së fundi, ky mineralizim karakterizohet nga predominimi i tipit metasomatik të mineralizimit, përqëndruar në shkëmbinjt karbonatikë të serisë metamorfike, ndërsa mungon tërësisht mineralizimi i lokalizuar në serpentinite. Në rreshpet metamorfike të pjesës së siperme mineralizimi njihet si i tipit "oligonit". Mineralizimet me të rendesishme, të lokalizuara në shkembinjt karbonatikë perbëjnë rezervat kryesore të vendburimit.

Perveç ketyre mineralizimeve shfrytëzohen edhe ato të tipit të oligoniteve me më pak rëndësi.

Njihen 4 trupa xherorë, nga të cilët trupi 1 është më i rendësishmi [2].

Në serinë metamorfike marrin pjesë antaret litologjikë me superpozicionë të caktuara ndaj trupave xherorë.

- filitet e tabanit (rreshpe të errta, deri në të zezë, perbehen nga kuarci, sericit, grafiti, kalciti dhe turmalina, pa kurfar ndryshimesh hidrotermale).
- rreshpet e ndritëshme kristalore (rreshpet sericitike, kuarc-sericitike, kloritike), përfshirë shkëmbinjt karbonatikë (gelqerorë të rikristalizuar "kristalorë", mermerët dhe rreshpet karbonatike.)



LEGJENDA

[Dotted Lines]	Sedimente te Terciarit	[S]	Serpentinite	[Diagonal Lines]	Prishje tektonike
[V]	Andezite	[Diagonal Lines]	Diabaze	[Solid Oval]	V.burimet polimetaloore
[Dashed Line]	Flish	[Dotted Lines]	Rreshpe metamorfike		

filitet e tavanit (rreshpe të errta, deri në të zezë, perbehen nga kuarci, sericit, grafiti, kalciti dhe turmalina, janë në menyrë intensive të silifikuar dhe nganjehere paraqiten me mineralizim të dobët). Trashësia e serisë metamorfike është 300–400 metra.

Serpentinitet (jurasicë?) gjinden në periferi të v.b. dhe nuk janë të prekur nga mineralizimi. Depozitimet kretake përfaqësohen nga sedimentet flishore që janë të përberë në pjesen më të madhe nga shtresat argilo – mergelore, ranore, argilo-ranore dhe mergelore. Sipas studimeve mikrofaunistike mosha relative e këtyre sedimenteve është e kretakut të sipërm (Cenomanian).

DISA LIGJESI TE PERHAPJES SE Zn DHE Pb NE VENDBURIMIN E HAJVALISE

Në pikëpamje strukturo - tektonike fusha xeherore "Hajvali-Badovcë-Kishnicë" është pjesë përbërse e zones lindore të thyrjes së thellë të Kopaunikut [8,10]. Kjo thyrje në regionin e Hajvalisë dhe të Kishnices është e ndarë në tri njësi më të vogla (të rendit më të ulët) strukturoro-tektonike, që janë:

- Zona e thyrjes "Hajvali-Badovcë".
- Zona e thyrjes "Kishnicë".
- Zona e thyrjes "Okosnicë".

Këto zona të thyrjes kapin një gjërsë deri 100m, janë kontrollues të vullkaniteve të terçierit si dhe kontrollues të mineralizimeve në vendburimet përkatese. Zona e thyrjes "Hajvali-Badovcë" ka perhapje që nga veriu i Hajvalisë duke percjellë brezin kontaktues të rreshpeve kristallore me serpentinitet e masivit Goleshë-Gvozdenikë, duke vazhduar më tutje në mes të rreshpeve kristallore dhe sedimenteve të kretakut ose formacionit diabazo-strallor deri në Okllapë.

Kjo zonë tektonike shoqërohet edhe me struktura të rendeve më të ulëta, që në bazë të drejtimit të shtrirjes i sistematizojmë në [2]:

- zhvendosje gjatësore, me drejtim të shtrirjes VVP - JJL ose VP - JL dhe rënije kah VL,
- zhvendosje diagonale, me drejtim gati meridional (350°) dhe rënije kah lindja.
- zhvendosje tërthore, normal me shtrirjen e antarëve litologjikë.
- zhvendosje normale me drejtim shtrirjeje lindje - perëndim.

Në fushën xeherore paraqiten edhe struktura plikative (rrudha) [0]. Këto struktura kryesisht i hasim në rreshpet kristallore, por edhe në sedimentet e kretakut. Në ndonjë rast konfiguracioni i rrudhës mund të vërehet edhe në trupat xeherorë (rrudhë asimetrike me boshtin e pergjithshem të zhytjes në JL.). Sidoqoftë, të dhënat e deritanishme tregojnë që të gjithë këto elementë tektonikë përfaqësojnë struktura parësore në vendburimin e Hajvalisë, pra i takojnë strukturave të paramineralizimit. Ato kanë shërbyer si faktorë kontrollues për qarkullimin e tretjeve xeherore dhe formimin e trupave xehërorë metasomatik. Tektonika e pasmineralizimit është zhvilluar më dobët, kryesisht si riaktivizim i zhvendosjeve diagonale e tërthore.

PERBERJA MINERALOGJIKE

Sipas studimeve të kryera në këtë vendburim [14] përbërja mineralogjike paraqitet si në Tabela 1.

Mineralet metalore	Mineralet jometalore	Mineralet sekondare	Mineralet relikte
Pirotina	Kuarci	Ceruziti	Magnetiti
Kalkopiriti	Sideriti	Angleziti	Ilmeniti
Valeriti	Mn - sideriti	Xhemsoniti	Grafiti
Sfaleriti	Rodokroziti	Goslariti	
Staniti	Mn-Kalciti	Melanteriti	
Arsenopiriti	Bariti	Gjipsi	
Galeniti	Kalcedoni	Limoniti	
Tetraedriti			
Burnoniti			
Falkmaniti			

Tabela 1 Përbërja mineralogjike e xeherorëve të v.b. Hajvalia.

Vërehen tre gjeneracione kryesore mineralogjike, përkatësisht të fazave hipo, mezo e epitermale. Përqëndrimet më kryesore të Zn lidhen me fazën mezotermale, kurse të Pb me faza të mëvonëshme.

PERBERJA KIMIKE DHE SHPERNDARJA E ZN, PB NE TRUPAT XEHERORE

Bazuar në të dhënat e analizave kimike të kampionave të mineralizimeve në vendburimin polimetalar të Hajvalisë, rezulton se xeheroret polimetalarë kane përbajtje të lartë të komponenteve të dobishme si Pb, Zn dhe Ag. Kështu, në vendburimin e Hajvalisë përberja kimike e xeherorit është mesatarisht:

Pb-5.55%	Bi-0.015%
Zn-8.70%	Sn-0.014%
Ag-60 g/t	Cu-0.05%
S-14.35%	
Au-0.5 g/t	

Shpërndarja e elementeve kryesore në vendburim karakterizohet me koeficient të varacionit sa vijon :

$$\begin{aligned} K_v^{Pb} &= 77.22\% \\ K_v^{Zn} &= 62.52\% \\ K_v^{(Pb+Zn)} &= 55.25\% \end{aligned}$$

Sa i përket komponentëve jo xeherorë rezultojnë këto përbajtje mesatare:

SiO_2 - 24.60%, MgO -0.87%, MnO -5.18%, CaO -1.23% dhe Al_2O_3 -7.40%

Siq shihet, elementet kryesorë me rëndësi ekonomike janë plumbi, zinku dhe Ag, përtë cilët llogariten edhe rezervat industriale të vendburimit. Përveç elementeve kryesorë gjatë procesit teknologjik ekstradohen edhe elemente të tjera shoqëruar si Au, Cd, Bi, etj. Për Au rezulton një lidhje e fortë e tij me Zn, përkatësisht sfaleritin [7]. Të dhënat mineralogjike kanë vërtetuar gjithashtu praninë e arit të lirë, lidhur kryesisht me masën e kuarcit, mirëpo një pjesë të mirë të tij e takojmë edhe në kontaktin në mës të piritit dhe sfaleritit të gjeneratës së tretë. Me sfaleritin lidhen gjithashtu përbajtjet e disa elementeve të shpërndarë. Sipas [9], analizat e bëra në sfalerite tregojnë sa vijon :

$Fe=8.12\%$, $Cd=0.1\%-0.3\%$, $Mn=0.2-1\%$, $Ag = 10-20 g/t$, $Sn = 30-50 g/t$, Ga -deri në 3 g/t.

Përsa i përket Ag, të dhënat mineralogjike tregojnë për praninë e pirargiritit. Të dhënat gjekimike (Figura 1) sugjerojnë një korelim shumë të fortë të Ag me Pb, çka mund të lidhet si me bashkëshoqërimin e pirargiritit me galenitin ashtu dhe pasurimin izomorfik të galenitit me Ag.




Figura 1 Korelimi i përbajtjeve të Zn dhe Pb me përbajtjet e Ag

Tabela 2 Koeficientet e korelimit, bazuar ne 30 analiza kimike përfaqësuese të vendburimit.

	Pb	Zn	Ag
Pb	1		
Zn	-0,36	1	
Ag	0,97	-0,33	1

Në mjaft nga koridoret e studjuara prej nesh nuk vërehet një shpërndarje karakteristike e Zn dhe Pb me rritje në pjesët qëndrore të trupit dhe rënje graduale drejt pjesëve anësore të tij. Përkundrazi, vërejmë shpesh rritje të përbajtjeve në kontaktin e trupave me shkëmbinjt dhe rënje brenda trupit. Përputhja e të dhënavë gjeokimike me dokumentimin gjëologjik të koridoreve tregon që kjo shpërndarje jo simetrike kontrollohet kryesisht nga faktori litologjik. Përndryshe, bie në sy mos korrelimi i përbajtjeve të Zn me ato të Pb. Për të nxjerrë më në pah këtë fakt, në figurat e mëposhtëme, kemi paraqitur edhe luhatjet e raportit Zn/Pb. Ky raport, në rastet e studjuara nga ne luhatet mesatarisht nga 2 deri në 3,1, por në prova të veçanta gjemjë vlera nga 0,3 deri në 12,1. Nëse raporti Zn/Pb në vlera 2 - 3, mund të konsiderohet si një karakteristikë e vendburimit të Hajvalisë, përkatësisht e përbërjes kimike të hidrotermave, luhatjet 6 deri 10 herë mbi këto vlera mesatare në prova të veçanta duhet të tregojnë përkushte të caktuara lokale. Siç duket nga figurat e mëposhtëme shpërndarja e Zn dhe Pb në trashësinë e trupave ka luhatje jo të vogla, çka tregon për natyrën jo homogjene të procesit metasomatik, kushtëzuar kryesisht nga faktori litologjik dhe intensiteti i aktivitetit kimik të hidrotermave.

Figura 2 Shpërndarja e Zn, Pb dhe e raportit Zn/Pb ne trashësin e trupit xeheror sipas provave të marra në koridorin 805, horizonti VIII.





Figura 3 Shpërndarja e Zn, Pb dhe e raportit Zn/Pb ne trashësin e trupit xeheror sipas provave të marra në koridorin 851, horizonti VIII-a.

SHPERNDARJA E ZN DHE PB NE TRUPIN XEHEROR 1 NE HORIZONTIN 9.

Trupi xeheror 1 në horizontin 9 që është horizonti më i thellë deri ku kanë vazhduar punimet e shfrytëzimit, është zgjedhur për të parë mundësinë e kërkimit të mëtejshëm në thellësi, por dhe sepse përfaqëson trupin që më mirë se kudo paraqet morfollojinë e një rrudhe të mineralizuar. Sipërfaqja e përgjithshme e trupit është 2900m². Mineralizimi është i tipit metasomatik që ka zëvendësuar karbonatet e rrudhosura në një rrudhë asimetrike. Kjo morfolloji e mineralizimit duket qartë ne shpërndarjen gjëokimike të metaleve të studjuar (Figura 4, Figura 5 dhe Figura 6).

Gjithsej 144 prova	Zn	Pb	Zn+Pb	Zn/Pb
Mesatarja	21.6	11.7	33.4	2.8
Devijimi Standart	8.6	9.1	12.1	2.1
Minimumi	1.49	0.25	1.74	0.16
Maksimumi	43.7	53.5	69.35	12.14

Tabela 3 Disa të dhëna statistikore mbi shpërndarjen e Zn, Pb, shumës dhe rapportit të tyre në trupin 1 në horizontin 9.

Shpërndarja e Zn (Figura 4) tregon shpesh ndërprerje të menjëhershme të përbajtjeve shumë të larta, që nuk mund të shpjegohet as me potencialin kimik të hidrotermave e as me arsyen tektonike, por me faktorin litologjik. Kështu kemi përqëndrime shumë të larta në shkëmbinj karbonatikë të zëvendësuar metasomatikisht që kalojnë direkt në sfond kur kontaktojnë me filite. E njëjtë gjë vërehet edhe në shpërndarjen e përbajtjeve të Pb (Figura 5), ku shpesh "piket" gjenden në kufi të trupit xheror e jo në qendër të tij. Tërheq vëmendjen fakti që në këtë trup nuk kemi një korelim të qartë hapsinor të përbajtjeve të larta të Zn me ato të Pb, që vërejtëm më lart në përgjithësi për vendburimin (Tabela 2). Kjo duket edhe më qartë në Figura 6.

Mos korrelimi hapsinor i përbajtjeve të Zn me ato të Pb (ndërsa kemi një korrelim shumë të mirë Pb-Ag) përbën një veçori të vendburimit. Ky mos korrelim hapsinor mund të jetë i lidhur me evolucionin kohor te përbërjes së hidrotermave dhe kushteve fizike të kristalizimit, kryesisht temperaturës. Përbajtjet më të larta të Zn lokalizohen aty ku faza mezotermale e mineralizimit ka qenë më e zhvilluar, kurse përbajtjet më të larta të Pb lidhen me zhvillimin më të theksuar të fundit të fazës mezotermale dhe fazën epitermale, pra në temperaturë më të ulta.




Figura 4 Shpërndarja e Zn në trupin 1 në horizontin 9.




Figura 5 Shpërndarja e Pb në trupin 1 në horizontin 9.

Merat reale dhe te interpoluara te raportit Zn/Pb




Figura 6 Vlerat reale dhe te interpoluara te rapporti Zn/Pb në trupin 1 në horizontin 9.

SHPERNDARJA E ZN DHE PB NGA HORIZONTET E SIPERM NE DREJTIM TE THELLESISE.




Figura 7 Sjellja gjeokimike e Zn, Pb (A) dhe rapportit të tyre (B) në zhytje të trupit 1 nga kuota 420 metra deri në kuotën 245 metra

deri ne thellësinë më të madhe të sfrytëzuar. Raporti Zn/Pb arrin maksimumin (2 -2,5) ne intervalin e kuotave 345-295 metra, duke vazhduar në thellësi po në ato vlera si dhe në pjesët më sipërfaqësore (rreth 1,5). Siç shihet horizontet më të thellë nuk tregojnë asnje shenje të një mbylljeje gjenetike të trupit xheror kryesor, 1, në thellësi. Përkundrazi, nga pikpamja gjeokimike duhet pritur një zhvillim më në thellësi i trupit, të paktën me po atë intensitet mineralizimi dhe me po atë predominim të Zn ndaj Pb si dhe në horizontet më të thellës në shfrytëzim.

PERFUNDIME

- 1 Vendburimi i Hajvalisë, i njojur botërisht për përbajtjet shumë të larta të Zn, por dhe me përbajtje të larta Pb e Ag, nuk mbyllt gjenetikisht ne horizontin 9, që është horizonti më i thellë i zbuluar. Përkundrazi, nga pikpamja gjeokimike, duhet pritur një zhvillim më në thellësi i trupit, të paktën me po atë intensitet mineralizimi dhe me po atë predominim të Zn ndaj Pb si dhe në horizontet më të thellë të shfrytëzuar.
- 2 Tendenca e përgjithshme e aktivitetit kimik të hidrotermave ka qenë një depozitim konstant i metaleve në pjesët e sipërme të vendburimit dhe një rritje e prurjes së tyre deri ne thellësinë e horizontit 9. Raporti Zn/Pb arrin maksimumin ne intervalin e kuotave 345-295 metra, duke vazhduar në thellësi po në ato vlera si dhe në pjesët më sipërfaqësore (rreth 1,5).
- 3 Shpërndarja e Zn dh Pb brenda trupave xherorë duket se kontrollohet kryesisht nga faktori litologjik (karbonatet me të përshtatëshëm dhe filitet ekranizuese). Mos korrelimi hapsinor i përbajtjeve të Zn me ato të Pb lidhet me kushtet e favorëshme ose jo të zhvillimit intensiv të fazës mezotermale të hidrotermave.
- 4 Faktor kryesor që kontrollon përbajtjet e Au në xherorë është kristalizimi i sfaleritit.
- 5 Faktor kryesor që kontrollon përbajtjet e Ag në xherorë është kristalizimi i pirargiritit dhe galenitit.

LITERATURA

- 1 Cissarc A.(1951), Bericht Uber eine Befahrung des Pb-Zn-Vorkommens von Ajvalija. Fond str.dok."Geozavod", Beograd.
- 2 Durmishaj B. (2002), Gjendja dhe perspektiva e v.b. Hajvalia. (Mikrotezë), Mitrovicë.
- 3 Hyseni S. (2000), Tipet morfologo-gjenetike të mineralizimeve polimetaloore të fushës xherore "Hajvali-Badovc-Kizhnicë" dhe potenciali industrial, (Mikrotezë), Tiranë.
- 4 Hyseni S.(2000), Veçoritë Metalogenike të mineralizimeve polimetaloore të Fushës xherore "Hajvali-Badovc-Kizhnicë"(Disertacion), Tiranë.
- 5 Hyseni S., Durmishaj B. (2002), Paraqitura e strukturave parësore në horizonte shfrytëzuese në vendburimin e Hajvalisë. Buletini i Shkencave Teknike, 2,2002, UP, Tiranë.

- 6 Julia A.(1938), Note sur la mine de Ajvalija. Fond Geozavoda – Beograd
- 7 Jourdaine P.(1937), Beleške o istra•nim radovima kod Ajvalije Fond. Geozavoda – Beograd.
- 8 Jankoviè S. (1990), Rudna le•ista Srbije: Regionalni metalogenetski polo•aj, Sredine stvaranja i tipovi le•ista. Beograd.
- 9 Jankoviè S.(1995), Opšte metalogenetske karakteristike kopaonièke Oblasti. Savetovanje o geologiji i metalogeniji Kopaonika, Beograd.
- 10 Kossmat F.(1924), Geologie der zentralen Balkan halbinsel, Berlin.
- 11 Klisiè M.(1995), Le•iste olova i cinka u rudnom polju Ajvalija-Ki•nica. Savetovanje o geologiji i metalogeniji kopaonika, Beograd.
- 12 Miletiae G.(1997), Strukture kontrole vulkanskikh aparata i prateæih orudnjena olova i cinka, Kopauniæke Metalogenetske oblasti (Simpozium IRL) – Beograd .
- 13 Miæiae I.(1980), Kontaktne,pneumatolitske,hidrotermalne promene u vulkanskim stenama Kopaoniæke oblasti.Rasprava geol.I geof. Istr.XIX, Beograd.
- 14 Smejkal S.(1960),Strukture mineralizacije, mineralnih parageneza I geneze olovo – cinkovo (Doktorska disertacija), Beograd.
- 15 Schumacher F.(1949), Bericht über die Roc vorkommen von Ajvalija. Fond(Trepça), Zveçan .
- 16 Stolberg (1974), Ingeni eur berogtung GmbH, Consulting engineers, II/1, Institut plumbit dhe zinkut,Zveçan (1979).

ABSTRACT

Key words: Geochemistry, polymetallic mineralization, Zn, Pb, Ag, Kosovo, Hajvalia

Hajvalia polymetallic ore deposit is one of the richest in Zn ore deposit in Europe with the average content: S-14.35%, Pb-5.55%, Zn-8.70%, Ag-60 g/t, Au-0.5 g/t, Bi-0.015%, etc... Mineralization is located in the middle part of a metamorphic Palaeozoic series, mainly in metasomatized carbonatic rocks. Some ore bodies are studied about the Zn, Pb content and the geochemical surfaces are drawn for the ore body 1 in the deepest IX horizon (average content: Zn 21.6% and Pb 11.7%). The correlation of Zn and Pb content in 30 representative underground samples results insignificant. Significant correlations exist between Pb and Ag content. Au is correlated with sphalerite. The same regularities are seen in the distribution of Zn and Pb across the ore bodies and in the surface of the ore body 1 in the IX horizon. The Zn/Pb ratio is 2-3 in average with a wide range (0.3-12). The Zn "anomalies" are found in the middle part of the bodies and the Pb one in the peripheral parts. There is a constant Zn, Pb deposition until the depth of 345m, then a clear trend of the increasing content in the depth. The temperature conditions seem to control the main Zn (mesothermal) and Pb (late mesothermal-epithermal) contents. The main content of Ag is correlated with the crystallization of galena and pirargirit.

VLERESIMI DHE PROGNOZIMI I XEHEROREVE TE FE – NI NE TREVEN E KOSOVES

Afrim Koliqi, Amet Tmava

ABSTRAKT

Ne treven e Kosoves mund te veçojme dy zona gjeometalogjenike prognozuese te mineralizimeve xeherpre te Fe – Ni oolitik si vijon :

Zona Ofiolitike e Vardarit, brezi nga Tërniku deri ne Kaçanik se bashku me Caraleven dhe Theranden (Suka Reka) fig.1. Keto treva paraqesin hapesira te pershtatshme metalogjenike me shfaqje te xeheroreve te Fe – Ni dhe vendburime (Pruthi V., 1980,) fig.1.

Brezi ofiolitik i Mirdites (ne Kosove) përaqet zonen e dyte perspektive ku perfshihen trevat e kretakut te siper mbi masat ultrabazike (Pashtriku, horsti i Rahovecit, etj), fig.1. Keto treva paraqesin mjedise interesante metalogjenike, pa pranine e shfaqjeve xeherore apo mineralizimeve te Fe – Ni lateritike, ku verehen edhe elementet kontrolluese dhe strukturat e pershtatshme te mineralizimit.

Gjetjen e ketyre vendburimeve te Fe – Ni do e mundesojne kerkimet e hollesishme gjeologjike, te cilat deri me sot kane munguar. Ne fazen e pare te ketyre kerkimeve duhet bere hartografimi i hollesishem i rajonit ne shkalle 1 : 10 000 duke siguruar sqarimin e nderlikuar strukturoro – tektonik dhe percaktuar profilet e tipeve morfogenetike te mineralizimeve te njohura. Ne fazen e dyte do te behet ndertimi i hartave metalogjenike te produkteve te kores se tjetersimit qe do te mundesoje percaktimin e sheshevë perspektive per kryerjen e shpimeve te thella gjeologjiko – strukturore dhe deshifrimin gjenetik te profileve te kores se tjetersimit.

Duke marre parasysh zhvillimet ekonomike te rimekembjes ne Kosove dhe shkallen e kerkimeve gjeologjike, ne kohet e tashme perspektiva e hulumtimeve ne kete drejtim eshte e vogel. Mirepo, bazuar ne analogjine e ketij xeherori ne Shqiperi dhe Maqedoni, ku eshte shume me i hulumtuar dhe percaktuar, mund te konkludohet pozitivisht per potencialin nikelmbajtes, siç eshte rasti ne Maqedoni apo Fe – Ni ne Shqiperi (Grazhdani A., 1989 dhe Ostrosi B., 1989).

HYRJE

Xeheroret e Fe – Ni lateritike (me permbytje te Co) ne Kosove kane zhvillim te konsiderueshem. Paraqiten me nderprerje ne gjatesi prej 50 km., dhe perfaqesohen nga masa serpentinite me shtrirje VP – JL se bashku me cepin transgresiv te kretakut te siper qe ze pjesen e skajshme te zones tektono – magmatike te Vardarit. Shfaqjet me te njohura jane ne veri te Drenices ne treven e Terstenikut, Verbocit dhe Gradices. Ne jug paraqiten ne Llapushe, ku nderpriten per te vazhduar pastaj ne gjatesi prej 30 km., ne Petrashicee, Caraleve, Bellice, Petrove, Malopolce, Nerodimje, Juzhanc, Brod, Ivaje dhe Pustenik, e ne drejtim te kufirit te Maqedonjse e me tej, fig.1. Ky bres ne Caraleve ndahet ne krahun tjeter dhe vazhdon ne drejtim te Therandes si ne Breshanc, Nishor, Gorice, etj.


Xeheroret e Fe – Ni jane te vendosur ne mes shtrojesh serpentinite dhe sedimenteve te kretakut te siper ne forme te shtresave dhe thjerrzave te zgjatura, por ka raste kur paraqiten edhe si thjerrza te vogla, ne pjeset me te poshtme te serise se kretakut te siper qe e perbejne ranoret dhe konglomeratet mbi te cilat shtrihen gelqerore te ndryshem.

Shtresat dhe thjerrzat e xeheroreve te Fe – Ni nuk kane permasa te medha, rralle ne shtrirje nuk kalojne 1 km., me shpesh kane trashesi 2 – 3 m., maksimum 15 – 20 m., ne renie mund te ndiqen deri ne 100 m.

Xeherori eshte i ndertuar nga oolitet, pizolitet, pelitet dhe materiali detritik. Hekuri ne zeheror paraqitet si okside, hidrokside dhe silikate te ndryshem. Xeheroret e Fe – Ni paraqesin produkte tipike te kores se tjetersimit pjeserisht te zhvendosura ne kuader te substratit ultramafik.

Korja e tjetersimit dhe produktet e saj ne kuader te vendburimeve te nikelite ne Kosove jane formuar nga tjetersimi kimik i ultrabajkeve nen ndikimin e kushteve te favorshme klimatike ne nje kohe te gjate gjeologjike qe nga Jurasicu ($J_{2,3}$) e deri ne Neogen. Transgresioni i senonit (Cr_2) ka perfshire dhe shkaterruar pjesen me te madhe te kesaj koreje, kurse materiali i transportuar dhe i risedimentuar ne bazen e sedimenteve te senonit ka dhene produktet e Fe – Ni lateritik.

Studimet e deritanishme, ndonese jo te plota, sidomos ne pikepamjen stratigrafike, tregojne se prodhimet e tjetersimit laterik kryesisht Fe – Ni – Co e me pak te Ni – Co silikat kane zanafillen e tyre qe nga kretaku i vonshem (Cr_2 – senonian). Nje mendim i tille argumentohet me pranine e prodhimeve te Fe – Ni (Co) ne Terstenik, Verboc – Gradice. Keto prodhime ndodhen midis formacioneve te serpentinitite (ne dysheme) dhe gelqeroreve masive, ranoreve dhe mergeleve te kretakut te vonshem (Cr_2). Keto formime i perkasin prodhimeve lateritike te ridepozituara ne largesi relativisht te vogla. Formimet e tilla kryesisht hekurore me rendesi industriale, duhen kerkuar dhe ne formime dhe struktura te mbuluara (ne thellesi me te medha dhe te pa eroduara), gjithkund nen depozitimet e kretakut te vonshem (Cr_2) te mbivendosura mbi shkembinj ultramafik. Natyrisht, ne ndihme te ketyre studimeve mund te perdoren me efikasitet metodat gjeofizike te SEV.



A – RAJONI NIKELMBAJTËS – ZONA OFIOLITE E VARDARIT.

B – SHESHI PERSPEKTIV – ZONA OFIOLITE E MIRDITËS.

- a - Fusha xeherore e Fe-Ni oolitik dhe Ni-Co silikat Golesh – Dobroshcë dhe Kaçanik.
- b - Shfaqjet xeherore të Ni-Co silikat Rajoni i Bosiunës
- c - Shfaqjet xeherore të Ni-Co silikat Rajoni i Mitrovicës
- d - Shfaqjet xeherore të Ni-Co silikat Rajoni i Gjalcovës

Fig.1. Harta skematike e përhapjes te shkëmbinjave ultrabazikë ne treven e Kosovës

HARTA GJELOGJIKE E TREVËS NIKELMBAJTËSE TË DRENICËS




Fig.2.

Shpuesi:

- kuaternari
- glijqerorë Cr₂
- serpentinitet J
- plioceni
- peridotitet J
- oadim. e permestrifakte
- Vandburimet e Fe-Ni
dhe Ni-Co
- thyerje tektonike




Fig.3. Shtylla litostatigrafike e rajonit nikelmbajtës të Drenicës. Përpuni Koliqi A.

TERSTENIKU

Xeheroret e Fe – Ni ne Tersteniku gjenden ne largesi 1.5 km., ne veri te stacionit hekurudhor Banjice (vija hekurudhore Fushe Kosove – Peje). Ne ndertimin gjeologjik te rajonit te gjere te Terstenikut marrin pjese serpentinitet mbi te cilat shtrihet horizonti i xeheroreve te Fe – Ni, e mbi kete horizont seria tavanore e kretakut te siperm e perbere nga konglomeratet bazalte dhe ranoret me fragmente te xeheroreve te Fe – Ni. Mbi to shtrihen gelqeroret masive, pjeserisht ranoret dhe mergelet, fig.4. E tere kjo seri ka drejtimin VVP – JJL te shtrirjes dhe renie te theksuar nga perendimi.

Zona xeherore ne siperfaqe ndiqet ne gjatesi prej 350 m., ne forme te tri thjerrzave, te cilat ne drejtim te thellesis bashkohen ne nje trup xeheror, i cili mbyllte ne thellesine 80 m. Thellesia e trupit xeheror leviz prej 3 – 13.5 m. Permbajtja mesatare e Fe 35 %, maksimumi 41.5 % dhe Ni 0.97 %. Komponentet e tjere luhaten ne keto kufij, (tab.1).

<chem>SiO2</chem>	20 – 35 %
<chem>Al2O3</chem>	4 – 7 %
<chem>CaO</chem>	1.39 %
<chem>MgO</chem>	1.7 – 4.45 %
<chem>MnO</chem>	0.25 – 1.15 %
S	0.20 – 0.35 %
As	0.13 – 0.31 %
<chem>TiO2</chem>	0.04 – 0.29 %
<chem>Cr2O3</chem>	2.36 – 3.15 %
<chem>P2O5</chem>	0.25 – 0.30 %
Ni	0.97 %
Fe	35 – 41.5 %

Tab. 1. Permbajtja ne perqindje e komponenteve ne vendburimin e Terstenikut

Pesha vellimore e xeherorit eshte 3.17 g/cm^3

Nga analizat mikroskopike (M. Protiq 1956), eshte percaktuar se xeherori ka tekture pizolitike e me rralle oolitike, rrallehere me forma te çrregullta dhe matrice te paket lidhese te silikateve, fig. 6-A. Oolitet e veçanta jane ndertuar nga materiali silikat i natyres kloritike apo magnetite te mbeshtjelle nga oksidet e hekurit.

Eshte verejtur shnderrimi i magnetitit ne martit. Rralle ka vetem kokrra te hematitit, ndersa kromiti eshte i koncentruar ne vete oolitet. Po ashtu rralle verehen pirite dhe markazite. Ka te ngjare qe mineralet e gjelberta silikate te jene shamoziti me kloritin.

Zona xeherore, nga serpentinitet ne drejtim te serise tavanore, ka kete ndertim : serpentinitet, serpentinitet e rreshpezuara pjeserisht te shkaterruar, materiali detritik nga copezat e serpentinitit dhe mbetjes se shkaterrimit te tij, ne oolite dhe pizolite, xaspise, xeherori oolitik dhe ne fund konglomerate dhe ranoret me fragmente te rralla te xeherorit oolitik fig.4 (Zh. Todoroviq, 1959).

Shfaqjet xeherore jane hulumtuar me punime minerare dhe shpime, me te cilat jane vertetuar rezervat xeherore prej 500 000 ton, te kategorise A+B+C. Ne vendburim nuk eshte bere ndonje shfrytezim deri tanë.

VERBOC – GRADICE

Treva xeheror mbajtese Fe – Ni Verboc – Gradice gjendet ne fshatin Verboc, ne lindje te ruges Drenas (Gllogovc) – Skenderaj, ne pjesen lindore te kodres Verbice. Shfaqjet xeherore te Gradices jane 0.5 km.,




Fig.4. Tersteniku-blok diagrami izomerik
Sipas Zh. Todoroviçit, 1956.

larg nga ato ne Verboc dhe se bashku paraqesin nje zone te vetme xeherore, fig.5. Keto terrene jane te ndara nga Tersteniku me sedimentet neogjenike te basenit te Drenices. Ne kete zone xeherore jane bere matje gjeomagnetike, te cilat mbi daljet xeherore kane dhene tre fusha anomale. Keto fusha anomale kane gjatesi 500 m., dhe gjeresi 200 m.

Bazen e ketij terreni e ndertojne serpentinitet e zbuluara nga erozioni ne shume vende. Ne nje hapesire te madhe ato jane te shprishura e te mbuluara me nje kore te holle opali she xhaspisit me pak limonit. Mbi serpentinitet ne menyre transgresive shtrihen sedimentet e senonit te perfaquesuara, nga lart – poshte me: konglomerate ranore, gelqerore ranore dhe gelqerore, trupat e xeheroreve te Fe – Ni vendosen ne kontakt te sedimenteve te senonit dhe serpentinitet, e me pak ne ranore bazalte dhe konglomerate, fig.3. Zona minerale ka gjatesi 370 m., ku Jane konstatuar nente thjerreza xeherore me gjatesi 10 – 80 m., me trashesi 2.5 m., dhe vijueshmeri ne thellesi deri 20 m.

Ne Verboc xeherori eshte i ngjashem me ate ne Terstenik. Ka karakter detritik dhe oolitik, me pak pizolitik si dhe te kalimit ne mes tyre (oolitik – pizolitik), fig. 6-B. Ne kontakt me serpentinitet xeherori eshte me teper detritik kurse ai ne ranore dhe konglomerate kryesisht eshte oolitik. Permbajtja e hekurit ne xeheror leviz 25 – 43 % dhe Ni 0.6 – 1.45 %.

Ne dallim nga Verboci, ne Gradice xeherori paraqitet ne konglomerate dhe ne ranore dhe ne kontaktin e tyre me gelqerore ne forme te shtresave te holla, te cilat se bashku me sedimentet e tjera shtrihen ne drejtim VL – JP dhe kane renie te madhe nga JL.

Shmangia e zones xeherore nga drejtimi dinarik eshte shfaqje lokale dhe pasoje e shkaktuar nga prishjet terthore dhe levizjet horizontale. Shfaqja xeherore e Gradices eshte hulumtuar me punime minerare dhe me kete rast eshte percaktuar shtrirja e saj me gjatesi 210 m., trashesi 0.5 – 8.5 m. Ne xeheror perberja e Fe ndryshon prej 6 – 50 % dhe Ni prej 0.19 – 0.6 %, ku ndeshen dhe fragmente te ranoreve qe sjellin uljen e perberjes se komponenteve te dobishme.

CARALEVE – KAÇANIK

Shfaqjet xeherore te Fe – Ni ne kete territor gjenden ne nje zone te gjate afersisht 30 km., me drejtim shtrirje VP – JL dhe jane te lidhura me sedimentet e kretakut te siperm te vendosura ne menyre transgresive mbi serpentinitet apo sedimentet e metamorfizuara te paleozoikut. Te gjitha formacionet ne kete rajon perveç erozionit ne saj te levizjeve tektonike shkarese kane perjetuar mbihypje te numerta, dhe me kete rast nje numer i anetareve litologjike eshte reduktuar ndjeshem.




Fig.5. Harta gjeologjike e rajonit të Verbovçit.




Fig.6. Pamja e e xehleroret të Fe-Ni. A- vendburimi i Tërstenikut. B- vendburimi Verbovc-Gradieç. Foto A. Koliqi.

Ne rrithinen e fshatit Caraleve takohen disa shfaqje xehlerore te Fe – Ni, qe kane qene objekt i shfrytezimit para luftes se dyte boterore. Ne krahun e majte te Lumin Caraleve, ne vendin e quajtur bregu i Mashinit kemi dy shfaqje xehlerore te zbuluara me punime minerare. Ne rastin e pare, trupi xehleror me gjatesi 30 m., ka trashesi disa metra dhe shtrihet mbi serpentinite, ku pjesen tavanore e zene gelqeroret mergelore. Veprimet e forta tektonike ndikuan qe profili litologjik dhe xehlerori te fitojne pjeserisht pamje irreshpezore. Ne lindje te kesaj shfaqjeje, ne largesi 800 m., kemi shfaqjen e dyte me karakteristika te njejtë. Ne krahun e djathte te po ketij lumi, nen masivin gelqeror bituminoz, vendoset shtresa e xehlerorit oolit me gjatesi 20 m., dhe trashesi disa metra. Si shtroje kane serpentinitet qe ne profilin vertical jane te ndryshuar e kavernoza. Ne tavan kane sedimentet mergelore e gelqerore, fig.7. dhe fig.8.


Xehleroret e Fe – Ni kane teksture oolitike kokerrimet, te ndertuar ne rradhe te pare nga oksidet e Fe shpesh te zevendesuara nga hidrokisidet, ku mineralet silikate janë te kufizuar kryesisht ne materialin lidhes. Perberja kimike e xehlerorit eshte : Fe prej 32 – 53 %, Ni 0.69 – 1.1 %, Cr₂O₃ 0.49 – 3.8 %. Ne kete territor gjate vitit 1944, per nevojat e hekuranes ne Jasenice janë shfrytezuar 18 000 ton xehlerore. Perveç ketyre shfaqjeve xehlerore ne territorin e Caraleves, mineralizime takohen ne fshatin Belice, Reçak, Petrove dhe Mallopolc, te perfaqesuara si thjerrëza me trashesi 3 – 4 m., e te gjata deri ne 30 m.

Fig.7. Profili gjeologjik në anën e djathtë të lumit Caralevë



1. Serpentinit-J, 2. serpentinit i ndryshuar-J, 3. meshpe-Pz, 4. xehleror i Fe oolitik, 5. gjelqerore-Cr i sipërm.

Fig.8. Profili gjeologjik i pusëzës në anën e djathtë të lumit Caralevë



1. Serpentinit-J, 2. serpentinit kavernoz-J, 3. serpentinit i meshpëzuar-J, 4. xehleror i Fe oolit, 5. mergje-Cr i sipërm, 6. gjelqerore-Cr i sipërm.

Ne territorin e gjere te Kaçanikut po ashtu takohen disa shfaqje xehlerore te Fe – Ni. Tek fshati Pustenik, ne kodren e quajtur Zabel, ne jug te Kaçanikut, ne serpentinitet me shtrirje jo normale mbi gelqeroret, ranoret dhe mergelet e flisit te moshes kretake, vendoset një shtrese kompakte e xehlerorit oolitik.

VLERESIMI DHE PROGNOZIMI I XEHEROREVE TE Fe – Ni NE TREVEN E KOSOVES

Trupi xeheror ka trashesi 7–8 m., dhe shtrirje mbi 30 m. Ne tavanin e ketij xeherori vendosen strallet dhe konglomeratet kuarcore, e mbi to gelqeroret. Xeherori oolitik i Zabelit eshte i pasur me oolite te madhesise 0.5–2 mm te ndertuara nga magnetiti i perzier me hematit dhe lende silikate me kokrriza te kromitit dhe piritit. Perberja kimike mesatare e xeherorit eshte si ne tab.2.

Tab.2. Perqindja mesatare e xeherorit oolitik te Zabelit

Perberja mineralogjike mesatare we xeherorit eshte : shamozit dhe klorit 35.5 %, magnetit 17 %, hematit 26 %, limonit (getit) 12 %, kromit 7.5 % dhe kuarc 2%.

SiO ₂	12.55 %
Al ₂ O ₃	6.10 %
Fe ₂ O ₃	51.21 %
Cr ₂ O ₃	3.70 %
TiO ₂	0.20 %
MnO	0.35 %
NiO	1.85 %
CaO	0.59 %
MgO	5.77 %
Na ₂ O + K ₂ O	0.68 %
H ₂ O	6.78 %
As ₂ O ₃	0.29 %
S	0.09 %

LITERATURA

Arkaxhiu F., 1968 ; *Kushtet e formimit te vendburimeve te Fe – Ni te kores se prishjes dhe perspektiva e zbulimit te tyre ne rajonet Librazhd – Pogradecit e Bilishtit*. Permblehdje studimesh Nr.3., f. 34-43, Tirane.

Arkaxhiu F., Bushi E., 1967 ; *Ndertimi gjeologjik, tektonik dhe perspektiva e perhapjes se xeheroreve te Fe – Ni ne zonen Bushtice – Pishkash*. Permblehdje studimesh Nr.4.

Donath M., 1953 ; *Shfaqjet e xeheroreve te Fe oolitik ne Kosove*. Fondi i dokumentacionit “Trepça” Stan Terg.

Maksimović L., 1962 ; *Probleme te kerkimit te Ni ne shkembinje ultrabajike te vendit*. Simpoziumi shkencor ne Beograd.

Matijević I., 1980 ; *Raport mbi kerkimet regionale te xeheroreve silikat ne K.S.A. te Kosoves*. Geozavod Beograd.

Novović T., 1955 ; *Shfaqjet e xeherorit te Fe oolitik ne Verboc*. Fondi i dokumentacionit “Trepça” Stan Terg.

Ostrosi B., 1989 ; *Metalogenia dhe strukturat e fushave xeherore (I – II)*. Universiteti i Tiranes, Tirane.

Ostrosi B., 1995 ; *Vendburimet e mineralev te dobishme, kerkimi i tyre I. (Metalet e zeza)*. SH.B.L.U. Tirane.

Pumo E., etj., 1989 ; *Situata gjeologjike per xeheroret e Fe – Ni dhe Ni silikat dhe detyrat per te ardhmen*. Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr. 4., f. 267-275, Tirane.

Pumo E., 1974 ; *Formimet e kores se prishjes ne zonen tektonike te Mirdites*. Permblehdje Studimesh Nr.4., f. 108 – 131, Tirane.

Pruthi V., 1986 ; *Metodat bashkekohore te studimeve regionale te ndertimit gjeologjik ne K.S.A. te Kosoves me theks te veçante ne metalogenjine dhe prognozimin e lendeve minerale*. Punim doktorate. F.X.M ne Mitrovice.

Shala D., Mullina Ç., Zhivanović Sh., 1988 ; *Raport mbi kerkimet e Fe – Ni ne Kosove*. Fondi i dokumentacionit ne Ferronikel, Lypjan.

Grazhdani A., Molla I., Peshkopia A., 1996 ; *Transversal faults and block – type development of laterites of Albania*. Terranes of Serbia. Eds; Knezevic, V.& Ktistic, B. Pp.327-335, Belgrade.

ABSTRACT

In Kosovo can distinguish two principal metallogenic areas for lateritic Fe – Ni ores.

The Vardari ophiolites host substantial Fe – Ni lateritic occurrences and outcrops (e.g. Terstenik – Kaçanik, Caraleve, Theranda or Suha Reka) (Pruthi V., 1980) fig.1.

The Mirdita (Albania) ophiolites continuation in Kosovo overlain by late Cretaceous limestone, in analogy with Albania, also represent good prospects for Fe – Ni lateritic ores.

To achieve the above targets it needs to be compiled 1 : 10 000 geological and structural maps.

In the second phase it needs to be compiled a metallogenic map probably on 1 : 25 000 scale with delineation of prospective areas with subsequent drilling programs.

Actually, there are absent such detailed geological studies regardless the high demands of Kosovo economy. Based in the very detailed geological and mining data from Albanian and Macedonia, it is quite possible to be undertaken such detailed geological studies.

VESHTRIM GJEOLOGO-INXHINIERIK E GJEOMJEDISOR I ZONES RURALE BULQIZE

Leonard KAZANXHIU, Jorgo KOLA

ABSTRAKT

Ne kete "Veshtrim gjeologo-inxhinierik dhe gjeomjedisor te zones rurale Bulqizë shtjellohen karakteristikat gjeomorfologjike, strukturore, tektonike, litologo-faciale kuaternare, hidrologjike e hidrogjeologjike si dhe treguesit fiziko-mekanike te dherave dhe te shkembinjve te zones, per te mbeshtetur studimet e projektimet gjeologo-inxhinierike, qe kryhen dhe do te kryhen ne te ardhmen duke i hapur horizont zhvillimit te infrastruktureve ne kriteri racionale.

HYRJE

Ne zonen e Bulqizes jane realizuar per dekada te tera studime e punime gjeologjike e gjeologo-minerare per te kerkuar, zbuluar e shfrytezuar burimet minerare, kryesish te kromit. Me keto synime jane kryer rilevime gjeologjike, kerkime me punime te ceketa minerare, shpime me sonda ne siperfaqe e nentoke, Jane hapur horizonte punimesh minerare etj. Keto Jane drejtuar nga gjeologe, arritjet e te cileve Jane pasqyruar ne raportet gjeologjike(2, 3, 12 etj). Ne kete kuader studime dhe punime te vecanta gjeologo-inxhinierike Jane kryer ne menyre anesore. Keshtu per shembull : vete fiziko-mekanike Jane studiuar nga Instituti i Studimeve dhe i Projekteve Gjeologo-Minerare(11), karakteristikat hidrologjike dhe hidrogjeologjike te zones Jane studiuar nga Ndermarja Hidrogjeologjike (9) etj. Te gjitha keto raporte e relacione kane patur si objekt kryesor vendburimin e kromit Bulqize te lidhur ngushtet e shfrytezimit te tij. Per rrjedhoje veshtrimi gjeologo-inxhinierik dhe gjeomjedisor ne teresine e zones nuk ka qene i plete dhe i thelluar. Ne kete "veshtrim" tonin ne nuk pretendojme qe te arrijme gjithcka maksimalisht, por te hedhim nje hap me tej per ti sherbyer zhvillimit te kesaj zone rurale.

KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE DHE GJEOLOGO-STRUKTURORE TE ZONES.

Nga pikpamja gjeomorfologjike zona e Bulqizes ben pjesa ne Krahinen Malore Qendrore te Shqiperise. Ajo perfshihet ne zonen ndermjetese mes pjeses veriore dhe asaj jugore te masivit ultrabazik te Bulqizes. Relievi i kesaj zone eshte i aksidentuar, i veshtire per kalim dhe shumë i nderprere nga perrenj, qafa, lugina, lumenj etj.. Shkaqet e nje relieve te tille te differencuar Jane shkaktuar nga : levizjet hapesinore te ngadalta e te vazdueshme te masivit, dhe nga erozioni. Masivi i Bulqizes ndahet ne dy pjesa, pjesa lindore e cila ka formen e germes "U" (Lugina e Vajkalit), dhe ajo perendimore e cila ka formen e germes "V" (Lugina e Planit te Bardhe) qe ndahan nga qafa e Buallit.

Raportet gjatesi : gjeresi te ketyre lugina variojne 5:1 – 6:1. Lartesite me te medha qe takohen ne kete zone Jane : Maja e Kreshtes 2101 m, e Dhogzit 2024 m etj. Ndersa ajo me e ulet eshte 744 m (Lugina e Vajkalit). Faqet e ketyre maleve kane pjerresi 70-75°.


Nga pikpamja gjeologo-inxhinierike ketu veçojmë keto njesi gjeomorfologjike :

1)- Njesia pothuaj e rrafshet ose zona kenetore, si zonë me kushte te papershtatshme per ndertim, pasi kerkon trajtime te vecanta studimore, projektuese e ndertuese me kostos te larte.

2)- Njesia buzë - kodrinore me pjerresi 10-35° e cila shtrihet ne te dy anët e zones kenetore dhe perbehet nga depozitime deluvialo-proluviale-koluviale te kuaternarit. Kjo zone ka kushte te pershtatshme per ndertime social-ekonomike,(prerja teriore A-A)

Leonard KAZANXHI, Jorgo KOLA

3)- Njesia e shpateve kodrinoro-malore me pjerresi 35-70° ku perhapje te kufizuar kanë depozitimet eluvialo-deluviale dhe kryesish formacionet rrenjesore. Kjo zone ka kushte te papershtatshme per urbanizem masiv, mbasi rrugjet dhe infrastruktura ne pergjithesi eshte relativisht e vështirë per tu realizuar. (Shih prerjen teriore gjeologo-inxhinierike A-A).



Prerja A-A skematike



Zona e Bulqizes lokalizohet ne llojet shkembore ultrabazike, qe karakterizohen nga alternimi ritmik i brezit dunit-harcburgit. Kjo zone ndertohej nga harcburgitet e dunitet e me rralle nga serpentinitet e piroksenitet. Rolin kryesor e luajnë harcburgitet e serpentinituara, kurse me te kufizuara Jane dunitet, të cilët formojnë thjerrëza, breznime deri masivë të vegjël. Ne sektorin verior te vendburimit te kromit Bulqizë shkembinje ultrabazikë mbulohen nga brekçiet shpatore (ose glaciale Q_{1-3} gl) dhe nga depozitimet me te reja kuaternare te lugines se Vajkalit. Ne harten gjeologjike depozitimet e kuaternarit Jane ndare mbi baza gjenetike. Rol te madh ka luajtur gjeomorfologjia e kesaj zone me proceset glaciale te fillimit te kuaternarit,(2,15,16). Akullnajat e tipit alpin kane formuar luginen e Vajkalit dhe kodrat qe rrrethojne Bulqizen nga krahu jugor i saj.

- Brekçiet shpatore Q_{1-3} gl

Zene kodrat qe rrrethojne Bulqizen nga jugu etj,(2,16). Perbehen nga copera formacionesh rrenjesore, dunite e harcburgite te dimensioneve te ndryshme, te paperpunuara e te lemuara jouniformisht. Jane te cimentuara ne nje mase suargjiloro-ranore me ngjyre gri ne te verdhe. Suargjilat si mase cementuese e copave shkembore mendohet se Jane produkte tipike te akullnajave, te formuara nga mielli glacial. Masa suargjiloro-ranore nuk eshte e shperndare uniformisht. Ne zonen e Bregut te Bulqizes ato takohen deri ne

thellesine 181m, ndersa ne drejtimin verior kufizohen si nga trashesia edhe nga shtrirja e tyre, pra ne drejtimin e lugines se Vajkalit ato pykezohen dhe zevendesohen nga depozitimet fluvio-glaciale.

-Depozitime fluvio-glaciale Q_{1,3} f-gl., mbushin krejt kupon e lugines se Vajkalit duke arritur trashesine maksimale 120m ne qender te saj. Nga poshte lart perfaqesohen nga:

Ranoret boje-hiri, me potence 8-10m, direkt mbi depozitimet rrenjesore ultrabazike.

-Argjilat blu ne hiri, vendosen mbi ranoret, jane kompakte dhe ne pjesen e poshtme kane pamje alevrolitike. Kjo pako ne qender te lugines ka trashesi 70-110m, qe zvogelohet ne 40-15m ne krahet. Mbi pakon argjilore vendosen formacionet deluvialo-proluviale.-eluviale.

-Depozitimet deluvialo-proluvialo-eluviale vendosen mbi depozitimet fluvio-glaciale dhe perfaqesohen nga nje shtrese teper heterogene, me kalim tipik gradual nga rerat ne zhuret dhe zhavorret. Ka trashesi te ndryshme, nga 43-50m ne krahet, ne qender zbret deri ne 10m, e me ne perendim ajo pykezohet. Ne qender te lugines ajo mbulohet nga nje shtrese suargjiloro-torfore, e cila ne harte shenohet me gjeneze lagunore. Kjo shtrese ka trashesi nga 20-24m ne lindje deri ne 40m ne perendim te lugines.

Masivi ultrabazik i Bulqizes perfaqeson nje krahinë te rrudhosur te perkultur ne rende te ndryshme, si ne planin gjatesor e terthor-vertikal, ashtu edhe ne planin horizontal, si per shkembinjtë ndertonjes, ashtu edhe per mineral mbajtjen ne te. Antiklinali i Bulqizes ka shtrirje 330-340°, zhytja nga V-VP ne qender, pjesen jugore e veriore, ne J-JL ne zonen ndermjetese me v.b. e Batres. Per vertetimin e strukturës se rrudhosur, te perkultur dhe te permbysur te masivit element kryesor eshte krom-mbjatja e v.b, e cila eshte ndjekur nepermjet punimeve minerare te shumta si nje vb i karakterit unikal, me perkulje hapesinore te rendeve masive, lokale deri fleksurore.

Tektonika rrudhosëse dhe ajo shkeputese janë singjenetike me mineralmbajtjen, por asinkrone me te. Tektonika verehet gjatesore, terthore dhe diagonale ndaj shtrirjes se masivit dhe krom-mbjatjes ne te. Sensi i renies se rrafsheve te prishjeve tektonike shkon ne pajtueshmëri me sensin e zhytjes se v.b. Prishjet tektonike drejt thellesise se v.b. zbehen duke i lene vend mikroçarshmërisë.

Masivi ultrabazik i Bulqizes, ne dogger-malm u rrudhos, u permbysh, doli mbi siperfaqen e ujit dhe iu nenshtrua proceseve te erozionit.

Ne keto momente (J₃-Cr₁) u depozitura dhe nje formacion flishor turbiditik, si sedimentim kaotik. Ka mendime se ekziston nje tektonike e fuqishme bllokore P-L e cila eshte e mbuluar nga depozitimet e kuaternarit ne Vajkal dhe ne Plan te Bardhe.

2 – NDERTIMI LITOLOGJIK I ZONES SE BULQIZES.

(Shih harten e depozitimeve kuaternare dhe prerjet perkatese)

Ne zonen e Bulqizes dallojmë keto komplekse litologjike :

1 – Kompleksin e depozitimeve rrenjesore ultrabazike.

2 – Kompleksin e depozitimeve eluviale qe perbehet nga eluvionet e formacionit bazë.

Ky kompleks ka trashesi 4-5 m dhe takohet ne zonat e ngritis kodrinore-malore, ndersa ne zonen e lugines se Vajkalit gjendet ne thellesi te medha.

3 – Kompleksi i argilave me ngjyrë të bardhë me permbajtje zajesh çakelllore me ndershtresa rerash te imeta.


Ky kompleks litologo-facial mund te konsiderohet edhe si tipik akullnajor.

Ka trashesi rrith 150 m ne pjesen qendrore dhe praktikisht pa ndonjë problem gjeologo-inxhinierik.

4 – Kompleksi aluvialo-deluvial, qe ka nje trashesi 10-15 m, perbehet nga depozitimet e rerave zhavorrore dhe e zhavorrëve me një ndershtresë suargjilash prej 4-8 m.

Ky kompleks perveç rendesise hidrogjeologjike si kompleks kryesor ujëmbajtës, ka rendesi edhe nga pikpamja gjeologo-inxhinierike, sepse perhapet edhe ne zonat e zhvillimit te ndertimeve, ku nje shfrytëzim i pakontrolluar i ujrate nentokesorë mund te shkaktojë dukuri gjeodinamike me pasoja per zhvillimin e ndertimeve.

5 – Kompleksi i depozitimeve kenetore ne te cilin perfshihen shtresat e argilave blu dhe mbi to torfat, dhe depozitimet torfore. Zona e perhapjes se ketyre depozitimeve duhet saktesar dhe perkufizuar mirë jo



Harta e depozitimeve kuaternare. zona Bulqize

Spjegues

- Suargjila dhe Torfa
- zhavorre te trasha dhe popla
- brekçie shpatore
- shk. ultrabazike
- ndertesa banimi
- shp. hidrogjeologjike



PRERJA I - I terthore skematike

vetëm per eleminimin e zones se perhapjes se ketyre depozitimeve si te papershtatshme per ndertim, por edhe te dukurive gjeodinamike ne siperfaqen e ndertimeve ekzistuese (çarje ne ndertesa, çedimet etj), te

cilat gjithashtu duhet te eliminohen per ndertime te renda inxhinierike te inxhinierisë civile. 6 – Kompleksi i depozitimeve proluviale, eluviale, deluviale, kolviale etj, qe per gjithesisht ndodhet jashtë zonës së depozitimeve kenetore, por ne nje brez të ngushtë edhe nderthuren me to.

Zonat e perhapjes se depozitimeve te ketij kompleksi litologo-facial kanë kushte te pershatshme per zhvillimin e ndertimeve social-ekonomike.



3 – KARAKTERISTIKAT OROGRAFIKE, KLIMA DHE KUSHTET HIDROGJEOLOGJIKE.

Nga pikëpamja orografike zona e Bulqizes ben pjesa ne rajonin hidrogeografik VL te Shqiperise qe perfshin pellgun ujembledhes te lumit Drin i Zi. Ne kete masiv llogaritet nje numer i shumtë liqenesh te lartesive te medha malore.

Prej ketyre liqeneve si dhe prej lartesive te maleve qe rrrethojne nga te gjitha anët zonën e Bulqizës fillojne rrjedhjen e tyre siperfaqesore rrjeti i perrenjve dhe pellgjet lumore.

Perroi Skenderit prurja 100 l/sek ne dimer ndersa ne vere ajo pakesohet,

Perroi i Ahishtes deri 30 l/sek,ndersa ne vere shteron,

Perroi i Duriçit deri 30 l/sek,

Perroi i Lugut te thelle nga 25-30 l/sek me nederprerje ne dimer,vjeshte e pranvere dhe shterim ne vere.

Perroi Kreshtes 20-25 l/sek,

Perroi i Lepushit 50-55 l/sek,

Perroi i Çupajve 10-15 l/sek.

Galerite e Klosit nxjerrin jashtë nje prurje ujore prej 400-450 l/sek.

Sasia e prurjeve ndryshon ne varesi te stines dhe te reshjeve. Ata furnizojne me ujrat e tyre dy lumenj kryesorë : lumin e Drinit te Zi, si dhe lumin e Matit. Prurja konstante e ketyre perrenjvene teresi eshte e tille qe ato mund te furnizojne qytetin dhe minieren me energji elektrike po te vendosen ne to rreth 10 çifte turbinash hidroenergitike.Konsumi i sotem ditor qyteti Bulqize +Miniere eshte 73.000 kw/h., ndërkohë që me vendosjen e këtyre turbinave sigurohet një kapacitet prej rreth 80.000 kw/orë.Arteri kryesor i ujit ne masiv eshte lumi i Grykes se Madhe, i cili ushqehet nga perroi i Skenderit dhe ai i Ahishtes. Lumi i Vajkalit rrjedh nga P drejt L ne ndryshim nga lumenjtë e tjerë te Shqiperise qe rrjedhin nga lindja ne drejtim te perendimit.

Nga pikëpamja klimatike vranesirat ne Shqiperi luhaten 3,8-5,3 balle ndersa ne Bulqize kane nje intensitet prej 5.9 ballë. Ditët me ndriçim dielli ne Bulqize janë 137 ditë/vit. Lageshtia absolute 1-30 milibar ne lugje.

Thellesia e ngrirjes se tokes 20-30 cm. Reshet mesatare vjetore 1200-1300 mm/vit. Temperaturat mesatare luhaten nga -5 deri – 12° C ne Janar deri ne 30° ne Korrik. Shpejtesia e eres eshte mesatarisht 7-12 m/seku. Debora ne kendet e vdekura shkon 2-3m. Ererat e forta dhe tufanet me debore fillojne nga Nentori dhe mbarojne ne Mars.

Përsa u përket kushteve hidrogeologjike zona e Bulqizes ka nje siperfaqe ujembledhese prej 6.8 km², ne formen e nje kazanoreje me faqe te pjerreta, ku ne qender te se ciles ndodhet "Gjoli i Vajkalit"(4).

Ne kete pellg kemi keto komplekse kryesorë ujembajtës :

1 – Kompleksi ujembajtës i shkembinje ultrabajzikë së bashku me brekjet shpatore.

2 – Kompleksi ujembajtës i depozitimeve kuaternare.

Ujerat e kompleksit te pare vihen re dukshëm në galeritë e shfrytëzimit te Minieres.

Keto ujra nentokesore te shkembinje ultrabajzikë, sipas perberjes kimike janë ujra te tipit hidrokarbonat-magneziumi me mineralizim te per gjithshem deri ne 0.2 gr/l dhe fortesi te per gjithshme 5.5-7.5 gradë gjermane.

Ndersa ne depozitimet kuaternare te lugines se Vajkalit kemi nje horizont te vetem ujembajtes, ate te zhavorreve, i cili ushqehet nga brekjet shpatore anesore qe kontaktojne ne periferi me te. Nga shpimet e kryera ne qender te Vajkalit jane verejtur derdhje uji por ato kane qene te perkoqshme. Ky uje kimikisht ka Mp=0.3-0.4 gr/lit, Ph >8,2 dhe F=9,5-11 grade gjermane. Ujerat siperfaqesore ne kete lugine grumbullohen dhe derdhen ne lumin e Vajkalit. Nga matjet ne te me kaperdredhes ka dale se ne Prill prurjet jane 3000-3150 l/sek,ndersa ne Tetor-Nentor minimumi 230 l/sek. Ketu po te perfshihen dhe prurjet statike nga nentoka ne Vajkal prurjet konstante jane 350-400 l/sek.

4 - DUKURITE GJEODINAMIKE

1- Proseset gjeodinamike pas stabilizimit te masivit ultrabajzik te Bulqizes.

Proseset endogjene qe çuan ne formimin e masivit ultrabajzik te Bulqizes i lane vend zoterimit te proceseve ekzogjene, si rrjedhoje e te cilave u formuan deluvionet, koluvionet, ricimentimi i tyre si: brekjet e shpatit, ranoret etj. Keto duke u grumbulluan kryesishet ne horizontet me te uleta te reliefit formuan luginen e Vajkalit me formacione te kuaternarit. Gjate kesaj kohe nuk kane ndodhur vetem proceset e prishjes, transportimit dhe depozitimit te shkembinje ultrabajzike,por kane ndodhur edhe levizje rajonale qe jane shfaqur me termetet. Nga studimet e kryera del se ne vijen e profilit Durres-Tirane-Bulqize-Diber mesatarisht nje here ne 30 vjet shfaqet termet me intensitet te larte sizmik. Keshtu permendim termetet e 30 Marsit 1921, 27 Gushtit 1942, 30 Nentorit 1967, dhe 24 Qershorit 1978. Seria e ketyre termeteve ka shkaktuar rrjeten e intensitetit te çarshmerise se shkembinje dhe rrezimin e masave shkembore ne terrene te thepisura duke ndikuar ne intensitetin e proceseve ekzogjene.

2.-Proseset gjeodinamike ne ditet e sotme.

Keto procese gjeodinamike ndikojne edhe mbi komunitetin, objektet dhe infrastrukturen ekzistuese te zones. Rrjedhoje e ketyre proceseve eshte formimi ne keto 3-4 vitet e fundit i 'liqenit te Vajkalit" per shkak te lcnies per nje kohe te gjate pa u pastruar e thelluar kanali kryesor i rrjetit kullues te lugines. Per rrjedhoje, u shfaq permbytja e nje pjese te lugines e cila u reflektua ne uljen apo cedimin e kesaj pjese me 0,5-2,5m. Ndersa ne objektet e ndertimit ndikimi ka qene si me poshte vijon:

1.-Godina 3 kateshe e ish-shkolles se mesme te per gjithshme Bulqize.

Ka pesuar 3 çarje ne murin e palestres se saj duke e nxjerre ate jashtë funksionit. Dy nga keto çarje vijojnë ne themel 0,7-1,5m thelli. Drejtimi i tyre eshte terthor-diagonal me murin, gje qe tregon dhe per nje anim te tij ne drejtim te pjeses se ceduar. Çarja e trete eshte shoqeruese, ka gjatesi 3-4m.

2.-Godina e shkolles 8-vjeçare "Xhevdet Doda" Bulqize.

Ne nje nga klasat e saj ne katin e trete ka nje plasaritje ne tavan, me gjatesi 4-4,5m.

Prapa ketyre dy ndertesave eshte kufiri me token vegjete te ceduar i cili ka dhene çarje edhe ne murin rrethues te shkolles 8-vjeçare.

3.-Godina e Drejtorisë arsimore te Rrethit Bulqize.

Eshte nder me te demtuarat nga plasaritjet e çarjet neper muret e saj. Gjatesia mesatare e tyre shkon nga 5-10m., kryesisht terthor mureve. Ka te tilla qe kapin edhe themelet e objektit dhe qe vijojne nga 0,2-0,5m thellesi.

4.-Pallatet Nr. 1, 18, 19 Bulqize e vjeter nen rrugen kryesore te qytetit.

Pallati nr 1 ka plasaritje e çarje te imeta neper muret e shkalleve te tij. Gjatesia e tyre shkon 0,5-3m, gjeresia 0,5-2mm. Pallatet nr 18 dhe 19 kane secili nga një çarje me gjatesi 3-4m, gjeresi 1-5mm, ne themel nga 0,4-0,7m thellesi. Ato mendojme se jane krijuar nga nderhyrjet ne konstruksion. Çarje, plasaritje dhe ulje bazamenti verehen edhe ne rrugen Bulqize e vjeter-Lagja e Re Bulqize, ne rrugen unaze te qytetit si dhe ne ate unaze e qytetit-varreza. Theksojme se prane varrezave te qytetit (sektori VP i lugines) verehen 5-6 çarje toke me gjatesi nga 150 deri 600-700m, paralel me konturet e uljes (liqenit). Keto çarje kane një gjeresi nga 5-10cm deri ne 50-70cm, e thellesi nga 10-20cm deri 1,7m. Keto pasoja erdhen per shkak te mospastrimit e thellimit per një kohe te gjate te kanalit kryesor kullues te lugines, nga grumbullimi dhe shkarkimi i ujравe siperfaqesore e nentokesore ne lugine, nga shtimi i prurjeve ujore (nga Miniera, nga shkarkimi i ujравe te bardha e te zeza te qytetit me zgjerimin e tij), nga karakteri gjithnjë e me konstant i ketyre prurjeve, nga ndryshimi i ekilibrit hidrostatik i formacioneve ujembajtese te vete lugines etj. Karakteristikat e ketyre çarjeve jane;

a - Pajtueshmeria e orientimit te tyre me vijueshmerine e çarjeve qe verehen ne token vegjetele te ceduar nga ujerat.

b - Dendesa me e madhe e tyre ne objektet me afer konturit te ujerave.

c - Shfaqja e tyre edhe ne objekte te cilat eshte veshtire te pranohen ne singjeneze me cedimet e tokes vegjetele te mbuluar nga ‘liqeni’ mbasi ndodhen larg.

Pra, çedimet e shkaktuara ne lugine ndikojne ne perballimin sizmik te objekteve te ngritura nen rrugen kryesore Bulqize-Burrel. Per dobesimin e qendreses se objekteve te ngritura ndikojne edhe nderhyrjet ne to, duke i shnderruar ne lokale sherbimi, jashte çdo kriteri gjeologo-inxhinierik. Keshtu psh; kulmin e ka arritur ndertesa prane Qendres se Kultures Bulqize, qe nga ndertese dy kateshe eshte bere tre kateshe, duke ‘ngrene’ nen to themelet. Ndertesa sot qendron e ngritur pa patur themele. Ndersa orteqet e debores kane ndikuar ne gjeodinamiken e proceseve ekzogjene. Keto jane shfaqur kryesisht ne pjesen jugore (zona D), duke rreziuar e bartur copa shkembinjsh, pa arritur ne afersi te qytetit.

5 – VETITE FIZIKO-MEKANIKE TE FORMACIONEVE.

Përsa u përket vete fiziko-mekanike të formacioneve provat jane marre nga shpimi 9H me thellesi 400ml, nga shpimi 926 profili –33 deri ne thellesine 700ml dhe nga punimet minerare te zones qendrore te vb Bulqize (2), te cilat me pas u rigrupuan sipas ndertimit makroskopik e sidomos mikroskopik (ne baze te shlifeve) ne brekçie, dunite, harzburgite e piroksenite me llojet e tyre te fresketa e te serpentinizuara.

Duke u bazuar ne vete fiziko-mekanike te llogaritura me rruge laboratorike dhe matematikore ne menyre permbledhese del tabela e vete fiziko-mekanike te shkembinjve e produkteve te tyre jo me thjesht dhe vetem per vb e Bulqizes, por per gjithe zonen e Bulqizes e cila padyshim sherben per ndertimet e metejshme te objekteve dhe infrastrukturese se kesaj zone.

Në këtë tabelë jepen të dhenat orientuese mbi vete fiziko-mekanike te shkembinjve ultrabajikë dhe produkteve te alterimit te tyre per projektuesit e objekteve ndertimore ne zonen e qytetit te Bulqizes (8,5,1).

Nga llogaritjet del se raporti R_{pr}/R_t per ultrabajiket varion nga 3-5. $R_{sh} > R_{pr} > R_t$. Analiza spektrale e tyre jep: $Si > 20\%$; $Cr_2O_3 > 10\%$; $Fe = 3-10\%$; $Al = 0,1-1\%$ ndersa elemente si: Ga, Va, Ti, Co, etj. ne sasi fare te vogla.

Pra, me te pershtatshme per ndertime te çdo lloji jane shkembinjtë rrenjesorë ultrabajikë, te cilët kanë parametra me te lartë e me te favorshem ne krahasim me depozitimet e tjera, ndersa ndertimet mbi depozitimet kuaternare te lugines se Vajkalit Jane me kosto te larte, te pasigurta nga ana sizmike dhe kerkojne trajtime te veçanta studimore per ndertime individuale.

N/R	N/K	Emërtimi i shkëmbinjve	Vetite fizike					Vetite mekanike			
			γ_s gr/cm ³	γ_0 gr/cm ³	δ %	P Nr	K _p %	W ₁ %	R _{sh} Kg/cm ²	R _t Kg/cm ²	R _{pr} Kg/cm ²
1.	18.	Piroksenite të freskëta	3.01	2.97	0.97	3	0.03	0.05	1375	140	240
2.	25	Harchburgite të freskëta	3.35	3.27	0.97	3	0.03	0.09	1170	30	169
3.	25	Dunite shumë të serpentinizuara	3.20	3.10	0.97	3	0.03	0.10	750	50	142
4.	18	Dunite shumë të serpentinizuara	2.74	2.71	0.98	2	0.02	0.10	800	47	144
5.	24	Harchburgite mesatarish të serpent.	2.91	2.80	0.97	3	0.03	0.12	840	45	158
6.	20	Dunite mesatarish të serpentiniz.	3.26	3.12	0.98	2	0.05	0.07	930	50	150
7.	30	Dunite të freskëta	3.29	3.26	0.98	2	0.02	0.08	1150	40	160
8.	22	Brekçje me cimentim ultrabajik	2.89	2.64	0.91	7	0.07	2.80	420	30	80

Tabela përmblidhëse e vete fiziko-mekanike të shkëmbinjve të rajonit vend-burimit Bulqizë.

Nr.	Emertimi i dheut per vajkalin e vb.	VLERAT GJEOTEKNIKE						
		gr/cm ³	gradë	C (bar)	E (kg/cm ²)	kg/cm ²	f=R _{sh} /100	K _f (m/ditë)
1	Tokë vegetale, torfë	1-1.2	< 10 ⁰	0.05	5-10	1	0.3	< 0.04
2	Rërë, zhur, zhavorr	1.9-2.0	20-45 ⁰		100-300	1.5-5	0.3-1.5	3-11
3	Suargjila	1.85	14-23 ⁰	0.2-0.5	30-50	1-1.5	< 0.5	< 0.08
4	Argjila	1.9	14-23 ⁰	0.2-0.5	50-120	1.5-2	0.5-1.5	< 0.08
5	Ranorë të cimentuar dobët, me pak lageshtire.	1.9	28-35 ⁰	1-1.2	100-200	1.5-2	3-4	5-15
6	Brekçiet shpatore	2.25-2.35	35-40 ⁰	1.5	10 ² -10 ³	2-4	4	10-20
7	Shkembinj ultrabazikë	2.7-3.27	> 45 ⁰	5	10 ⁵	8-10	6-8	< 0.03

1 bar = 0.982 kg/cm²

6. GJEOMJEDISI DHE DOMOSDOSHMERIA E SHFRYTEZIMIT RACIONAL TE TIJ

Gjeomjedisi perfaqeson teresine e faktoreve te ndryshem gjeologo-mjedisorë, ne bashkeveprim te ngushte me njeri-tjetrin.

Faktoret gjeologjike jane: gjeomorfologjia, gjeodinamika, vete fiziko-mekanike te shkembinjve, struktura etj. Faktoret mjedisore jane: karakteri i reliefit, klima, moti, flora, fauna, infrastruktura etj. Keta faktore duhen studiuar jo vetem ne teresi por edhe ne veçanti per çdo objekt qe nderton komuniteti. Eshte kurioz fakti qe banoret e ketyre trevave edhe pse nuk kane patur njohuri shkencore gjeomjedisore, prape se prape nga pervoja e percjelle brez pas brezi, kane ditur ta shfrytezojne mjedisin mbi kriter e racionale, duke ngritur banesa e hapur vendkalime ne zonat me te sigurta nga proceset gjeodinamike. Kjo pervoje pozitive nuk u mbajt parasysh ne ndertimet e qytetit. Keshtu u ngriten ne anen e poshtme te rruges kryesore te Bulqizes, ndertesa ne toke te bute, jo mbi formacione shkembore te qendrueshme. Prandaj, siç u permend ne keto ndertesa jane verejtur plasaritje e çarje ne mure e tavane. Ketu ka ndikuar negativisht edhe mungesa e një plani irregullues perspektiv te qytetit, me studim gjeologo-inxhinierik. Ndaj ka ndodhur qe ne vatren e "ligenit" te formuar te funksionoje nje pike karburanti, mbi nje perrua te Duriçit te hidhen themellet e një ndertese banimi etj.

Po te kish nje studim gjeologo-inxhinierik dhe nje projekt perspektiv mbi ngritjen e qytetit te gjeologeve dhe minatoreve, veshtire do te qe zgjedhja e kesaj treve per banim. Ndoshta, per te menjanuar kushtet e dimrit te ashper dhe te gjate, si dhe ndotjet e ajrit dhe te ujerave nga Miniera, me e pershtatshem do te qe terreni verior tek "Ura e qytetit" te hershem, ose diku ne shpatet e buta perendimore te Qafe-Lamës.

7 - METODAT E PERDORURA NE STUDIM.

Veshtrimi gjeologo-inxhinierik e gjeomjedisor i zones rurale Bulqize ne menyre tangenciale e sektoriale eshte realizuar edhe nga autore te ndryshem nepermjet rilevimeve gjeologjike, raporteve e relacioneve gjeologjike e gjeologo-minerare, si dhe me parametrat teknike te vrojtuar me analiza laboratorike. Ne kete studim behen perpjekje per ta pare problemen ne tere kompleksin e vet. Per kete si hap i pare u programua

puna per te siguruar te gjithe informacionin e mjaftueshem e te nevojshem si parakusht per t'i hyre shtjellimit te çeshtjeve qe trajtohen.

8 - PERFUNDIME.

Zona e Bulqizes eshte pjese e Krahines Malore Qendrore te Shqiperise. Pellgu ujor prej 6,8 km² ushqen Matin e Drinin e Zi me prurjet e rrjedhave siperfaqesore e nentokesore(nepermjet çarshmerise). Karakteri i reliefit eshte teper malor, i aksidentuar me diferenca kuotash deri 1000m (Kreshta 2101m, Vajkali 744m lartesi).

Shkembinjte ndertonjës janë: magmatiket e tipit ultrabajik(harcburgite deri shume te serpentinizuar, piroksenite, serpentinite etj, si dhe depozitime te shkrifeta ose te çimentuara ne pjeset e uleta te reliefit, si produkt i alterimit te shkembinjve rrenjesore Shkembinjte perfaqesojne nje krahine te rrudhosur, te perkultur e te permbysur. Krommbajtja qe permbysjnë eshte ne pajtuesheri strukturore me ta. Edhe sistemi i prishjeve tektonike, sidomos i verejtur terthor shtrirjes meridionale me intensitet me te madh, ne sensin e renies harmonizohet me sensin e zhytjes se krommbajtjes. Ne drejtim te thellisise, me rritjen e trysnive minerare, çarshmeria gradualisht i le vend mikroçarshmerise, duke u zvogeluar qendrueshmeria e punimeve minerare.

Ne ndertimin litologo-facial verehen:

a-Shkembinjte rrenjesore

b-Copezimet e alterimit

c-Mbetjet tipike lijenore: argjilat e zhavorrishtet

d-Mbetjet deluviale-koluviale-eluviale e aluviale.

Ne kompleks keto depozitime e shnderruan gradualisht lijenin e hershem te Vajkalit ne kenete dhe, me rrjetin e kanaleve kulluese u kthye ne fushe. Ky mjesdi kushtezon studimet konkrete gjeologo-inxhinierike per çdo objekt e per infrastrukturen ne qytet e ne fshat.

Shkembinjte rrenjesore kane veti fiziko-mekanike me te larta se produktet e tyre, te cilat kane me te ulet kompakte sine e ngjeshmerine. Prandaj siguria sizmike mbi keto produkte ulet shume. Vajkali furnizohet nga prurje konstante mbi 250-300 l/sek. Rrjedhoje e veprimtarise se tyre janë cedimet ne fushe e çarjet e plasaritjet ne ndertesat dhe rrugjet automobilistike.

Deri me sot infrastruktura e ngritur dhe objektet e ndryshme te ndertuara (banesat, lokalet, depot, pikat e shperndarjes se karburantit etj) nuk janë paraprise nga studime gjeologo-inxhinierike e gjeomjedisore te karakterit zonal dhe aq me pak per çdo objekt e segment rrugor.

9 - REKOMANDIME

Çdo ndertim te mbështetet ne studime gjeologo-inxhinierike e gjeomjedisore.

Per gjendjen egzistuese te objekteve te ngritura dhe infrastrukturen ku verehen demtime te ngritet nje grup specialistesh per evidentimin e tyre si dhe per te percaktuar rekonditimet me te pershatshme, me synim parandalimin me kohe te pasojave negative te pritshme.

Te ngritet ne nivel me te larte sensibilizimi dhe aktivizimi i komunitetit per nje mjesdi te shendetshëm, të kulturuar dhe të sigurtë.

10. – LITERATURA.

1. Cipo, F. Vetitë fiziko-mekanike të shkëmbinjve ultrabajikë të rajonit të vend-burimit Bulqizë. (Disertacion) I.S.P.M. Tiranë 1981.
2. Gushi, K. Raport gjeologjik i v. B. Bulqize 1/1/1960-1/1/1968.
3. Gushi, K. Raport gjeologjik i punimeve te kryera ne v.b. e kromit Kola. J. Bulqizë dhe llogaritja e rezervave ne gjendje 1/1/1973.

4. Kallajxhiu P. Projekt mbi punimet hidrogjeologjike në v.b. Bulqizë viti 1965
5. Konomi N. Gjeologjia inxhinierike. Vitetë fiziko-mekanike të shkëmbinjve. Sh. B. L. U. Tiranë 1980.
6. Kazanxhiu L. Kushtet gjeologo-inxhinierike të zonës së Qytetit të Bulqizës. (Për problemet e shfrytëzimit racionale, të plotë dhe ekonomik të mjedisit). Projekt Diplomë e viti 2001.
7. Grup autorësh. Rreziqet gjeologjike dhe gjeoambienti. Përmbyt. Stud. 1997.
8. Grup autorësh. Tabela përbledhëse e të dhënave orientuese të cilësive fiziko-mekanike të dheut.
9. Lako A. etj. Raport hidrogjeologjik i shkallës 1:100.000 mbi vrojtimet e kryera në zonën Peshkopi-Burrel-Bulqizë. Viti 1968.
10. Muço B. Tërmetet, demonet e nëntokës. Sh. B. Enciklop. Viti 1996.
11. Pano Dh., Cipo F. Studim mbi përcaktimin e veticës fiziko-mekanike të shkëmbinjve për v.b. e Bulqizës. Tiranë 1972.
12. Qorlaze. S. etj. Raport gjeologjik i punimeve te kryera ne v.b. Bulqizë dhe llogaritja e rezervave ne gjendje 1/1979.
13. Sallufi. F. Raport mbi konditat gjeologo-inxhinierike te sheshit te ndertimit te konviktit te shkolles se mesme te minierave Bulqize. 1991.
14. Shabani S., Kazanxhiu L., etj. Administrimi i territorit dhe i resurseve natyrore te rrëthit Bulqize. Projekt viti 2001-2003. Dega Rajonale Bulqize.
15. Tafilaj I., Kallajxhiu P. Konditat hidrogjeologjike te v.b. Bulqize (Pjese e raportit 1/1968).
16. Tafilaj I. Referat në sesionin e I shkencor të Ndërmarrjes Shtetërore Hidrogjeologjike. Mars 1968.

ABSTRACT

Bulqiza area belongs to the Central Mountain part of Albania. The water basin of 6.8 km² surface supplies the Mati and Drini i Zi rivers. The bedrocks are represented of harzburgite - magmatic rocks, bearing important chromite ore deposits (Bulqiza, Batra and so on). From the lithologic - facial point of view several units are distinguished :

- a - Bedrocks
- b - Alteration rocks
- c - Typical like formations : muds and gravels
- d - Aluvial, elluvial, colluvial, deluvial sediments.

The complex geological construction underlines the necessity of the specialized engineering - geology studies for the specific infrastructure segments.

TOKA NE ZHVILLIM

NJE VESHTRIM I RI NDAJ TEKTONIKES GLOBALE NEPERMJET TEORISE SE TOKES NE EKSPANSION

VEDAT SHEHU

ABSTRACT

Gjate çerekut te fundit te shekullit te fundit, duke filluar me Kerin (Carey 1973, 1976, 1996), Blinovin (Blinov 1983), duke vazduar me mua (Shehu 1988), Vogelin (Vogel 1984), Çudinovin (Chudinov 1992, etj.) e duke perfunduar me shume te tjere deri ne mbarim te viteve nentedhjete (Tasos 1998) eshte vertetuar qe te gjitha te dhenat nga fundi i oqeaneve krejt Toka dhe nga Universi ne teresi pajtohen me mire me teorine e Tokes ne Ekspansion se sa me Tektoniken e Pllakave, pavaresisht se kjo e fundit vazdon te futet ne shume interpretime thelbesore te shkencave te Tokes (Tackly 2000).

Kjo lidhet me faktin e thjeshte qe konturet e kontinenteve puqen pothuajse plotesisht ne një glob teresor me reze me te vogel dhe ne një izobat me te thelle dhe se mekanizmi i supozuar per levizjen e pllakave litosferike nuk eshte një interpretim shkencor i pranueshem; eshte thjesht një modifikim i Driftit te Kontinenteve te Wegener-it.

Te gjitha teorite gjeotektonike mbeshteten fuqimisht ne teorite kozmologjike te prejardhjes se Tokes dhe sistemit Diellor. Pamvaresisht nga modelet baze prej te cilave nisen interpretimet e zhvillimit gjeologjik ato u perfshin ne dy grupe te medha fiksiste dhe mohiliste:

Teori me rreze, gravitet, mase dhe siperfaqe (resp. Vellim) konstante, te pandryshueshme.

Teori me keto parametra te ndryshueshem.

Teoria e Tokes ne zhvillim eshte një perpjekje per të mbeshtetur ekspansionin apo zgjerimin e saj mbi një baze te re per gjithesimi qe shpjegon se si Toka eshte duke u zhvilluar qe nga origjina. Pra synohet per te mbushur boshlekun ne teorine e Ekspansionit, perderisa dijetare te tille te medhenj si Keri (Carey 1976) dhe Oueni (Owen 1984) shprehen se eshte një fakt qe Toka eshte duke u zgjeruar por ata nuk e dine perse. Keshtu del si perfundim se zgjerimi eshte pasoje e zhvillimit te Tokes nepermjet bashkeveprimit. Qe te pranojme kete ne duhet te mbeshtetemi ne një interpretim te ri qe nis me origjinën e Sistemit Diellor dhe transformimin e materies ne Univers.

Edhe te dhenat dhe onterpretimet per hapjen e Albanideve te futura me ngut ne skemat e Tektonikes se pllakave (Kodra, etj. 1982) mbeshtesin plotesisht teorine e Tokes ne zhvillim duke justifikuar drejtime te reja per kerkime.

TOKA NE ZHVILLIM DHE RRITJE

Ne trajtimin e problemeve gjeologjike te Albanideve nje vend kyç zene problemet e moshes, gjenezes dhe vendosjes hapsinore te shkembinjeve ofiolitik apo te gjelber qe perbejne bazamentin e shkembinjeve sedimentare te zones Mirdita. Ketej ka dale pyetja: mos ndoshta buzet anesore te Mirdites dikur kane perfaqesuar faqet e një çarjeje gjigande planetare sipas se ciles puqeshin plisat me ndertim gjeologjik te njejtë, te cilet me vone janë larguar nga njëri tjetri, po ashtu siç janë larguar kontinentet pas copetimit te kontinentit te vetem te sterlashte.

Po te ishte keshtu atehere hapesjra e nevojshme qe do te krijohej nga largimi i llokmave te kores se copetuar, qe me vone do te formonte bazamentin e zonave tektonike perkufizuese eshte mbushur me lende magnetike kryesisht bazaltike te ardhur nga poshte. Kjo duhet te kete ndodhur po me ate mekanizem si ne rastin e largimit te kontinenteve dhe te formimit te kores oqeanike. Per mekanizmin e largimit te kontinenteve dhe te formimit te kores oqeanike, teoria e Tektonikes se Pllakave eshte ndeshur perpara veshtiresish, te cilat edhe pas modifikimeve, nuk eshte me ne gjendje ti kaperceje. Keshtu te dhenat e saj u perdoren me sukses prej dijetareve te ndryshem, sidomos pas simpoziumit te Sidrejt (Australi) me 1981, per te themeluar teorine e Ekspansionit te Tokes. Sipas kesaj teorie kontinentet largohen duke qene te fiksuar me bazamentin

Vedat SHEHU

e vet, per shkak se rritet rrezia e rrzuillit tokesor. Disa autore e mbeshtesin kete teori te akspansioni i gjithesise, qe gjoja paska filluar pas shperthimit te Madh. Te tjere autore, pa marre parasysh te dhenat faktike, rritjen e bazojne ne cilesine e planetit per te thithur pluhur kozmik qe çon ne shtimin e mases e te vellimit. Nje pakice tjeter e veshtron zmadhimin e berthames me një densitet (Egyet 1963) me te madh per te kaluar ne një gjendje tjeter me densitet me te vogel. Ndryshimin ne kuptimin e teorise se Tokes ne zhvillim dhe te Tokes ne Ekspansion po e ilustrojme ne figuren 1, (Shehu 1988).




Fig. 1 Ne dy rastet A dhe B (prerja e levores se kokres) dhe pemes shprehet procesi i zmadhimit vellimor nepermjet rritjes, kurse ne rastin C shprehet thjesht zgjerimi apo ekspansioni.

Nga kjo paraqitje kuptohet se zmadhimi i rrezes se Tokes sipas Tokes ne zhvillim (Shehu 1988) realizohet duke u furnizuar me lende te gjeneruar prej shndrimi, sikurse e paraqet edhe Tassos ne vete globin tokesor (Tasos 1998), nepermjet shteses se mases dhe tensionit (fig.2).

Per te kuptuar mekanizmin e rritjes dhe zhvillimit te Tokes duhet te veshtrojme ate si një trup kozmik, nen dritten e te dhenave dhe interpretimeve te fundit. Ketej del se materia (korpuskulare dhe valore) shfaqet ne tri trajta: 1- e tejngjeshur (yjet neutronike, pulsaret, vrimat e zeza, etj.); 2- e tejrralluar (fushat fizike, rrezatimet); 3 - e elementeve kimike dhe lidhjeve te tyre (ne gjendje te ngurte, te lenget dhe te gazete). Plazma pranohet si një trajte e katert e materies ndermjet rrezatimit dhe elementeve kimike. Keto trajta te materies janë ne nderveprim te perhershëm ne kohe dhe hapesire te pambarimte.

Lenda e sterngjeshur nuk mund te qendroje ne ngjeshje te perhereshme; arrin një cak pas te cilit ndodh shperthimi. Pikerisht nga shperthimi i një trupi supermasiv duhet te kete origjinën edhe sistemi yne diellor. Si pasoje ne qender te Tokes, ne planete, sikurse ne Diell duhet te mbetet një pjesë nga kjo lende qe shndrohet vazhdimesht. Lenda e formuar rishtaz nga shndrimi ze një vellim shume me te madh se pjesëza perkatese e lendet se tejngjeshur te konsumuar. Kjo çon ne rritjen e zhvillimin e rrzuillit. Korja tokesore prej rritjes ndahet ne plisa qe largohen nga njëri tjetri. Hapesira midis plisave mbushet me lende te re magnetike dhe fragmente mantelore. Ne kete menyre eshte çare edhe koria e lashte ne Albanide, Dinaride, Helenide dhe me tej ne brezin e gjeosinkinalit Tetis. Midis bloqave te ndare e ne largim eshte futur gradualisht lenda e re magnetike. Keshtu eshte formuar edhe bazamenti i Mirdites dhe mineralet qe lidhen me te.

Keto interpretime kerkojne te krijojen koncepte te reja per perberjen e berthames se Tokes, per prejardhjen e Sistemit Diellor, per formimin e elementeve kimike me anen e shndrimit, per natyren e gravitacionit per mekanizmin e termetave dhe vullkaneve.

Kjo teori mund te perdoret me drejt e me mire ne praktiken kerkimore si per mineralet e dobishme dhe per shndrimin dhe pervehtesimin e natyres si dhe revolucionarizon mendimin shkencor per kerkime te metejshme jo vetem ne drejtim gjeologjik.

VESHTRIM MBI FORCEN LEVIZESE TE ZHVILLIMIT GJEOLOGJIK TE TOKES

Per te kuptuar dhe interpretuar me mire proceset dhe dukurite gjeologjike na duhet t'i shqyrtojme ato nen një kend veshtrim te ri dhe te nderthurura nga njera tjetra qe nga origjina.

Roli i berthames se Tokes.

Cështja mbi perberjen natyren fizike te berthames dhe rolin qe lot ajo ne proceset gjeologjike te planetit tone futet ne problemet joshese dhe enigmatike jo vetem te gjeologjise teorike, gjeofizikes e gjeokimise, por edhe te astrofizikes dhe astrokimise. Sipas te dhenave te mirenjhura sizmike, berthama e jashtme (fig.2) permban veti lengu dhe kufizohet me berthamen e brendeshme nepermjet nje zone kalimtare prej 100 km. Po ashtu me mantelin verehet nje zone e ngushte kalimtare. Te dyja keto zona kalimtare te shprehura qarte ne diagrame (fig. 2b) tregojne per shderimin e materjes nga nje gjendje ne tjetren duke perfunduar ne zhvillimin gjeologjik te Rruzullit.

Gradualisht jane mohuar interpretimet qe e konsiderojne berthamen krejt inaktive, si nje koncentrat Fe-Ni, apo si nje lende silikate me veti metalike nen kushtet e presioneve te larta. Autore me te hershem (Halm 1935, Egyet 1963, kuzenjcov 1983, etj.) dhe aktualisht Tassos (1998) janin interpretimet e ndryshme





Fig. 2 – Paraqitet skematikisht ndertimi i brendshem i Tokes (fig.2a) dhe diagrama e shpejtseve te valeve sizmike ne varesi me thellesine (fig.2b).



per formen e paqendrueshme te trajtes se katert te shfaqjes se materjes plazmes qe ndodhet e tejngjeshur ne berthame, e cila shndrohet ne nje mase vellimore qe ngjitet larte dhe krijon shtese mase dhe shtese nderjeje (shtresi), burim i forces levizese. Shkalla e ngjeshjes se materjes se njetrajteshme ne berthame llogaritet me densitet fillestar me vlera shume te ndryshme prej 17 (prej Egyet) deri ne me shume mijra, (Halm,etj.) sikurse ne trupat qillor te tejngjeshur.

Keshtu ndertimi i peshtjellave te brendeshme te Tokes dhe i levizjeve gjeologjike eshte pasoje e proceseve qe vijnë nga shndrimet qe peson nje trajte e caktuar e materies ne thelbin e berthames se trupit qillor (Kuznjecov 1983).

Vullkanet dhe Termetet – shfaqje te zhvillimit te Tokes

Vullkanizmi bazik (kryesisht bazaltik) eshte ai qe ka mbizotuer ne formimin e bazamentit ofiolistik te Albanideve, eshte ai qe ka mbizotuer ne proceset e ndertimit te bazamentit te gjeosinkinalit Tetis dhe eshte mbizoterues ne proceset e sotme vullkanike ne Tokë; ka qene apo eshte mbizoterues ne Hene, Mars Merkur dhe Aferdite. Keshtu lavat bazaltike te ngurtesuara dhe shkembinje magnetike qe per nga origjina lidhen me keto lava Jane komagmatike dhe perbejne pjesen dermuese te kores tokesore. Ketej del edhe perfityrimi i drejte mbi rolin e madh shkembformues e koreformues i lavave bazaltike.

Gazet qe shoqerojne vullkanet, sipas te dhenave analitike (Lawrence 1974) perbehjen ne pjesen me te madhe nga H_2O (avuj uji), O_2 dhe N_2 , mandej marrin pjese CO_2 dhe CO ne sasi te konsiderueshme, kurse ne sasira te vogla Jane te pranishem H_2 , H_2S , SO_2 , HCl , HF , CH_4 , NH_3 , SO_3 , etj. Nga keto te dhena verehet qarte se vullkanet çlirojne ne forme gazesh po ata perberes kryesore te hidrosferes, atmosferes dhe biosferes. Duke ditur se vullkanizmi ka shoqeruar historine e Tokes vazhdimisht eshte plotesisht e natyreshme te pranojme se ai ka qene furnizuesi kryesor i pasurimit te ketyre tri peshtjellave.

Eshte vertetuar nje lidhje hapsinore e funksionale ndermjet yullkaneve dhe termeteve. Verehet nje perputhje mahnitese kur krahasohen hartat e perhapjes se vullkaneve me te epiqendrave te termeteve. Nga autore te ndryshem (Lawrence 1974) eshte theksuar se shumica e vatrave te vullkaneve kane vendosje hapsinore ne zonen e vendosjes se vatrave te termeteve, e pikerisht ne thellesine 100-250 km.

Grumbullimi i lendet se re ne ngjitur per ne siperfaqe neper vatra te caktuara, shkakton tension dhe prishjen e ekuilibrit sferik te gravitetit. Kur grumbullimi eshte ne nje mase me te madhe rivendosja e ekuilibrit behet ne nje thellesi me te madhe jo me te thelle se 250 - 720 km. Anasjelltas per nje mase lende me te vogel prishja dhe rivendosja e ekuilibrit do te ndodh, kur masa do te arrije afer periferise (jo me afer se 20-10 km). Me anen e ketij mekanizmi shpjegohen shume me mire edhe deformimet e kores tokesore ne per gjithesi te shoqeruara edhe me levizjet e blloqeve tektonike.

Termetet dhe vullkanet u pergjigjen ligjesive prandaj gjate perqatitjes shfaqin shenja qe mund te regjistrohen e te parashikohen gjithnjë e me sakte (deformimet e siperfaqes, emetime, anomali manjetike). Pra Jane varesi te ligjeve te zhvillimit dhe mund te parashikohen.

Hidrosfera, atmosfera dhe biosfera ne zhvillim

Keto peshtjella gjeologjike te tokes perbehjnë nga te njejtet elemente kimike, Jane ne bashkeveprim te perhershëm dhe Jane zhvilluar se bashku. Berthama e Tokes ushqen si peshtjellat e gurtë ashtu edhe ato flurore me lende te pare. Koria tokesore eshte ne proces deformimi dhe rindertimi te vijueshem si nen veprimin e faktoreve te brendshem (nga poshte) ashtu edhe te atyre te jashtem (nga larte).

Te trija keto sfera kane kaluar nje histori te perbashket duke u rritur e zhvilluar paralelisht ne lidhje me njera tjetren. Rreth 2 miliarde vjet Toka ekzistoi e shkrete me hidrosferë te pakonsoliduar gjersa u shfaq procesi i fotosintezes base per formimin e organizmave te thjeshta dhe vetem mbas 2 miliarde te tjerave rreth 0,6 miliarde vjet me pare u stabilizua zhvillimi i vrullshem i biosferes ne kushte atmosferike e hidrosferike te pershtateshme (Vojtkeviç 1973).

Hapesira nderplanetare dhe nderyjore

Duke u larguar nga atmosfera dhe ndikimi i fushes gravitacionale te Tokes (Hafizi 1999) hyjme ne hapesirat nderplanetare qe permbajne disa dhjetra atome ne 1 cm^3 . ne hapesirat nderplanetare takohet dhe nje mori copezash prej meteoresh e coperash te prejardhur nga shperberja e kometave. Ne hapesirat nderyjore takohet nje atom hidrogjen ne 10 cm^3 apo ne hapesirat ndergalaktike ne 10^3 cm^3 .

Brenda hapesires nderplanetare ndeshemi me rrezatim kozmik intensiv (protone, elektrone dhe berthama elementesh kimike), me origjine kryesisht nga Dielli dhe vetem ne nje perqindje te vogel vijne nga burime te largeta kozmike. Ky rrezatim hapet dhe devijohet nga fusha manjetike e Tokes dhe asimilohet nga bashkeveprimi me shtresen e Ozonit.

Fusha manjetike e Tokes ndikohet nga rrezatimi kozmik. Ketu duhet theksuar se edhe termeti krijon ne zonen e epiqendres anomali te fushes manjetike. Pra edhe ketu verehet se rrezatimi eshte pasoje e bashkeveprimit midis trajtave te materjes.

Planetet e perngjashem me Token

Planete te perngjashem me Token jane planetet e brendshem qe fillojne nga unaza e asteroideve, e cila perfaqeson orbiten e nje planeti te paformuar ndermjet Marsit dhe Jupiterit.

Merkuri, Aferdita, Marsi po ashtu Hena dhe asteroidet perfaqesohen nga lloje shkembore shume te peraferta me te Tokes. Edhe ne Hene si ne Toke koria kontinentale eshte me e vjeter se ajo e deteve, pra e ngurtesuar me pare. Po ashtu ne planetet e tjere jane verejtur dukuri si te Tokes, me te theksuar ne Mars ku kanalet gjigande duket se jane analoge te rifteve tokesore, kurse ne Aferdite ngajne me vragat e thella oqeanike.

Persa i perket planetave te jashtem duhet nenvizuar si me i largeti, plutoni tashme nuk konsiderohet planet prej astronomeve, por njeri me i madhi prej 70 TTN-ve (Trupave Trans-Neptunian), qe vertiten rreth Diellit; pra kurre s'ka qene planet, por eshte marre si i tille (Schilling 1999).

Dallime midis planetave verehen ne dendesine e ndryshme. Me sa duket ky ndryshim varet nga shkalla e konsumimit te arritur te lendet se tejngjeshur te berthames te shnderuar ne lende elementesh kimike e mandej ne lende shkembore silikate (Shehu 1988).

Po ashtu ngashmeria e perberjes se meteoriteve me ate te shkembinjeve bazike te Tokes mund te tregoje ate qe elementet kimike ne asteroide jane formuar nga po ato procese qe sot ndodhin ne berthame te planetave dhe ne Diell, prandaj edhe prejardhja e tyre eshte e pandashme nga origjina e sistemit Diellor.

Shkembformimi, Proces Universal

Kohe me pare (Low 1970) eshte konstatuar lidhje okside metalore potencialish shkembformuese si dhe perberje silikate ne vrojtimet e spektrave te fotometrise infra te kuqe. Por kjo nuk mund te tregoje ate qe ne historine e sistemit Diellor, kondesimi i grimcave te forta silikate nderyjore, apo te flakura nga Dielli, qojne ne formimin dhe ndertimin e planetave dhe trupave meme te meteoriteve. Nuk do te kishte mundesi qe nga produkti i djegjes te formohej drejt persedrejti lenda e djegeshme. Megjithate dihet qe pluhuri kozmik, sikurse mbeturinat e trupave te shkateruar (meteoret, meteoritet, etj.) mund te terhiqen nga fusha gravitacionale e planetave dhe te behien pjese perberese e tyre (Shehu 1988). Kete krahasim jo dhe aq te goditur mund ta shprehin skematikisht keshtu:

Mbi Atomet e Elementeve Kimike

Sot eshte krijuar nje perfytyrim i ri per shnderimet ne gjithesi, dmth qe elementet kimike nuk jane "tullat" baze qe e perbejne ate, se keto elemente formohen, shperbehen dhe perseri riformohen nga veprimi i



ndersjelltë i trajtave te ndryshme te materies. Shperberja e berthamave te trupave qielloj çon ne formimin e elementeve kimike (Shehu 1988).

Mbi Gravitacionin

Gravitacioni eshte nje nga kater bashkeveprimet fizike te mirenjohura. Tre te tjerat jane: bashkeveprimi berthamor i dobet (elektron-proton); i forte (ndermjet barioneve) dhe elektromagnetizmi.

Gravitacioni ka veti te perbashketa me format e tjera te shfaqjes se materies:

Mjet bashkeveprimi ndermjet trupave material. Matematikisht forca e ketij bashkeveprimi formulohet si dhe ajo e forces elektrostatiske.

Gravitacioni transmetohet ne vale. Natyra kuantike dhe valore e gravitacionit tashme quhet e miregjene dhe eshte vertetuar nga disa te dhena (Nicolson 1983); pulsari PSR113+16 zvogelon periudhen orbitale per shkak te humbjes se mases prej rrezatimit te gravitoneve. Graviton ne astrofizike quhet kuanti i fushes se gravitacionit.

Duke e kuptuar gravitacionin si pasoje procesesh apo bashkeveprimesh atehere edhe variabiliteti i tij eshte i kuptueshem ne varesi me kushtet kozmike te sistemit Diellor ne rrrotullimin e vet rreth qendres se Galaktikes. Fakti qe fazat e intensifikimit te proceseve tektonike te kores tokesore i perjigjen nje pozicioni te caktuar te Diellit ne orbiten e tij, le te nenkuftohet se proceset e shnderimit te materies, qe shoqerohen edhe me rrezatim gravitoresh behen me intensitet luhates, kjo çon domosdoshmerisht ne luhatjen e intensitetit te fushes se gravitacionit.

Mbi origjinën e Tokes

Duke analizuar interpretimet e fillimit te gjithesise nga plazma e supernxehur (Zedoviç 1971) dhe e shperndare uniforme apo nga shperthimi i madh (Silk 1982) del si perfundim se njetrajtshmeria fillestare e shperndarjes apo perqendrimi te materjes nuk mund te shpjegoje krijimin e proceseve. Gjithmone ka ekzistuar bashkeveprimi plus dhe minusi; protoni dhe elektroni dhe larmia e proceseve. Mbi kete baze kalojme ne formulimin e nje teze te thjeshte: lenda e superngjeshur perqendrohet ne berthamat e trupave qielloj, ajo e super-rralluar ne hapesirat midis tyre, kurse ajo kalimtare ne peshtjellat e trupave qielloj, mvesh berthamat e trupave qielloj (Shehu 1988).

Keshtu ndersa ne nje trup lenda sterngjeshet arrin nje pikë kritike qe nuk mban me dhe procesi i kunderveprimit çon ne shperthim. Me keto premisa del e nevojshme te pranojme kete skeme te formimit te Sistemit Diellor.

Pas shperthimit te nje trupi kozmik gjigand me permasa astronomike nje nga copat e tij perfshin ne fushen e vet gravitative nje mori grimcash apo copash. Keto ishin Dielli potencial me grimcat planetesimale, qe me

perplasje u bashkuan ne sfera me te medha derisa krijuan berthamat e planeteve qe vertiteshin rreth tij. Ne kushte optimale u formuan planetet fillestare. Ne rastin kur procesi i transformimit te materies uniforme ne elemente kimike e lende guore perfundoi perpara perqendrimit te truphave ne trup me te madh dmth ne berthame planetesh, nga perplasjet e tyre u arrit ne thermim te metejshem. Keshtu ndodhi me brezin e asteroideve, ku procesi i shkembformimit pararendi procesin e bashkimit dhe perngjittes se grimcave dhe lenda e superngjeshur arriti shume shpejt shderimin e plete ne lende silikate apo silikato-metalike. Toka, sikurse dhe planetet e grupit te saj u stabilizua dhe u zhvillua ne orbiten e vet perreth Diellit. Sa me teper kalonte koha aq me teper krijhesh mase elementesh kimike dhe lidhjesh te tyre. Fillimisht keto formonin kuroren e gazte te Tokes, mandej ate te lenget e me ne fund ate te ngurte, koren tokesore dhe litosferen me mantelin.

Zhvillimi i Kores Tokesore ne Albanide

Duke aplikuar teorine e tokes ne shvillim dhe respektivisht ne rritje me anen e shnderimit te berthames, pranohen per mendimin tim interpretimet teorike te bera nga Keri (Caery 1973, 1996) dhe Tassos (Tassos 1998) per nderjen e kores dhe penetrin diapirik te lendes magnetike te lenget apo te ngurte e per pasoje levizjet tektonike, qe sipas kushteve shfaqen me shkeputje apo me rrudhosje. Nga rilevimet dhe analizat qe kam kryer gjate punes studimore-kerkimore per shfrytezimin e lumenjeve kam njojur direkt prerjet karakteristike te te gjitha zonave tektonike si dhe kam studjuar ne menyre te detajuar shume sektore. Askund nuk shfaqet ndonje gjurmë e magmatizmit jurasic megithese ai pranohet nga shumica e gjeologeve, veçanerisht nga Kodra nepermjet disa botimeve, ndoshta per konformizem me autore me te hershem.

Keshtu hapjen dhe krijimin e gjeosinkinalit Tetis une e vendos ne kufi ndermjet eres hercenike dhe asaj alpine, ku derdhen lavat e para te shoqeruara edhe me protruzione ultrabajikesh. Ne jurasic ndodh perseri nderja dhe hapja, por kete radhe me penetrin diapirik te ultrabajikeve. Nuk verehet asnjë gjurmë i te ashtuquajturit subduksion, perkundrazi mund te flitet per tektonik diapire apo siç e percakton Çudinovi (Chudinov 1992, 1998) tektonik edukzioni.

Perkrahesit e Tektonikes se Plakave duke mohuar tektoniken Diapire jane detyruar te pranojne formimin e ofioliteve te Mirdites kryesisht ne jurasic te mesem te siper (Shallo, etj. 1980; Kodra, etj. 1982), kur studjuesit e meparshem kishin konfirmuar perkatesisht mungese vulkanizmi ne kete epoke (Teksti i Hartes Gjeologjike 1:200 000 V. 1960) dhe ultrabajket i konsideronin vetem intruzione.

Ne fig. 3 jepen skematikisht 5 momente te zhvillimit te Albanideve ne analogji me interpretimet e Tassos per detin Egje; te Kerit e Mudit (Mudy 1998) e autoreve me te hershem si Oweni (1983), Chudinov (1992) e te tjere ne vende te ndryshme.

Kjo skeme plotosohet edhe me kolonen lithostratigrafike (fig.4), ku paraqiten skematikisht dy interpretime, sipas autorit (A) dhe sipas pikepamjes me te perhapur (B).

Dallimi thelbesor qendron ne ate qe sipas "A"-se ne jurasic te siper nuk eshte perseritur procesi i vulkanizmit, veçse ka ndodhur depertimi i nguret i diopireve apo protruzioneve ultrabajike.

Keshtu ashtu siç jepet edhe ne interpretime dhe skemat e autoreve te permendur ketu, per rajone te ndryshme te globit, nga ngritja e lendes se gjeneruar qe nga berthama e tokes nepermjet bashkeveprimit te transformit shtese lende e mase, e cila ne udhet per ne siperfaqe krijon akumulime ne nivele te diferenca e bashke me kete krijohet shtese nderjeje apo tensioni qe çon ne tektoniken diapirike dhe krijimin e sistemeve te rrudhosura.

Me anen e kesaj teorie krijohen premsa te reja per kerkimin e mineraleve te lidhur me magmatizmin bazaltik dhe penetrin e protruzioneve ultrabajike.



Fig. 3. Paraqitura skematike e zhvillimit gjeologjik e albanideve me anen e pese prerve teriore te zonave tektonike: Jonike (J), Krujës (Kr), Kraste-Cukalit (KC), Mirdites (M), Korabit (K).

Prerja A: Fundi i eres paleozoike dhe i epokes hercenike te levizjeve tektonike.

Prerja B: Ne triasik te mesem perfundon vulkanizimi dhe formimi i ofioliteve.

Prerja C: Mbarimi i kretakut te poshtem.

Prerja D: Formohet reliivi i sotem.




Fig. 4 Kollona lithostratigrafike e Albanideve sipas dy interpretimeve A dhe B.

Legjenda e prerjeve dhe e kolones

- 1 - Bazamenti albanideve: renoja paleozoike te metamorfizuara.
- 2 - Fragmente permiane: rreshpe, konglomerate gelqerore, seria e ranoreve te kuquerremte (a), "Vemkans" apo Luma, gipse (b).
- 3 - Bazamenti ofiolotik i Albanideve: masivebazike, mesataro-acide dhe derivate; bazalte, vullkanogjeno-sedimentar; agimi i epokes alpine.
- 4 - Horizonti i kuquerremet me faune amonite gelqerore ngjezor, gelqerore shtresore te kuquerremet me stralle.
- 5 - Seria e poshtme gelqerore triasik e formuar ne nje epoke qetesie tektonike relative te Albanideve.
- 6 - Rreshpe (a) dhe gelqeror ngjezor me faune amonitesh (b) te jurasikut te poshtem, gelqeror te jurasikut te mesem(c).
- 7 - Depozitime te larmishme ne epoken e differencimeve tektonike jurasiko – kretale: strallore radiolaritike, rreshpe, konglomerate, gelqerore (a) laterite (b), protuzione apo diapire masivesh ultrabazike (c).
- 8 - Seria gelqerore e siperme e formuar ne epoken e dyte te qetesise tektonike relative (krete e siperme deri eocen).
- 9 - Depozitime ne epoken e differencimeve tektonike te kretakut te siperme eocenit: laterite, depozitime terrigjene, gelqerore.
- 10 - Depozitime te differencuara te fllshit paleogenik transgresive te eocenit e oligocenit edhe me laterite e shtresa qymyresh.
- 11 - Molasa e miocenit depozitimi i argilo – ranoreve edhe me shtresa qymyresh ne kushtet e differencimeve te theksuara tektonike.
- 12 - Molasa pliocenike edhe me shtresa qymyresh.
- 13 - Mbulesa e depozitim, eve pliokuaternare e kontemporane.
- 14 - Thyerje tektonike.

Legjenda:

1. Bazamenti i metamorfizuar paleozoik; rrrenojat e kaledonideve dhe hercenideve prej rreshpesh, ranoresh, kuarcitesh, etj., ne zonen tektonike te Korabit (K) dhe Gashit (G);
2. Bazamenti permian i zones se Alpeve (A) me rreshpe, gelqerore dhe konglomerate.
3. Formacioni terrigen permotriasic – seria "luma" apo "verukano" ne zonen e Korabit (K),
- 4,5,6,7. Bazamenti ofiolitik permotriasic (i mesem) ne zonen tektonike Mirdita (M) me ultrabazike (4), gabro e gabroide (5), granite e granitoide (6), vullkanogjeno-sedimentare (7).
8. Seria e poshtme gelqeroro-triasike, kryesisht ne pjeset anesore te Mirdites (M) kalimtare per ne zonat e tjera.
9. Seria gelqeroro – triasike, strallore e argillore jurasike, gelqerore kretake ne zonat jashte Mirdites (Kraste-Cukalit KC, Krujes Kr, Jonike J. Alpeve A).
10. Seria terigjene jurasiko-kretake apo e "fllshit" te hershem kryesisht ne zonen tektonike te Mirdites.
11. Seria gelqerore e siperme, transgresive kretake ne zonen e Mirdites (M).
12. Formacioni terrigen fllshor i paleogenit kryesisht ne zonat e jashtme ne Kraste- Cukal (KC), ne Kruje (Kr), ne Jonike (J) dhe ne Alpe(A).
13. Formimet molasike zhavorrore neogenjike e te neogenkuaternarit: konglomerate, ranore, argjilite, alevrolite, rralle gelqerore e here here me shtreseza qymyri, kryesisht ne zonen Jonike (J) dhe ne gropat e brendeshme; Burrelit, Korçes, Peshkopise (Dibres). Pjeset me te ulta mbulohen nga zhavorret e kuaternarit dhe ato bashkekohore.

KONKLUSIONET




Fig. 5. Skema e tipareve themelore geologjike te albanideve

Te dhenat e reja qe u futen dhe u interpretuan ne teorine e Tektonikes se Plakave pasojne me mire ne teorine e tokes ne zhvillim. Ku zgjerimi i saj realizohet me shderimin e Berthames te superngjeshur. Berthama e brendshme permban thelbin e forces levizese per zhvillimin e planetit dhe perben synimin strategjik per njohjen shkencore te saj. Kjo teori gjen aplikim edhe ne treven e gjeosinkinalit Tetis perfshi Albanidet. Me anen e kesaj teorie orientohen me mire deshifrimet strukturore dhe kerkimet gjeologjike. Rruzulli tokesor duhet veshtruar edhe me teper si nje moster e gjithesise ne duart tona per zbulime te metejshme.

Literatura

- ✓ Carey S.W., 1976: The expanding Earth ; El. Sc. Pu. Co.
- ✓ Carey S.W., 1996: Earth Universe Cosmos; Un. Tasme . Ear. Scb.
- ✓ Chundinov Ju.V., 1992, rib. 1998 Global Eduction Tectonics of the Expanding Earth; AH Zeist, The Netherlands.
- ✓ Blinov V.F., 1973: O hipoteze razrastania zemli; Moske
- ✓ Mundy B., 1988: Expanding Earth Pac. Un. Coll., Ang. California
- ✓ Egyet L. 1963: The Expanding Earth Natyre
- ✓ Halm J.K.E., 1935: An astronomical aspect of the evolution of the earth. Astrom. Soo.s.Afr.IV (1). Cituar sipas Carey 1976
- ✓ Hafizi Mimoza., 1999: Bazat e Astrofizikes: Shtepia Botuese e Librit Universitar, Tirane.
- ✓ Kodra A., Gjata K., 1982: Ofiolitet ne kuadrin e zhvillimit Gjeologjik te Albanideve. Bul. Shk. Gje. 2, 1982.
- ✓ Kuznjecov V. V., 1983: Model jadra Zemli i geomagnitnoe Pole; Geol. I Geof.5
- ✓ Lawrence D. S., 1974: Neovulkanism: a proposed replacement for the concepts of the plate Tectonics and Continental drift; botuar nga Kohle Ch. F.
- ✓ Low F. S., Krishna Swamy, 1970: Narow band infrared photometry of á – ory. Nat. 1970.
- ✓ Nikolson J. 1983: Tjagotenie Černie diri i Vselenija (perkthim nga anglishtja Mos. "Mir")
- ✓ Silk J. 1982: Big Bang. San fanc. 1982; cituar sipas nikolson 1982
- ✓ Shallo M., 1980 Magmatizmi ofiolitik ne albanide; referat shkencor ne konf. E 6 – te gjeologjike.
- ✓ Schilling covert 1999. Pluto: The Planet that Never was science 8 january 1999.
- ✓ Shehu V., 1988 Toka ne zhvillim, sht. Bot. "8 nentori"
- ✓ Shehu V., Gjata Thanas 1990. Disa aspekte te tektonikes mbihipese ne kuadrin e marredhenieve te zonave. Bul Shk. Gjeol. Nr.2 1990
- ✓ Shehu V., Gjata Thanas 1990. Te dhena dhe interpretime per mbihipjet ne albanide. Mbajtur ne simpoziumin Kombetar Tektonika Mbulesore ne albanide, Tirane, Nentor 1990.
- ✓ Tassos S. T., 1998 a: Earth Expansion; proc. Int. Symposium on NCGT, Nov.
- ✓ Tassos S. T., 1998 b: The manifestation of Excess mass and stress in the Algean region; Proc. Int. Symp. On NCGT, Nov.
- ✓ Tockly J. paul, 2000: Mantle convection and Plate Tectonics: Toward an Integrate physical and chemical Theory. Science 16 June 2000.
- ✓ Vogel K. 1984: Beitrage Zur Frage der Expansion der erde auf der Grundlage von Globenmodellen. Zeitschrift fur Geologische Wissenschaften.
- ✓ Vojtkiević G. V. 1973: Proishozhdenie i hemiçeskaja evolucija Zemli. Mos. "Mir"
- ✓ Zeldović Ja. B. 1971; Teoria Tjagotenija i evolucia zvezd cituar sipas Vojtkiević
- ✓ Gjeologjia e Shqiperise 1970 – Teksti i hartes gjeologjik te Shqiperise ne shkalle 1 : 200 000 e vitit 1967.

NDERIM PER ILIA PAPEN

Me hidherim te rende mesuam per vdekjen e parakoheshme, nga nje semundje e rende, te shokut dhe kolegut tone te dashur **ILIA PAPA**. Ilia Filip Papa lindi m e25 Maj 1947 ne Aliko te Sarandes, ku dhe kreua shkollen 7 vjeçare, ndersa shkollen e mesme te per gjithshme e kreua ne gjimnazin e Sarandes me rezultate shume te mira. Gjate viteve 1965 – 1970 vazhdoi studimet e larta ne Fakultetin e Gjeologjise dhe Minierave te Universitetit Shteteror te Tiranes, te cilin e mbaroi me rezultate te larta dhe u diplomua Inxhinier Gjeolog.

Ilia Papa, pasi mbaroi shkollen e larte, punoi 15 vjet me rradhe (1970 – 1984) ne rethin e Pukes, ne kolektivin e gjeologeve te kesaj ndermarrje, duke drejtuar punimet gjeologjike ne disa vendburime te rendesishme, si ne Qafe Bari, Paluce, Tuç, Rruja e Rinise, Lak Roshi dhe ne byrone e per gjithesimit te ndermarjes. Me pas u transferua ne ndermarrjen gjeologjike te Gjirokastres, ku deri ne vitin 1992, ka bere kerkime gjeologjike ne rrjetet Gjirokaster e Sarande. Me punen e tij Jane te lidhura rezultatet e arritura ne zbulimin e ketyre vendburimeve, duke qene iniciator dhe dejtues i afte per kryerjen e punimeve dhe studimeve gjeologjike. Nder te tjera eshte kontributi personal i tij dhe kembengulja ne gjetjen e vendburimit Rruja e Rinise, qe u zbulua nen drejtimin direkt te tij dhe eshte bashkëautor i vleresimeve te vendburimeve te Qafe Barit, Paluces, Lak Roshit, Munelles dhe i disa punimeve shkencore (ku eshte bashkëautor) per 14 projekte dhe 4 raporte e studime te rendesishme gjeologjike per rrjetin e Pukes si dhe per kerkimin e fosforiteve e lendeve te para ne rrjetin e Gjirokastres. Ilia Papa punoi ne ekipe dhe ekspedita te largeta e me veshtiresi, larg vendlindjes, duke krijuar familjen e re te tij, me banim ne Puke e Fushe Arrez, duke qene nje familjar shembullor.

Ilia ishte punetor, i pa fjale, i sakrifices, me dije dhe me rezultate e efektivitet te larte ne pune, shume i regullt e serioz, i dashur dhe i respektuar me shoket e tij te afert e me te gjithe punetoret. Ishte nje person me zemer te gjere, model dhe mjaft i respektuar, me kapacetet te larte e i pa fjale, duke qene per dy vjet per gjegjes ekspedite ne Lak Roshi dhe nje nga specialistet me te respektuar te ndermarrjes gjeologjike. Shoket dhe gjithe punonjesit e gjeologjise, qe e kane njojur dhe punuar me te, ruajne kujtimin dhe respektin e veçante per jeten dhe punen e Ilia Papes.

Ngushellime nenes, gruas e femijeve, vellezerve e motrave te tij, qe i donte aq shume, dhe gjithe te afermeve te tij.

Ne do te kujtojme ne respekt te veçante kontributin e madh qe ka dhene ne kerkimet gjeologjike dhe vleresimin e shokut tone te dashur Ilia Papa, i cili do te jete i paharuar ne mendjen dhe zemrat tona.

HOMAZH DHE RESPEKT PER ILIA PAPEN

Nga shoket e tij te afert te punes : Lirim Hoxha, Fiqiri Bakalli, Polikron Vaso, Tonin Deda, Abdulla Balla, Pellumb Kokona, Fatmir Kalaja, Ismail Turku, Ndoc Vukzaj, Myfit Ferhati, Resmi Kamberi, Afat Serjani, Agim Guçaj, Dede Marku, Xhavit Selimi, Stak Gjoni, Nikolle Pjetri, Tonin Vjerdha, Spiro Laska, Thanas Llahanaj, Dhimiter Mehilli, Arqile Papuçiu, Apostol Qirkó.